



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 4132 prot.

Shkodër, më 19. 12. 2022

V E N D I M

Nr. 269, datë 19. 12. 2022

**"Për miratimin e raportit të cilësisë së brendshme për vitin akademik 2021-2022"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 38, pika 1, germa j; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa h, Neni 24, pika, 2, Senati Akademik, pasi mori në shqyrtim Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2021-2022, në mbledhjen e tij të datës 19.12.2022

**Vendosi:**

1. Të miratojë Raportin e cilësisë së brendshme për vitin akademik 2021-2022 (materiali bashkangjitur).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARË  
Prof. dr. Suzana GOLEMI











UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

# RAPORTI I VETËVLERËSIMIT 2021-2022

## GRUPI I VETËVLERËSIMIT

- |                               |                           |   |
|-------------------------------|---------------------------|---|
| 1. Dr. Aurora Dibra           | Kryetar                   |    |
| 2. Msc. Olta Smajli           | Anëtare                   |   |
| 3. Dr. Vilma Piroli           | Anëtare                   |   |
| 4. Msc. Sidita Zaganjori      | Anëtare                   |   |
| 5 Prof. As. Dr. Jozef Bushati | Anëtar(Ekspert i jashtëm) |  |
| 6. Xhenet Saloviç             | Anëtare (Studente)        |   |

Dhjetor, 2022





## PERMBAJTJE

|  |     |
|--|-----|
| Shkurtime.....   | 3   |
| Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit.....  | 5   |
| Historiku i IAL.....   | 6   |
| Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional.....     | 24  |
| I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË..... | 27  |
| II – BURIMET DHE PARTNERITETI .....  | 36  |
| III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI.....                             | 53  |
| IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI .....                                | 72  |
| V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE.....   | 82  |
| Përfundimet dhe vlerësimi i përgjithshëm.....  | 95  |
| Lista e evidencave mbështetëse të IAL-sw.....  | 119 |





## Shkurtime

|              |  |
|--------------|--|
| <b>ASCAL</b> | Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit të Lartë |
| <b>GVB</b>   | Grupi i Vlerësimit të Brendshëm                      |
| <b>LAL</b>   | Ligji për Arsimin e Lartë                            |
| <b>MASR</b>  | Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë              |
| <b>NJSBC</b> | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë          |
| <b>USH</b>   | Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”             |
| <b>ILP</b>   | Instituti i Lartë Pedagogjik                         |
| <b>BUSH</b>  | Biblioteka e Universitetit të Shkodrës               |
| <b>AMS</b>   | ASCAL Managment System                               |
| <b>FSHSH</b> | Fakulteti i Shkencave Shoqërore                      |
| <b>FSHE</b>  | Fakulteti i Shkencave të Edukimit                    |
| <b>FE</b>    | Fakulteti Ekonomik                                   |
| <b>FD</b>    | Fakulteti i Drejtësisë                               |
| <b>FGJH</b>  | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja                         |
| <b>FSHN</b>  | Fakulteti i Shkencave të Natyrës                     |



## Lista e tabelave

|  |    |
|--|----|
| Tab. 1: Skeda informuese për Universitetin “Luigj Gurakuqi” .....      | 6  |
| Tab. 2: Organigrama.....   | 8  |
| Tab. 3: Skeda informuese për FSHN .....                                | 10 |
| Tab. 4: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN .....  | 10 |
| Tab. 5: Skeda informuese për FSHE.....                                 | 12 |
| Tab. 6: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHE.....   | 13 |
| Tab. 7: Skeda informuese për FGJH.....                                 | 14 |
| Tab. 8: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FGJH.....   | 15 |
| Tab. 9: Skeda informuese për FE.....                                   | 17 |
| Tab. 10: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE.....    | 16 |
| Tab. 11: Skeda informuese për FSHSH.....                               | 20 |
| Tab. 12: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH..... | 20 |
| Tab. 13: Skeda informuese për FD.....                                  | 23 |
| Tab. 14: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FD.....    | 23 |



## Hyrje në procesin e Vetëvlerësimit

Duke u bazuar në nenin 130 të ligjit nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, statutin e USH-së, si dhe në “Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë” miratuar me VKM nr.824, datë 24.12.2021, është krijuar grupi për vlerësimin e brendshëm të USH-së. Grupi i vetëvlerësimit përbëhet nga tre anëtarë të Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Vlerësimit të Standardeve të USH-së, një anëtar i Drejtorisë së kurrikulave, një ekspert i jashtëm (ish-pedagog i USH-së si dhe Koordinator i parë i USH-së për akreditimin) dhe një studente. Ky raport ka për qëllim të krijojë një tablo të qartë të IAL-së në lidhje me 5(pesë) fushat kryesore:

- Institucioni i arsimit të lartë, menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë
- Burimet dhe partneriteti
- Programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi
- Aktiviteti shkencor / artistik dhe inovacioni
- Studentët dhe mbështetja e tyre

Grupi i punës i sipërpërmendur i ka ndjekur me përpikmëri të gjitha parimet e parashtuara më poshtë nga ASCAL për realizimin e detyrës së vlerësimit të USH-së

· Vlerësimi i Cilësisë duhet të karakterizohet nga profesionalizmi, vërtetësia, objektiviteti, paanshmëria, transparenca e plotë dhe përfshirja e të gjithë aktorëve në të gjitha fazat e vlerësimit.

· Zhvillimi i Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë (SBSC) në Njësitë e IAL.

· Të realizojë Vlerësimin e Brendshëm me synimin që të krijohet një tablo e qartë dhe transparente e Njësisë nën vlerësim, për të ndërtuar politika zhvillimi në përputhje me misionin e saj dhe të shërbejë si bazë për procesin e mëtejshëm të akreditimit të institucioneve e programeve.

· Të bëjë publik informacionin me qëllim që të gjithë partnerët dhe publiku i gjerë (studentët, prindërit, stafet akademike dhe ndihmëse, partnerët e tjerë socialë, ekonomikë e politikë) të informohen për gjendjen e njësisë, programeve, kurrikulave, shërbimeve, etj.

· Të shërbejë në fund të fundit për kultivimin e Kulturës së Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë si pjesë e tyre e brendshme dhe e qëndrueshme.

· Vlerësimi të bëhet i mbështetur në dokumenta, procedura, anketime, takime me palët e interesuara etj.



## Historiku i IAL

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” (USH) është Institucion Publik i Arsimit të Lartë (IPAL) në RSH, veprimtaria e të cilit bazohet në nenin 57, pika 7, të Kushtetutës, në ligjin nr.80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Fillimisht është hapur me 2 shtator 1957 si Instituti i Lartë Pedagogjik 2-vjeçar i Shkodrës, me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.150, datë 18.04.1957. Gjatë periudhës 1970–1971, Instituti i Lartë Pedagogjik, kaloi nga afati i studimit 2-vjeçar në atë 3-vjeçar dhe në vitin shkollor 1982-1983, kaloi nga sistemi 3-vjeçar në atë 4-vjeçar. Kalimi në sistemin 4-vjeçar do të përbënte një hap të rëndësishëm për ngritjen e punës mësimore-shkencore dhe edukative të këtij institucioni. Aspekt i rëndësishëm gjatë kësaj periudhe ishte edhe rritja e numrit të pedagogëve që u shoqërua me rritjen e katedrave. Gjatë viteve 1957-1991, Instituti i Lartë Pedagogjik në Shkodër, ka qenë qendra kryesore e përgatitjes së mësuesve për arsimin 8-vjeçar, ku janë diplomuar 9 586 mësues, pra, rreth ¼ e numrit të arsimtarëve që kishte Shqipëria në ato vite. Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 28.05.1991 mori statusin ligjor Universitet, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. USH-ja është person juridik publik që financohet nga Buxheti i Shtetit ose vetëfinancohet nga burime të tjera të ligjshme. Aktualisht ky Universitet është i organizuar në 6 fakultete dhe 21 departamente dhe ofron 3 cikle studimi : *cikli i parë i studimeve “Bachelor”, cikli i dytë i studimeve “Master Profesional” ose “Master Shkencor” dhe cikli i tretë “Doktoraturë”*. Sot, USH-ja është ndër universitetet më të mëdha në vend, në të cilin studiojnë studentë nga rrethet e ndryshme të vendit, kryesisht nga Veriu i Shqipërisë, por edhe nga trevat shqiptare, si nga Mali i Zi, Kosova dhe Maqedonia. Ky Universitet ka si mision të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, të kërkimit shkencor dhe të shërbimeve si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet.

Tab.1: Skeda informuese për Universitetin “Luigj Gurakuqi”


| EMRI I INSTITUCIONIT   | UNIVERSITETI “LUIGJ GURAKUQI”   |
|------------------------|---|
| Adresa:                | Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", Rektorat <i>Sheshi 2 Prilli</i> , Shkodër, Albania<br>P.O.BOX 4001  |
| Kontakt:               | <a href="mailto:info@unishk.edu.al">Email-info@unishk.edu.al</a><br>Telefon: +355 (22) 800 651<br>Ëëbsite: <a href="http://www.unishk.edu.al">www.unishk.edu.al</a> |
| Rektor                 | Prof. dr. Suzana Golemi<br>Email- <a href="mailto:suzana.golemi@unishk.edu.al">suzana.golemi@unishk.edu.al</a>  |
| Licensuar:             | VKM Nr. 150, datë 18.04.1957 si Institut i Lartë Pedagogjik   |
| Statusi ligjor aktual: | VKM Nr.124, datë 28.05.1991 si Universiteti “Luigj Gurakuqi”  |

|                   |  |
|-------------------|--|
| Akredituar:       | Vendim i ASCAL, Nr.70, datë 21.09.2017<br>Vendim i ASCAL Nr. 03, datë 24.01.2020   |
| Fakultetet        | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës</li> <li>2. Fakulteti i Shkencave të Edukimit</li> <li>3. Fakulteti i Drejtësisë</li> <li>4. Fakulteti i Shkencave Shoqërore</li> <li>5. Fakulteti i Gjuhëve të Huaja</li> <li>6. Fakulteti Ekonomik</li> </ol> |
| Ciklet e studimit | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Bachelor</li> <li>2. Master Shkencor, Master Profesional</li> <li>3. Doktoraturë</li> </ol>  |

### Organigrama e USH dhe Historiku i fakulteteve

Struktura organizative e USH- së është e publikuar edhe në faqen ëeb të Universitetit (Ref.link). Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” përbëhet nga 6 fakultete dhe 21 departamente.





**Fakulteti i Shkencave të Natyrës** si njësi kryesore e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” e nisi veprimtarinë e vet mësimore dhe shkencore me themelimin e Institutit të Lartë Pedagogjik, më 02 shtator 1957. Në këtë vit u hapën degët Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Gjeografi si programe studimi 2-vjeçare. Në vitin 1970, degët e studimit të ILP-së patën një ristrukturim dhe kohëzgjatja e studimeve u shtri në 3 vite akademike. Dega Biologji-Gjeografi u rikonceptua duke krijuar dy degë të ndryshme: Biologji-Kimi dhe Histori-Gjeografi. Në vitin 1991, fakulteti merr emrin që ka edhe sot, Fakulteti i Shkencave të Natyrës. Dega e Matematikës dhe dega e Fizikës ndahen si degë të veçanta. Aktualisht FSHN-ja, ka në përbërje si njësi bazë katër departamente dhe Qendrën e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës.

**Misioni.** Fakulteti i Shkencave të Natyrës ka si mision përgatitjen dhe formimin cilësor të studentëve në të gjitha ciklet e studimit si dhe kërkimin shkencor në fushat përkatëse, në mënyrë që të shfrytëzojnë burimet dhe kapacitetet e vendit në përputhje të plotë me strategjinë dhe perspektivën e zhvillimit. Rezultatet e frytshme të bashkëpunimit tonë me institucionet e mirënjohura arsimore në Evropë dhe SHBA, japin sigurinë e plotë të një perspektive të qartë të fakultetit tonë.

**Politika e Cilësisë:** Fakulteti i Shkencave të Natyrës u ofron studentëve mundësinë të studiojnë dhe të punojnë me një staf akademik të përkushtuar dhe u ofron programe mësimore bashkëkohore me nivel të lartë shkencor, gjithmonë në ndryshim.

#### **Fakulteti ofron:**

- Promovimin e kërkimit dhe të studimeve të avancuara në fusha të ndryshme teorike, praktike dhe aplikative në biologji-kimi, matematikë, informatikë, fizikë dhe në shkencat mjekësore.
- Promovimin e filozofisë të të mësuarit të studentëve për përgatitjen e tyre për profesione specifike.
- Organizimin e stafit akademik në grupe studimi dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta duke rritur mundësinë e kualifikimit të specializuar të stafit si dhe të bashkëpunimit mes tyre për realizimin e projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me departamente të ngjashme të shteteve të tjera me qëllim nxitjen e bashkëpunimit në drejtimin mësimor e kërkimor.
- Të sigurojë në shumicën e lëndëve projekte grupi dhe projekte individuale që simulojnë situata që do të hasin studentët në ambientet e punës në të ardhmen.
- Përgatitjen e trajnimit të mësuesave të: biologjisë, kimisë, matematikës, fizikës dhe të informatikës në arsimin parauniversitar, si dhe aftësimin e tyre për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit të teknologjisë së informacionit.

- Të nxisë të mësuarit gjatë gjithë jetës duke inkurajuar punën individuale përtej njohurive që zhvillohen në auditorët e shkollës.
- Konsolidimin e mjaft arritjeve të punës shkencore në fushat e studimit të departamenteve, si dhe zgjerimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në fushat mjedisore dhe mjekësore.
- Kualifikimin e punonjësve mësues dhe stafit ndihmës pedagogjik, si dhe përmirësimin e teknikave të mësimdhënies me anë të përdorimit të pajisjeve dhe teknikave audiovizive bashkëkohore.
- Nxitjen e të mësuarit aktiv dhe në mënyrë të pavarur, duke i dhënë përparësi realizimit të punëve laboratorike, praktikave në terren, projekteve të ndryshme, detyrave të kursit dhe sidomos punimeve të diplomave.
- Studentët e diplomuar në programet e studimit të FSHN-së të jenë të aftë të demonstrojnë kompetenca teorike, teknike dhe praktike në shkencat e natyrës dhe mjekësore.

Tab.3: Skeda informuese për FSHN-në

|                   |   |
|-------------------|---|
| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti i Shkencave të Natyrës  |
| Adresa:           | Rruga Jeronim de Rada 12, Shkodër   |
| Kontakt:          | website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a>   |
| Licensuar:        | 2 Shtator 1957 si ILP<br>Në vitin 1991, themelohet si fakultet më vete  |
| Dekani            | Prof. as. Dr. Rrok Smajlaj<br>Email- <a href="mailto:rrok.smajlaj@unishk.edu.al">rrok.smajlaj@unishk.edu.al</a>   |
| Departamentet     | 1. Departamenti i Matematikës<br>2. Departamenti i Fizikës<br>3. Departamenti i Biologji-Kimisë<br>4. Departamenti i Infermierisë                             |
| Ciklet e studimit | 1. Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor)<br>2. Cikli II i studimeve (6 programe studimi Master Profesional dhe 1 program studimi Master Shkencor) |

Tab.4: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHN-ja

| Departamenti   | Programi i studimit                                   | Dokument Licensimi                            |
|----------------|---|---|
| 1.Infermierisë | ➤ Bachelor në Infermieri të përgjithshme (180 ECTS)   | Shkresë MASH Nr. 784/1 prot., datë 05.06.2001 |
|                | ➤ Bachelor në Mami (180 ECTS)                         | Shkresë MASH Nr. 3955 prot., datë 01.06.2007  |
|                | ➤ Bachelor në Fizioterapi (180 ECTS)                  | Shkresë MASH Nr. 3954 prot., datë 01.06.2007  |
|                | ➤ Master Profesional në Psikologji shëndeti (90 ECTS) | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012                |
| 2.Biologji     | ➤ Bachelor në Biologji – Kimi (180                    | VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957             |

|               |   |   |
|---------------|---|---|
| Kimisë        | ECTS)   |   |
|               | ➤ Master Shkencor në Biologji mjedisore (120 ECTS)  | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009                                     |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Biologji – Kimi (120 ECTS)                                   | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008                                     |
| 3.Fizikës     | ➤ Bachelor në Fizikë (180 ECTS)   | Vendim Nr 4/1 i Ministrit, datë 15.01.1999                        |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Matematikë - Fizikë (120 ECTS)                               | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008                                     |
| 4.Matematikës | ➤ Bachelor në Matematikë (180 ECTS)   | VMASH Nr. 4, datë 15.01.1999                                      |
|               | ➤ Bachelor në Informatikë (180 ECTS)  | Shkresë MASH Nr.2571/1 prot., datë 19.07.2002                     |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë (120 ECTS)         | UMASH Nr. 506, datë 8.11.2010                                     |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë (120 ECTS)         | UMASH Nr. 506, datë 08.11.2010                                    |
|               | ➤ Program studimi me karakter profesional Teknik sistemesh dhe rrjetesh kompjuterike (120 ECTS) | VKM Nr. 190, datë 03.07.2020                                      |
|               | ➤ Informatikë në gjuhën angleze   | Urdhër nr. 365, datë 01.07.2022 Nr. prot. 3321/3, datë 08.07.2022 |
|               |   | VKM nr. 459, datë 27.07.2022                                      |
|               | ➤ Biologji-Kimi në gjuhën angleze   | Nr. prot. 4088/2, datë 29.07.2022                                 |
|               | ➤ Specialist i lartë elektrik   | VKM nr. 459, datë 27.07.2022<br>Nr. prot. 4088/2, datë 29.07.2022 |
|               | ➤ MP “Zhvillim programesh të avancuara” (Advanced software development”                         | Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022,                                  |

**Fakulteti i Shkencave të Edukimit** i USH-së, i ka fillesat e tij në vitin akademik 1981 – 1982, me hapjen e programit të studimit për Mësues për klasat I – IV të shkollës 9 – vjeçare (Cikli Ulët). Po në këtë vit akademik u krijua për herë të parë në Universitetin e Shkodrës, katedra e Psikologjisë dhe Pedagogjisë, e cila merret me problemet e degës së Mësuesisë për Ciklin e Ulët.

**Misioni.** Fakulteti i Shkencave të Edukimit ka si mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore për një përgatitje cilësore dhe konkurrente si mësues për arsimin fillor, arsimin parashkollor dhe mësues të edukimit fizik. Synon të përgatisë specialistë të këshillimit psikologjik, të fushës së psikologjisë dhe punonjës socialë. Në fushën e artit synon të përgatisë specialistë në Pedagogjinë muzikore dhe në artet pamore, të aftë për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit e të vendit si dhe në kërkimin shkencor.

**Politika e Cilësisë:** Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioriteteve të zhvillimit të vendit.

**Fakulteti ofron:**

- Kurrikula të pasura dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, (Cikli I dhe Cikli II), në zbatim të Deklaratës së Bolonjës, legjislacionit për Arsimin e Lartë dhe udhëzimeve të MASR, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë e nevojshme praktike.
- Staf akademik të kualifikuar me tituj e grada shkencore, profesionalizëm dhe përkushtim i tij për t’u përballuar me sfidat për përmbushjen e qëllimeve që ka FSHE-ja.
- Nivel të lartë të punës kërkimore - shkencore të pedagogëve dhe të aktivitetit të tyre botues.
- Monitorim i përvitshëm i cilësisë së mësimdhënies.
- Numër të lartë aktivitetesh të realizuara nga pedagogët me studentë (orët e hapura, të ftuar specialistë të fushës).
- Marrëdhënie të ngushtë bashkëpunimi me institucionet e qeverisjes lokale dhe shërbimet e ofruara nga OJF – të, ku zhvillohen praktikat profesionale të studentëve.
- Bashkëpunim të vazhdueshëm të Fakultetit të Shkencave të Edukimit me komunitetin akademik, e më gjerë.

*Tab.5: Skeda informuse për FSHE*

|                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>EMRI I FAKULTETIT</b> | Fakulteti i Shkencave të Edukimit  |
| <b>Adresa:</b>           | Rruga “Kolë Heqimi”, Shkodër   |
| <b>Kontakt:</b>          | Website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a>  |
| <b>Licensuar:</b>        | VKM nr.125, datë 01.09.1991 si Fakultet i Ciklit të Ulët.<br>Vendim Senati nr.117, datë 31.10.2000 si Fakulteti i Shkencave të Edukimit                        |
| <b>Dekani</b>            | Prof. as. Dr. Fatmir Vadohej<br>Email- <a href="mailto:fatmir.vadahi@unishk.edu.al">fatmir.vadahi@unishk.edu.al</a>  |
| <b>Departamentet</b>     | 1. Departamenti Psikologji-Punë Sociale<br>2. Departamenti i Mësuesisë<br>3. Departamenti Edukim fizik dhe sporte<br>4. Departamenti i Arteve                  |
| <b>Ciklet e studimit</b> | 1. Cikli I i studimeve (7 programe studimi Bachelor)<br>2. Cikli II i studimeve (5 programe studimi Master Profesional dhe 3 programe studimi Master Shkencor) |

*Tab.6: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHE-ja*



| Departamenti                | Programi i studimit  | Dokument Licensimi  |
|-----------------------------|--|---|
| 1.Psikologji - Punë Sociale | ➤ Bachelor në Psikologji (180 ECTS)  | Shkresë MASH Nr. 4276 prot., datë 01.07.2004                          |
|                             | ➤ Bachelor në Punë Sociale (180 ECTS)  | VKM Nr.560, datë 12.08.2005   |
|                             | ➤ Master Shkencor në Psikologji klinike (120 ECTS)   | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011  |
|                             | ➤ Master Shkencor në Psikologji organizative (120 ECTS)  | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011  |
|                             | ➤ Master Profesional në Shërbimet sociale (Për vitin akademik 2021-2022)(60 ECTS)                            | VKM Nr. 334, datë 17.09.2021  |
| 2.Mësuesisë                 | ➤ Bachelor në Mësuesi për Arsimin Fillor (180 ECTS)  | VKM Nr.167, datë 28.05.1991   |
|                             | ➤ Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor (180 ECTS)  | VKM Nr.332, datë 13.05.1996   |
|                             | ➤ Master Shkencor në Mësuesi në Biologji-Kimi, me Profil Minor në Karriera dhe aftësimi për jetën (120 ECTS) | VKM Nr. 548, datë 16.08.2012  |
|                             | ➤ Master Profesional në Mësuesi për Arsimin Fillor (120 ECTS)  | VKM Nr.598, datë 07.12.2012   |
| 3.Edukim Fizik dhe Sporte   | ➤ Bachelor në Edukim fizik dhe sporte (180 ECTS)   | Shkresë e MASH-it Nr. 2742 prot., datë 27.04.2006                     |
|                             | ➤ Master Profesional në Mësuesi në lëndët Edukim fizik dhe sporte (120 ECTS)                                 | VKM Nr. 1212, datë 11.12.2009   |
| 4.Departamenti i Arteve     | ➤ Bachelor në Pikturë dhe Grafikë (180 ECTS)   | UMASH Nr. 272, datë 20.07.2015  |
|                             | ➤ Bachelor në Pedagogji muzikore (180 ECTS)  | UMASH Nr. 272, datë 20.07.2015  |
|                             | ➤ Mësues Muzike  | Urdhër nr. 581, datë 04.10.2022, nr. prot. Nr 1701/2, datë 04.10.2022 |
|                             | ➤ Mësues i Artit Pamor   | Urdhër nr. 504, datë 06.09.2022, nr. prot. Nr 5697/1, datë 06.09.2022 |



**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja**, në përberje të të cilit ka tri departamente: i Gjuhës Angleze departamenti i Romanistikës dhe i Gjermanistikës, zhvillon procesin e mësimdhënies dhe kërkimin shkencor në fusha të lidhura me profilet gjuhësore dhe kulturore të njohura dhe të licensuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

**Misioni:** Fakulteti Gjuhëve të Huaja ka si mision formimin e studentëve të nivelit Bachelor me njohuritë më bashkëkohore, duke synuar përgatitjen e tyre si specialistë në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të përkthimit dhe të komunikimit ndërkulturor, aftësimin e studentëve për të kryer punë kërkimore edhe në rrafshet krahasimore mes gjuhës dhe kulturës së studiuar dhe asaj shqipe. formimin e studentëve të nivelit Master Profesional me metodologjitë dhe teknikat më bashkëkohore dhe të njohura në fushën e mësimdhënies dhe mësimnxënies së gjuhës së huaj.

**Politika e Cilësisë:** Të ruajë standardet dhe të zhvillojë më tej rolet dhe synimin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e brezave në funksion të kërkesave për specialistë dhe përkthyes të gjuhëve të huaja.

#### **Fakulteti ofron:**

- Një kurrikul të pasur dhe të larmishme programesh mësimore në të dy nivelet, Bachelor dhe Master profesional, të hartuara me mbështetjen e fortë dhe të qëndrueshme të universiteteve dhe institucioneve partnere evropiane në bashkërendim me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësi për të fituar njohuritë më të përditësuara në fushën akademike dhe aftësitë praktike.
- Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.
- Formim, përkushtim, korrektësi dhe profesionalizëm të stafit akademik të specializuar në universitete perëndimore për të përballuar dhe përmbushur me sukses sfidat dhe detyrimet në përmbushje të misionit të fakultetit dhe për t'u formuar në vazhdimësi.
- Mbështetje nga profesorë dhe personalitete të ftuar, vendas dhe të huaj, nga universitetet partnere që pasurojnë programet e studimit pranë këtij fakulteti, duke bashkëndarë përvojat e tyre me stafet e FGJH-së, përmes leksioneve të hapura dhe konferencave që realizohen me nisma të përbashkëta.
- Ndërthurje të shkëlqyer të njohurive teorike me ato praktike, përmes materialeve autentike që u ofrohen studentëve të nivelit Bachelor dhe praktika që realizojnë studentët Master profesional.
- Bashkëpunime të frytshme me Universitete Evropiane, që ofrojnë mundësi të shkëlqyera studimi përmes akordimit të bursave për studentët dhe përvoja shkëmbimi dhe pasurimi profesional për stafin akademik.
- Ofrimi i bursave semestrale në kuadër të programit Erasmus+ në universitete gjermane dhe italiane
- Mësimdhënie nga lektorë të huaj austriakë, italianë, amerikanë, të cilët ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së studimit akademik.
- Klimë pozitive bashkëpunimi mes stafit akademik dhe studentëve. Në fakultetin tonë mirëpritur studentët e trojeve dhe të huaj me kuota të veçanta.

Tab.2: Skeda informuese për FGJH

|                      |   |
|----------------------|---|
| EMRI I INSTITUCIONIT | Fakulteti I Gjuhëve të Huaja  |
| Adresa:              | Fakulteti I Gjuhëve të Huaja , Rruga Dom Bosko, nr.2,<br>P.O.BOX 4001   |
| Kontakt:             | <a href="mailto:dekanatifgjhush@gmail.com">dekanatifgjhush@gmail.com</a><br>Website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a> |
| Dekani               | Prof. as.dr. edlira Bushati<br>Email- <a href="mailto:edlira.bushati@unishk.edu.al">edlira.bushati@unishk.edu.al</a>  |
| Licensuar:           | VKM Nr. 28, datë 20.01.2001 si Fakulteti i Gjuhëve të Huaja,<br>Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.   |
| Akredituar:          | Vendim i KA, Nr.130/4, datë 16.10.2006  |
| Departamentet        | 7. Departamenti i Gjuhës Angleze<br>8. Departamenti i Romanistikës<br>9. Departamenti i Gjermanistikës  |
| Ciklet e studimit    | 4. Cikli I i studimeve (Bachelor)<br>5. Cikli II i studimevr (Master Profesional)   |

Tab.8: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FGJH-ja

| Departamenti                     | Programi i studimit  | Dokument Licensimi                         |
|----------------------------------|--|--|
| 1. Departamenti i Anglistikës    | ➤ Bachelor në Gjuhë Angleze (180 ECTS)                       | VKM Nr. 300, datë 21.06.1994               |
|                                  | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Angleze (120 ECTS)  | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008              |
| 2. Departamenti I Gjermanistikës | ➤ Bachelor në Gjuhë Gjermane (180 ECTS)                      | Shkresë MASH Nr. 960 prot. datë 11.03.1996 |
|                                  | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Gjermane (120 ECTS) | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008              |
| 3. Departamenti i Romanistikës   | ➤ Bachelor në Gjuhë Frënge (180 ECTS)                        | VKM Nr.560, datë 12.08.2005                |
|                                  | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Frënge (120 ECTS)   | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008              |
|                                  | ➤ Bachelor në Gjuhë Italiane (180 ECTS)                      | VKM Nr. 146, datë 04.08.1998               |
|                                  | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë Italiane (120 ECTS) | VKM Nr. 1333, datë 01.10.2008              |



**Fakulteti Ekonomik** është hapur në shtator të vitit 1993, me Vendim nr. 349, datë 10.8.1992 të MASH -it. Që nga viti 1993 deri në vitin 2000, Fakulteti ka pasur vetëm një degë, atë të Administrim - Biznesit. Ky departament e ka zanafillën si njësi mësimore në përbërjen e Fakultetit të Shkencave të Natyrës së këtij Universiteti. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.332, datë 13.05.1996 Fakulteti i Ekonomisë fitoi statusin e Fakultetit të pavarur brenda Universitetit të Shkodrës. Në vitin 2000, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës u miratua hapja e degës Financë-Kontabilitet dhe në 2001-in ajo e Marketing-Turizmit. Dega e Turizmit implementoi për herë të parë në Fakultetin Ekonomik sistemin sipas Deklaratës së Bolonjës që në vitin akademik 2005- 2006 me mbështetjen e Konferencës së Rektorëve Gjermanë. Në vitin akademik 2008 -2009 të tre degët e Fakultetit Ekonomik kanë filluar procesin mësimor në Nivelin e Parë të Studimeve, sipas Deklaratës së Bolonjës, në sistemin 3 - vjeçar. Në vitin akademik 2009- 2010 në Fakultetin Ekonomik filloi për herë të parë cikli i dytë i studimeve me Masterin Shkencor në Turizëm të qëndrueshëm dhe në vitin 2011 u hapën programet e Masterit Shkencor në specialitetet e Administrim-Biznesit, Financës dhe Kontabilitetit. Në vitin akademik 2012–2013 u hapën tre programe Masteri Profesional në Trashëgimi kulturore dhe Menaxhim turizmi, Masteri Profesional në Administrim-Biznes dhe Masteri Profesional në Financë-Bankë. Ndërkohë në vitin akademik 2018-2019 u hap programi Master Profesional “Menaxhim financiar, kontabilitet dhe kontroll në administratën publike”, në kuadrin e projektit FINAC, i financuar dhe mbështetur nga fondet e Bashkimit Evropian. . Këtë vit, me Urdhër Nr. 174, Dt. 04.04.2022, nr. 1848/4 prot, MAS i akordon Fakultetit Ekonomik të drejtën për të hapur programin e ciklit të tretë, Doktoratë në « Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm ». Me Urdhër të Rektorit të USH-së, Nr.86, Dt.14.11.2022, ky program studimi, po me Dt.14.11.2022, hapi dyert për pranimin e brezit të parë të studentevë.

**Misioni:** Fakulteti Ekonomik ka si mision formimin e studentëve me njohuritë më bashkëkohore duke synuar përgatitjen e tyre, si: menaxherë, financierë, kontabilistë dhe specialistë në fushën e turizmit të aftë për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunitetit e të vendit, si dhe në kërkimin shkencor dedikuar fushës së ekonomisë.

**Politika e Cilësisë:** Të mbajë dhe të zhvillojë më tej rolet dhe funksionin e fakultetit si sigures i cilësisë në arsimimin e të gjitha shtresave në funksion të prioritetëve të zhvillimit ekonomik të vendit.

#### **Fakulteti ofron:**

- Një kurrikulum të pasur dhe të larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike.
- Pjekuri e profesionalizëm, përkushtim i një personeli akademik dinamik për t'i përballuar me sukses sfidat në përmbushje të misionit të fakultetit.
- Mbështetje nga profesorë të ftuar vendas dhe të huaj, të cilët pasurojnë programet tona duke ndarë përvojat e tyre.

- Mundësi kombinimi të vazhdueshëm të njohurive teorike me praktikën profesionale në organizata biznesi, institucione të ndryshme, sipas fushës së studimit.
- Studime universitare që zhvillohen në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.
- Mundësi për të marrë pjesë në programet mësimore të ofruara nga Fakulteti Ekonomik edhe për studentët e trojeve shqiptare.
- Bashkëpunim i FE-së me universitete në Evropë dhe në SHBA për kërkimin shkencor, mobilitete për stafin akademik dhe studentët e këtij fakulteti.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm i FE-së me komunitetin akademik, autoritetet e qeverisjes qendrore e vendore, komunitetin e biznesit dhe OJF-të në realizimin e misionit të tij.
- Fakulteti Ekonomik është i vendosur në zemër të rajonit verior të Shqipërisë, në qytetin e Shkodrës.

Tab.9: Skeda informuese për FE

|                   |  |
|-------------------|--|
| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti Ekonomik   |
| Adresa:           | Sheshi “Dugajte e Reja”, Shkodër   |
| Kontakt:          | Website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a>  |
| Licensuar:        | VKM nr.332, datë 1996  |
| Dekani            | Prof. as. dr. Blerta Dragusha<br>Email- <a href="mailto:blerta.dragusha@unishk.edu.al">blerta.dragusha@unishk.edu.al</a>   |
| Departamentet     | 1. Departamenti i Financë-Kontabilitetit<br>2. Departamenti i Administrim-Biznesit<br>3. Departamenti i Turizmit   |
| Ciklet e studimit | 1. Cikli I i studimeve (3 programe studimi Bachelor)<br>2. Cikli II i studimeve (4 programe studimi Master Profesional dhe 4 programe studimi Master Shkencor)<br>3. Doktoratë në « Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm |



Tab.10: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FE

| Departamenti                | Programi i studimit   | Dokument Licensimi                           |
|-----------------------------|---|--|
| 1.Financë<br>Kontabilitetit | ➤ Bachelor në Financë – Kontabilitet (180 ECTS)   | Shkresë MASH Nr. 4390 Prot., datë 23.10.2000 |
|                             | ➤ Master Shkencor në Kontabilitet (120 ECTS)  | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011               |
|                             | ➤ Master Shkencor në Financë (120 ECTS)   | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011               |
|                             | ➤ Master Profesional në Financë – Bankë (120 ECTS)  | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012               |
|                             | ➤ Master Profesional në Menaxhimi financiar, kontabiliteti dhe kontrolli në administratën publike (60 ECTS) | UMASR Nr. 702, datë 19.10.2018               |
| 2.Administrim - Biznes      | ➤ Bachelor në Administrim – Biznes (180 ECTS)   | VKM Nr. 349, datë 10.08.1992                 |
|                             | ➤ Master Shkencor në Administrim - Biznes (120 ECTS)  | UMASH Nr. 395, datë 10.08.2011               |
|                             | ➤ Master Profesional në Administrim - Biznes (120 ECTS)   | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012               |
| 3.Turizëm                   | ➤ Bachelor në Turizëm (180 ECTS)  | MAS vendim 1803/1, datë 05.06.2001           |
|                             | ➤ Master Shkencor në Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm (120 ECTS)  | VKM Nr. 1370, datë 10.10.2008                |
|                             | ➤ Master Profesional në Trashëgimi kulturore dhe Menaxhim turizmi (120 ECTS)                                | UMASH Nr. 503, datë 18.10.2012               |
|                             | ➤ Doktoraturë në Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm   | Nr.86, Dt.14.11.2022,                        |

**Fakulteti i Shkencave Shoqërore** është një prej themelvënësve të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe e ka gjenezën e tij që në vitin 1957, vit kur u hap për herë të parë Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës. Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 167, datë 28.05.1991, institucioni fitoi statusin e universitetit dhe brenda tij Fakulteti i Shkencave Shoqërore vijoi aktivitetin si njësi e veçantë me dy drejtime studimi: Gjuhë - Letërsi dhe Histori - Gjeografi. Që nga viti 1995 pranë këtij Fakulteti është ngritur dhe funksionon Qendra e Studimeve Albanologjike. Me UMASH Nr.498, datë 07.10.2011 në vitin akademik 2011-2012 u hap shkolla dokto­rale “Gjuhë shqipe”, e cila synon të kryejë studime komplekse në fushë të gjuhësisë, si në rrafshin sinkronik, ashtu edhe në atë diakronik. Studimet albanologjike përbëjnë thelbin dhe veçantinë e të gjitha programeve të studimit të këtij fakulteti. Për disa vite pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore ka funksionuar edhe “Këshilli i Profesorëve” i kësaj njësie, i cili e ka promovuar stafin akademik me titujt “Profesor i asocuar” dhe “Docent”.


**Misioni:** Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka si mision formimin dhe kualifikimin e studentëve në të gjitha ciklet, përgatitjen e specialistëve në fushën e gjuhësisë, të letërsisë, të historisë, të gjeografisë, të gazetarisë, por edhe të disiplinave të përafërta kulturore, si: redaktorë gjuhësorë dhe letrarë, punonjës biblioteke, ciceronë muzesh dhe guida turistike, zëdhënës shtypi e specialistë të sektorit të komunikimit. Gjithashtu ky fakultet përmes programeve të studimit Master Profesional në Mësuesi synon formimin e mësuesve të kualifikuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Përmes programeve të studimit Master Shkencor dhe Doktoraturë synohet formimi i specialistëve të profilit të lartë në fushat e sipërpërmendura, si: pedagogë, studiues e kërkues shkencorë. Sot Fakulteti i Shkencave të Shoqërore ka 36 pedagogë, prej të cilëve 5 mbajnë titullin “Profesor”, 8 “Profesorë të asocuar”, 18 “Doktorë”, 2 “Docentë” dhe 3 pa tituj e grada.

**Politika e Cilësisë:** Fakulteti i Shkencave Shoqërore kujdeset dhe shquhet për cilësinë e studimeve në arsimin e lartë në të gjitha ciklet. Ai vepron në fushën e formimit kulturor dhe profesional, duke synuar arritjen e standardeve të larta dhe konkurruese në profilet e përmendura në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar, si dhe kujdeset për formimin dhe përditësimin e njohurive.

#### **Fakulteti ofron:**

Programe studimi në të dy ciklet për të gjitha profilet e studimit, ndërsa për Gjuhën shqipe edhe në nivel doktorature.

- Kurrikula të larmishme dhe të përditësuara që u japin mundësi studentëve të përballen dhe të jenë të suksesshëm në tregun e punës.
- Staf akademik të kualifikuar brenda dhe jashtë vendit, me përvojë akademike, që ofron një mësimdhënie bashkëkohore.
- Personalitete me kontribute të veçanta nga fushat kërkimore që mbulojnë dhe bashkëpunim në kërkimin shkencor.



- Përfshirjen e të gjithë stafit të fakultetit jo vetëm në procesin mësimor, por edhe në kërkimin shkencor përmes botimeve me vlerë konkurruese në nivel kombëtar, në fushat përkatëse.
- Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
- Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional e shkencor të studentëve.
- Lidhje të teorisë me praktikën përmes ekspeditave, praktikave profesionale, laboratorëve dhe punëve praktike.
- Mobilitet të studentëve në kuadrin e projekteve të ndryshme ndërkombëtare.
- Bashkëpunim me fakultetet simotra brenda dhe jashtë vendit, si dhe me qendra të rëndësishme kërkimore-shkencore

Sot Fakulteti i Shkencave të Shoqërore ka 36 pedagogë, prej të cilëve 5 mbajnë titullin “Profesor”, 8 “Profesorë të asocuar”, 18 “Doktorë”, 2 “Docentë” dhe 3 pa tituj e grada.

Tab. 13: Skeda informuese për FSHSH-në

|                   |  |
|-------------------|--|
| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti i Shkencave Shoqërore  |
| Adresa:           | Rruga “Jeronim de Rada” 4, Shkodër   |
| Kontakt:          | Website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a>  |
| Licensuar:        | VKM nr.167, datë 28.03.1991  |
| Dekani            | Prof. dr. Artan Haxhi<br>Email- <a href="mailto:artan.haxhi@unishk.edu.al">artan.haxhi@unishk.edu.al</a>   |
| Departamentet     | 1. Departamenti i Gjuhësisë<br>2. Departamenti i Letërsisë<br>3. Departamenti i Historisë<br>4. Departamenti i Gjeografisë   |
| Ciklet e studimit | 1. Cikli I i studimeve (4 programe studimi Bachelor)<br>2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Profesional dhe 3 programe studimi Master Shkencor)<br>3. Cikli i III i studimeve (Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”) |



Tab.14: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FSHSH

| Departamenti  | Programi i studimit  | Dokument Licensimi                           |
|---------------|--|--|
| 1.Gjuhësisë   | ➤ Bachelor në Gjuhë – Letërsi (180 ECTS)   | VKM Nr.150 prot., datë 18.04.1957            |
|               | ➤ Doktoraturë në “Gjuhë shqipe”  | UMASH Nr.498, datë 07.10.2011                |
| 2.Letërsisë   | ➤ Bachelor në Gazetari dhe Komunikim (180 ECTS)  | Shkresë MASH Nr. 2743 prot., datë 27.04.2006 |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi në Gjuhë – Letërsi (120 ECTS)  | VKM Nr. 1291, datë 24.09.2008                |
|               | ➤ Master Shkencor në Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Studime të Thelluara në Gjuhësi” (120 ECTS)                     | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009                 |
|               | ➤ Master Shkencor në Studime shqiptare dhe etnokulturore, profili “Etnokultura dhe Letërsia Shqipe” (120 ECTS)                     | VKM Nr. 619, datë 11.06.2009                 |
| 3.Historisë   | ➤ Bachelor në Histori-Gjeografi me drejtim Histori (180 ECTS)  | Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006 |
|               | ➤ Bachelor në Histori dhe trashëgimi kulturore (Për vitin akademik 2021-2022) (180 ECTS)   | VKM Nr. 272, datë 21.07.2021                 |
| 4.Gjeografisë | ➤ Bachelor në Histori-Gjeografi me drejtim Gjeografi (180 ECTS)  | Shkresë MASH Nr. 1127 prot., datë 20.02.2006 |
|               | ➤ Master Shkencor Studime Regjionale në Gjeografi (120 ECTS)   | UMASH Nr. 212, datë 31.05.2013               |
|               | ➤ Master Profesional në Mësuesi Histori – Gjeografi (120 ECTS)   | VKM Nr.1212, datë 11.12.2009                 |
|               | ➤ Programi studimi me karakter profesional Udhërrëfyes turistik dhe Menaxhues i itinerareve turistike për Rajonin Verior (60 ECTS) | VKM Nr.196, datë 03.07.2020                  |
|               | ➤ Gjeografi dhe zhvillim territor  | VKM nr. 440, datë 20.07.2022                 |
|               |  | Nr. prot. 4872/1, datë                       |

|  |   |                                 |
|--|---|---------------------------------|
|  |   | 25.07.2022                      |
|  | ➤ Studime të Historisë dhe kulturës Shqiptare | Urdhër Nr. 583, datë 04.10.2022 |

**Fakulteti i Drejtësisë** u hap me VKM nr.332, datë 13.05.1996, ndërsa studimet e larta në Drejtësi në Universitetin e Shkodrës u hapën me VKM nr.349, datë 10.08.1992 “*Për hapjen e degës së Drejtësisë dhe Administrim-Biznesit në Universitetin “Luigj Gurakuqi” në Shkodër*”. Aktualisht ofron 4 programe studimi. Ai përbëhet nga 3 departamente: departamenti i të Drejtës publike, departamenti i të Drejtës civile dhe departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe evropiane. Me VKM Nr. 191, datë 03.07.2020 është hapur Programi i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi me kohëzgjatje 5-vjeçare. Diplomat e lëshuara nga ky fakultet njihen prej vitesh në universitete të ndryshme, si p.sh., ato evropiane dhe amerikane.

**Misioni:** Fakulteti i Drejtësisë ka si mision t’u ofrojë studentëve njohuri të përgjithshme dhe specifike profesionale dhe shkencore në përshtatje me tregun e punës në fushën e të drejtës për:

- shkollën e magistraturës,
- nëpunës civilë gjyqësorë,
- administratën publike dhe administratën gjyqësore,
- profesionet e lira.

Ndër objektivat formuese është mundësia e aftësisë së studentëve për zbatimin dhe interpretimin e legjislacionit, për hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.

**Politika e Cilësisë:** Fakulteti i Drejtësisë synon rritjen e cilësisë së arsimimit të studentëve nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënies me metoda bashkëkohore dhe staf të kualifikuar në universitetet perëndimore.

**Fakulteti ofron:**

- Një kurrikulum të pasur dhe të larmishëm programesh mësimore në të dy ciklet e studimeve, në përputhje me nevojat e tregut, që u siguron studentëve mundësinë për të fituar njohuritë e fundit akademike dhe aftësitë praktike për hartimin e akteve ligjore si juristë në administratën gjyqësore, publike e private, në aftësimin për argumentim të përshtatshëm për zgjidhjen e çështjeve juridike të përgjithshme dhe të veçanta të nevojshme për specialitetin përkatës në tregun e punës.
- Një kurrikul në bashkërendim me kërkesat dhe parimet evropiane që mundëson lëvizshmërinë e studentëve në programe studimi jashtë vendi me mundësi ekuivalentimi.

- Infrastrukturë mbështetëse për studentët, mjedise me hapësira të përshtatshme dhe teknologji bazë, pajisje dhe programe kompjuterike, internet, bibliotekë universitare etj.
- Bashkëpunim të ngushtë student-pedagog dhe mbështetje të vazhdueshme për formimin profesional të studentëve.

Tab.11: Skeda informuese për Fakultetin e Drejtësisë

|                   |   |
|-------------------|---|
| EMRI I FAKULTETIT | Fakulteti i Drejtësisë  |
| Adresa:           | Rruga “Jeronim de Rada” 12, Shkodër   |
| Kontakt:          | Website: <a href="http://www.unishk.edu.al/Fakultetet">www.unishk.edu.al/Fakultetet</a>   |
| Licensuar:        | VKM nr.332, datë 13.05.1996   |
| Dekani            | Dr. Gasper Kokaj<br>Email- <a href="mailto:gasper.kokaj@unishk.edu.al">gasper.kokaj@unishk.edu.al</a>                                   |
| Departamentet     | 1. Departamenti i të Drejtës ndërkombëtare dhe Evropiane<br>2. Departamenti i të Drejtës publike<br>3. Departamenti i të Drejtës civile |
| Ciklet e studimit | 1. Cikli I i studimeve (1 programe studimi Bachelor)<br>2. Cikli II i studimeve (3 programe studimi Master Shkencor)                    |

Tab.12: Skeda informuese për programet e studimit që ofron FD

| Programi i studimit  | Dokument Licensimi   |
|--|--|
| ➤ Program i Integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në Drejtësi (300 ECTS) | VKM Nr. 191, datë 03.07.2020   |
| ➤ Bachelor në Drejtësi (180 ECTS)  | VKM Nr. 349, datë 10.08.1992   |
| ➤ Master Shkencor E Drejta kushtetuese dhe administrative (120 ECTS)             | VKM Nr. 682, datë 25.08.2010   |
| ➤ Master Shkencor E Drejta private dhe e biznesit (120 ECTS)                     | VKM Nr. 1162, datë 25.11.2009  |
| ➤ <b>Master i shkencave ne Drejtësi (5 vjeçar)PIND</b>                           | Urdhër nr. 191, datë 03.07.2020<br>Nr. prot. 2329/2, datë 03.07.2022 |

## Vetëvlerësimi përkundrejt fushave të vlerësimit për Akreditimin Institucional

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksonimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 24.01.2020, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, me **vendim nr. 03, datë 24.01.2020 vendosi për Akreditimin Institucional të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, me kohëzgjatje për 4(katër) vite deri më 23/01/2024 me 5 rekomandime për t’u përmbushur nga USH-ja.**

### **Rekomandimet janë:**

1. Institucioni, të sigurojë një rrjedhje më të mirë të informacionit nga nivelet e sipërme të menaxhimit tek ato të ulëta, dhe anasjelltas.

Në kuadër të këtij rekomandimi, USH-ja ka marrë masat e duhura për pajisjen me një e-mail zyrtar nga platforma Microsoft office 365 (@unishk.edu.al) të gjithë stafin administrativ, stafin akademik me kohë të plotë dhe atë me kohë të pjesshme si dhe ka krijuar grupet e pedagogëve shifat.departamente@unishk.edu.al , dekanet@unishk.edu.al etj. Kështu rrjedhja e informacionit bëhet në mënyrë periodike dhe në kohë reale duke pasqyruar informacionin e marrë nga ministria apo agjensitë përkatëse tek fakultetet dhe departamentet, si dhe tek vetë pedagogët. Përveç informacionit periodik dhe njoftimeve në faqen zyrtare të Universitetit, projekt-vendimet dhe raportet e takimeve u dërgohen qoftë në mënyrë protokollare dhe qoftë online nga nivelet e sipërme të menaxhimit deri tek ato më të ulëta.

2. Institucioni, të mundësojë autonominë financiare në nivelin e njësisive bazë.

Në lidhje me përmbushjen e këtij rekomandimi mungojnë aktet nënligjore përkatëse për ta realizuar.

3. Institucioni, të sigurojë mbulimin e ngarkesës mësimore në programet e studimit të ciklit të parë nga staf akademik efektiv në masën të paktën 70%.

Për përmbushjen e këtij rekomandimi, gjatë vitit akademik 2021-2022 janë rekrutuar 10 pedagogë me kohë të plotë. Ndarja e pedagogëve sipas fakulteteve është:

- Tek Fakulteti i Shkencave të Edukimit janë rekrutuar 5 pedagogë me kohë të plotë
- Tek Fakulteti i Drejtësisë janë rekrutuar 2 pedagogë me kohë të plotë;
- Tek Fakulteti i Shkencave Shoqërore është rekrutuar 1 pedagog me kohë të plotë.
- Tek Fakulteti i Gjuhëve të Huaja është rekrutuar 1 pedagog me kohë të plotë.

Bazuar në të dhënat e mësipërme po eidentojmë programet e studimit që nuk e plotësojnë mbulimin me PAE në masën 70%:

Fakulteti Ekonomik

- BA në Administrim – Biznes 67%
- Fakulteti i Shkencave të Natyrës
- BA në Infermjeri 51.1%,
- BA në Fizioterapi 60.60%,
- BA në Mami 49.9%
- MP në Psikologji Shëndeti 63.5%.
- MP në Mësuesi në Matematikë me Profil Minor në Informatikë 54% ,
- MP në Mësuesi në Informatikë me Profil Minor në Matematikë 55%,
- Fakulteti i Shkencave Shoqërore
- Programi studimi me karakter professional “Udhërrëfyes Turistik dhe Menaxhues i Itinerareve Turistike për Rajonin Verior” 55%
- Fakulteti i Shkencave të Edukimit
- BA në Punë Sociale 63.50%
- MSH në Psikologji organizative 67.20%

4. Institucioni, të gjejë mënyra më efektive për shpërndarjen e buxhetit për kërkim shkencor.

Tek buxheti i Universitetit është parashikuar fondi për kërkimin shkencor, por nuk ka një bazë ligjore të qartë për mënyrën e shpërndarjes së këtij fondi. Me vendim Senati Nr.301, datë 04.10.2021 është vendosur që të shpërndahet shuma e parashikuar në buxhet të zëri për shpenzime për pjesëmarrjen në konferenca (kërkim shkencor) në mënyrë të barabartë për çdo njësi kryesore për vitin akademik 2020-2021(Evidenca 1.2) dhe sistematikisht pedagogët janë rimbursuar prej dy vitesh tashmë për botime në revista shkencore dhe pjesëmarrje në konferenca të EU/OECD. Evidentimi i procedurave të alokimit të buxhetit për kërkimin shkencor është arritur në masën 100%. Tashmë ky rekomandim i ASCAL është shndërruar në pikë të fortë të USH.

5. Institucioni, të riorganizojë ambientet ekzistuese të stafit akademik, në mënyrë që të rriten standardet teknike për hapësirat e punës dhe gjithashtu të sigurojë dritën natyrale.

Është bërë riorganizim i disa zyrave në ato fakultete ku ka pasur hapësira për të bërë lëvizje të tilla, si psh për departamentin e Edukimi Fizik dhe Sportet dhe për departamentin e Infermieri- Fizoterapi.

# I – INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË, MENAXHIMI, AUTONOMIA DHE SIGURIMI I CILËSISË

## **Standardi I.1 Institucioni dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit.**

USH e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore bazuar në aktet ligjore në fuqi, në Statutin e USH-së dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet qeverisëse të USH-së.

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" ka të miratuar me Vendim të Senatit nr prot. 690, nr.116, datë 18.05.2010 "Rregulloren e brendshme të administratës së Universitetit". Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë administrative të USH-së nëpërputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj. Kjo rregullore i ka bazat juridike në Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, në Ligjin për arsimin e lartë, Ligjin nr.9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe në Statutin e USH-së. Aktualisht, strukturat drejtuese të USH-së po përfundojnë "Rregulloren" e re të administratës e cila bazohet në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Statuti i USH-së është rifreskuar dhe miratuar me Vendim të Senatit nr. Prot. 725, datë 02.03.2018 (Ref. Link) (Evidenca 1.1). Statuti është hartuar në zbatim të Nenit 33 në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe është zbatim konkret i këtij ligji si dhe i gjithë legjislacionit tjetër në fuqi për arsimin e lartë.

Në Statutin e USH-së është përcaktuar qartë misioni i USH-së, autonomia, liria akademike, paprekshmëria, organizimi, strukturat përbërëse të tij, veprimtaritë e autoriteteve dhe organeve drejtuese, zgjedhja dhe emërimi i tyre, nivelet e delegimit të kompetencave nga autoritetet drejtuese dhe administrative, periudhat e kryerjes së vlerësimit të brendshëm të strukturave ose të programeve të studimit, detyrat dhe të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik, administrativ dhe të studentëve, si dhe çështje të tjera që rregullojnë veprimtarinë e institucionit. Veprimtaria mësimore, kërkimore-shkencore dhe ajo administrative të Fakulteteve të USH-së janë në përputhje të plotë me LAL 80/2015 dhe statutin e USH-së. Fakultetet kanë hartuar edhe rregulloret e tyre ku janë përfshirë aktet që rregullojnë ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi në mbarëvajtjen e programit të studimit. Në këto rregullore përcaktohet roli i drejtuesit të njësisë bazë dhe koordinatorit të programit të studimit. Bazuar në sa më sipër janë hartuar edhe rregulloret e brendshme të departamenteve.

Evidence 1.1 Statuti

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/dokumenta\\_unishk/Statuti\\_USH\\_qershor\\_2018.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/dokumenta_unishk/Statuti_USH_qershor_2018.pdf)

Evidence 1.2 Rregullore e administrates

Evidence 1.3 Rregullore e Fakultetit



Evidence 1.4. Rregullore e Departamentit.

Evidence 1.5 Rregullore e programeve të Studimit.

**Standardi I.2 Institucioni organizohet në mënyrë të tillë që të sigurojë eficiencë në menaxhim.**

Universiteti është i organizuar në fakultete, departamente dhe qendra kërkimore në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Strukturat menaxhuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. Stafii akademik ka kualifikimet e duhura shkencore dhe gëzon liri të plotë akademike në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera akademike.

Aktualisht USH përbëhet nga 6 Fakultete: Fakulteti i Shkencave Shoqërore, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Fakulteti Ekonomik, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Drejtësisë, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja si dhe dy Qendra kërkimore: Qendra e Studimit të Ujërave të Rajonit të Shkodrës, e atashuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, si dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, e atashuar pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore. Qendra kërkimore të njohura më përpara si Institute kërkimore janë reformuar në Qendra kërkimore në bazë të ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Universiteti i Shkodres “Luigj Gurakuqi” është i pajisur me faqen ëeb [ëëë.unishk.edu.al](http://ëëë.unishk.edu.al). Në ëëbsite-in e USH-së jepet informacion në lidhje me programet e studimit që ofron USH, planet mësimore, informacion në lidhje me stafin akademik, çdo relacion i mbledhjeve të rektoratit, vendime të Senatit Akademik, vendime të Bordit të Administrimit. Çdo aktivitet i cili ndodh në USH pasqyrohet në kohë reale në faqen zyrtare. (<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/>)

Në këtë drejtim USH dhe fakultetet kanë punuar mjaft mirë në promovimin e aktiviteteve të stafëve dhe studenteve në rrjetet sociale. USH dhe fakultetet si pjesë integrale e tij, disponojnë në rrjete sociale llogaritë e tyre për promovimin e fakultetit. Këto llogari administrohen nga stafet e fakulteteve, ku pasqyrohen të gjitha njoftimet e rëndësishme për studentët dhe pedagogët si edhe aktivitetet e arritjet e ndryshme të fakultetit.

**Evidence 1.6 Raport mbi faqen e facebookut te FE-se**

**Standardi I.3 Institucioni harton një strategji zhvillimi.**

Universiteti ka një Strategji Zhvillimi e cila është e miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr.115, datë 31.05.2022 “Për miratimin e Strategjisë së zhvillimit të USH-së” Senati akademik miratoi Strategjinë e zhvillimit të USH-së. Strategjia është hartuar nga një grup pune me profesorët më me eksperiencë në USH i caktuar me urdhër nga Rektori. Strategjia e USH-së është diskutuar gjerësisht, nga organet dhe autoritetet drejtuese të tij. USH ka një strategji zhvillimi me afat katërvjeçar. Strategjia përfshin periudhën 2022-2026, ku janë përfshirë disa iniciativa dhe projekte konkrete të propozuara nga USH, të cilat përkojnë me drejtimet e secilit Fakultet të USH-së.



#### **Evidencë 1.7 Strategjia e USH-së, 2022-2026**

Me vendim Nr.79, datë 25.03.2022 "Për miratimin e Strategjive sektoriale në USH" Senati akademik ka miratuar Strategjinë e komunikimit dhe informimit publik, Strategjinë e mësimdhënies, Strategjinë e kërkimit shkencor dhe Strategjinë e ndërkombëtarizmit.

#### **Evidencë 1.8 Strategji sektoriale në USH**

Me Vendim Nr.93, datë 13.04.2022 "Për miratimin e Strategjisë sektoriale të tregut të punës në USH" Senati akademik miratoi Strategjinë sektoriale të tregut të punës

#### **Evidencë 1.9 Strategjive sektoriale e tregut të punës në USH**

Pas miratimit të këtyre strategjive, edhe Fakultetet kanë përgatitur strategjinë e zhvillimit të tyre, në përputhje me misionin e tij dhe me objektivat dhe platformën e zhvillimit të USH-së .

#### **Evidencë 1.10 Strategjinë e zhvillimit të FSHE**

#### **Standardi I.4 Institucioni respekton kufijtë e autonomisë së tij.**

Autonomia e USH-së është e rregulluar me ligj dhe institucioni i përmbahet kufijve të kësaj autonomie. USH zgjedh organet dhe autoritetet e veta drejtuese. USH ka instaluar në Drejtorinë e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila monitoron kufijtë e autonomisë akademike dhe administrative. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në USH është ngritur bazuar në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Ajo vlerëson efikasitetin e veprimtarive mësimore, kërkimore të institucionit bazuar në Ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe në bazë të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018. Cdo semester kjo zyrë harton, shpërndan dhe analizon Pyetesoret Studentor. Për të mbështetur NJSCB-në dhe procesin e vlerësimit të brendshëm, Rektorati urdhëron krijimin e një komisioni Ad hoc për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, si dhe njësitë kryesore kanë të instaluar NJSBC në nivel Fakulteti dhe NJSBC në nivel programi studimi ku është i përfshirë dhe një ekspert i jashtëm i fushës. USH është organizuar në mënyrë të tillë që të përfitojë financime nga programet evropiane dhe më gjerë. Në strukturën e USH-së është ngritur Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, i cili aplikon vazhdimisht në projekte, paraqet projekt-propozime si partner me institucione të tjera. Në mënyrë të vazhdueshme fakultetet kanë përfituar financime dhe vazhdojnë të përfitojë nga pjesëmarrja në këto projekte.

Evidencë 1.11 Vendim për Zyrën e Sigurimit të Cilësisë

Evidencë 1.12 Vendim për Komisionin Ad-hoc për RVB

Evidencë 1.13 Vendim NJSBC në Fakultete

Evidencë 1.24 Analizë e pyetesorit të studenteve në USH nga Zyra e Sigurimit të cilësisë

#### **Standardi I.5 Institucioni favorizon debatin konstruktiv.**

USH vë në veprim këshillat e tij të organizuar sipas niveleve ku përmendim Bordin e Administrimit, Këshilli i Etikës, Dekanati dhe Komisionet. Këshillat luajnë rol tepër të rëndësishëm në dhënien e mendimeve, propozimeve dhe marrjen e vendimeve. Të gjitha



propozimet, mendimet dhe vendimet që ndërmerren nga këshillat e lartpërmendur u përcillen autoriteteve drejtuese. Një rol po aq të rëndësishëm luan edhe personeli akademik i cili përfshihet në debatin e brendshëm sipas procedurave institucionale të parashkuara në statut.

Materialet për diskutim përgatiten dhe vihen në dispozicion të anëtarëve të organeve kolegjiale, përpara marrjes së vendimeve. Senati dhe organet kolegjiale mblidhen periodikisht sipas përcaktimeve në Statutin e USH-së, dhe informacioni për pikat e rendit të ditës shpërndahet paraprakisht tek të gjithë anëtarët në mënyrë elektronike. Senati Akademik i USH-së mblidhet periodikisht, si rregull, 1 herë në muaj. Bordi i Administrimit, si rregull, mblidhet të paktën një herë në dy muaj, ndërsa organet e tjera sipas nevojave. Gjatë takimeve, anëtarët e këtyre organeve debatojnë në mënyrë konstruktive, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët. Mendimet dhe propozimet e Senatit Akademik dhe organeve kolegjiale janë vendime për zbatim. Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme procesin e zbatimit të tyre.

Fakultetet favorizojnë debatin konstruktiv, duke filluar që nga njësia bazë deri tek dekanati nëpërmjet: mbledhjeve, axhendat e të cilave bëhen të ditura paraprakisht, duke i dhënë mundësi pjesëtarëve t'i mendojnë paraprakisht, para se t'i shqyrtojnë dhe t'i diskutojnë në mbledhjet përkatëse të Departamenteve, apo të dekanatit. E njëjta frymë diskutimi është edhe në Fakultet (rregullorja e Fakultetit miratohet vetëm me 2/3 e votave të Asamblesë së personelit akademik). Po kështu edhe në grupet e vetëvlerësimit ka diskutim, pasi ka të pranishëm studentë dhe ekspertë të jashtëm, të cilët gjenerojnë ide, me qëllim përmirësimin e cilësisë.

Evidencë 1.14 Vendim mbledhje departamenti FSHSH

Evidencë 1.12 Vendim per Komisionin Ad-hoc për RVB

#### **Standardi I.6 Institucioni publikon veprimtarinë kryesore të organeve kolegjiale, raportin vjetor dhe aspekte të tjera të lidhura me transparencën.**

Raporti vjetor i USH-së paraqitet çdo vit në fund të vitit akademik. Raporti përgatitet nga Rektorati dhe paraqitet përpara Senatit Akademik. Ai pasqyron veprimtarinë dhe aktivitetet e brendshme, si dhe veprimtaritë e jashtme të institucionit. Prej tre vitesh këtij raporti i është shtuar dhe raportimi mbi Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në USH, i cili hartohet nga një grup pune, ku është pjesëtar një ekspert i jashtëm. Raporti ndihmon në vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit, për vetë faktin se përmban një analizë të hollësishme që vjen si rezultat i analizave të veçanta të çdo fakulteti, dhe këtu pasqyrohen të gjitha arritjet dhe problematikat e institucionit si një i tërë. Çdo fakultet paraqet raportet/analizat e tij, të cilat shërbejnë si bazë për të hartuar raportin/analizën e USH-së.

Raporti i veprimtarisë së USH-së paraqitet pranë MASR. Raporti, pas dërgimit në MASR, publikohet në faqen zyrtare të USH-së, sipas detyrimeve ligjore në fuqi.

Krahas raporteve të punës kërkimore-shkencore, çdo vit hartohen, diskutohen dhe miratohen në mbledhjet e departamenteve dhe ato të dekanatit edhe RVB-të e programeve të studimit, të cilat pasqyrojnë ecurinë dhe problematikat e tyre. Këto raporte hartohen dhe paraqiten nga grupet

përkatëse të përzgjedhura në mbledhjet përkatëse të departamenteve.

Evidencë 1.15 Raporti i punës mësimore shkencore 2020-2021

Evidencë 1.16 Relacion mbledhje depar. ose dekanati për miratimin e RVB-ve

**Standardi I.7 Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programe e studimit që ofron.**

Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një preokupim kryesor për të gjitha fakultetet. Në fakultete janë ngritur NjSBC-ja e Fakultetit. GVB-të përkatëse hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departamentet përkatëse, më pas në dekanat.fakultetet organizojnë pyetësorë me studentët në mënyrë të vazhdueshme.

Në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, dekanati, me Vendim Nr.61, datë 06.11.2020, ka miratuar një pyetësor për të marrë mendimet e studentëve të sapodiplomuar. Të dhënat e përfuara analizohen dhe hartohet relacioni përkatës, i cili diskutohet dhe miratohet në dekanat (Evidenca 1.26).

Evidence 1.17 RVB programi studimi

Evidencë 1.18 Analizë e pyetësorëve të studentave të sapodiplomuar


**Standardi I.8 Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Fakultetet e Ush-së bëjnë përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofron. Krahas analizës vjetore të punës mesimore-shkencore, në fillim të vitit akademik secili departament miraton, në një mbledhje të veçantë, sylabuset e lëndëve që mbulon, duke raportuar ndryshimet e bëra dhe arsyet përkatëse. Gjithashtu, tashmë është kthyer në një traditë për fakultetet marrja e mendimit të studentëve që diplomohen përmes pyetësorëve ose fokus grupeve.

Fakultetet organizojnë rregullisht seanca orientuese dhe informuese çdo fillim semestri, përmes të cilave, departamentet japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve. Studentëve u ofrohet informacioni i nevojshëm on-line përmes faqes zyrtare të Universitetit. Në ambientet e fakulteteve ka kënde të posaçme (në korridore të fakultetit) që bëjnë të njohur, krahas njoftimeve të tjera, edhe programet e studimeve dhe orarin mësimor. USH-ja, gjithashtu, mban kontakte me ZVA-in dhe drejtuesit e shkollave të mesme. Në këtë kuadër USH-ja organizon "Ditët e hapura" në shkollat e mesme të qytetit të Shkodrës dhe më gjerë, me qëllim njohjen e maturantëve me programet e studimit që ofron.

Hapja e programeve të reja të studimit bazohet në VKM, Udhëzimet e MAS dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi në lidhje me kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për hapjen dhe riorganizimin e programeve të studimit.

Gjatë këtij viti akademik në Ush janë hapur 9 programe studimi.



1. Bachelor në “ Gjeografi dhe Zhvillim Territori”
2. Bachelor në ” Informatikë “në Gjuhën Angleze
3. Bachelor në ” Biologji- Kimi “në Gjuhën Angleze
4. Master profesional në “ Mësues Muzike”
5. Master profesional në “ Mësues I Artit Pamor”
6. Master profesional në “ Zhvillim programesh të avancuara”
7. Master I Shkencave në “ Studime të historisë dhe kulturës shqiptare”
8. Program studimi me karakter profesional “ Specialist I Lartë Elektrik “
9. Doktoratë në “ Ekonomi dhe turizëm të qëndrueshem”

Për politikën e pranimit të studentëve vendas dhe të huaj, USH-ja zbaton udhëzimet e dërguara nga MASR dhe Statutin e USH-së.

Programet e studimeve përmirësohen duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët, kjo arrihet në bazë të analizës SËOT që parashikon çdo RVB. RVB-të bëhen objekt diskutimi dhe miratimi në departamentet përkatëse dhe më pas kalojnë në Dekanat e në Rektorat. Testimi i aftësive të studentëve mbështetet në Rregulloret e studimit të USH-së miratuar nga SA i USH-së me Vendim nr.182, Dt. 28.05.2019 .

Evidence 1.19 Ditët e hapura FE

Evidence 1.20 Lista e programeve të reja të hapura në USH viti akademik 2021-2022

**Standardi I.9 Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.**

USH përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.

Programet e studimit promovojnë vlerat dhe praktikën më të mirë të arsimit të lartë në funksion të rritjes së cilësisë së jetës shoqërore dhe ekonomike në vend.

Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të rajonit. Aftësimi i studentëve zë vend të rëndësishëm në objektivat e strategjisë. Tek Strategjia e USH-së 2022-2026 janë përcaktuar dhe prioritetet kryesore për periudhën 2022-2026, si: mësimdhënia dhe studentët, kërkimi shkencor, ndërkombëtarizimi, impakti rajonal, qëndrueshmëria. Janë miratuar në Senat “Strategjitë Sektoriale”, si: Strategjia e ndërkombëtarizimit të Universitetit, Strategjia sektoriale e kërkimit dhe inovacionit, Strategjia e komunikimit dhe informimit publik dhe Strategjia e studimit të tregut të punës etj., që kanë përcaktuar qëllime dhe objektiva specifike edhe në drejtim të aftësimi të studentëve. Në përputhje me strategjinë e USH-së 2022-2026 janë hartuar edhe

strategjitë e fakulteteve. Me vendim të SA nr.79 datë 25.03.2022 janë miratuar strategjitë sektoriale në USH (E vlefshme tek:[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim\\_nr\\_79\\_dt\\_25-03-2022.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim_nr_79_dt_25-03-2022.pdf)) Po kështu është miratuar me vendim SA nr 93 datë 13.04.2022 'Strategjia sektoriale e tregut të punës (E vlefshme tek '[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim\\_nr\\_93\\_dt\\_13-04-2022\\_Strategjia\\_tregut\\_te\\_punes.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim_nr_93_dt_13-04-2022_Strategjia_tregut_te_punes.pdf))

Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Në programet e studimeve janë të paraqitura\ rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e studimeve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore.

Fakultetet përpiqen të monitorojnë punësimin e të diplomuarve të tyre ndër vite, zakonisht një vit pas diplomimit, mundësuar me ndihmën e Zyrës së këshillimit të karrierës dhe Alumnit. Në kuadër të akreditimit të programeve të studimit, departamentet e Fakulteteve që do të përfshihen në këtë proces kanë realizuar një studim të tregut të punës i cili i ndihmon ata të vendosin përparësi në programet e studimit bazuar në nevojat e rajonit<sup>1</sup>.

#### **Evidence 1.21 Strategji e FE**

#### **Evidence 1.22 Studim i tregut të punës FE**

**Standardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e mara në vijim të tyre.**

Departamentet angazhohen në proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultete. Në departamente janë të krijuara grupet e punës për hartimin e RVB-ve të programeve të studimit dhe në përbërje të këtyre grupeve janë të përfshirë pedagogë, studentë dhe ekspertë të fushës.

USH bën përpjekje për të vlerësuar përvojat e fituara. Në fakultete është ngritur dhe funksionon Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) për programet e studimit e cila bën vlerësimin për aspekte të ndryshme lidhur me realizimin e programit të studimit. Ky vlerësim bazohet në shpërndarjen në adresat elektronike të studentëve përkatës të pyetësorit të miratuar paraprakisht në Dekanatet përkatëse. Rezultatet e pyetësorëve diskutohen në departamente dhe përcillen në Dekanat, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës në të gjitha aspektet, sidomos në problematikat e evidentuara nga studentët.

#### **Evidence 1.23 Analizë e pyetësorit të studentëve në FE**

**Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Në hartimin e raporteve për vlerësimin e brendshëm për secilin program studimi marrin pjesë të gjithë anëtarët e departamenteve, duke filluar që nga përgjegjësi i departamentit, i cili ndihmon me mendimet dhe shkresat përkatëse, duke vazhduar me mendimet e studentëve dhe të ekspertit të jashtëm. Gjithashtu, edhe sekretaria mësimore dhe e dekanit japin evidencat e kërkuara. RVB-të e

<sup>1</sup> Evidencë e studimit të tregut të punës, Gjuhë angleze dhe Gjuhë italiane.

hartuara kalojnë për miratim në departamentet përkatëse dhe më pas në Dekanat. Pasi miratohen në Dekanat, përcillen në Rektorat.

Edhe raporti lidhur me programin e studimit, bazuar në të dhënat e përfuara nga pyetësi me studentët e sapodiplomuar, diskutohet në dekanat dhe nxirren konkluzionet përkatëse.

Evidencë 1.18 Analizë e pyetësorëve të studentave të sapodiplomuar

### **Përfundimi dhe Vlerësimi**

USH e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore bazuar në aktet ligjore në fuqi, në Statutin e USH-së dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet qeverisëse të USH-së. Krahas këtyre dokumenteve bazë fakultetet bazohen edhe në Rregulloren e Fakultetit. Gjithashtu, secili departament ka rregulloren e vet, të miratuara me vendim të Dekanatit. Secili program studimi ka rregulloren përkatëse, miratuar me vendim të Dekanatit. Fakultetet respektojnë autonominë e vet, bazuar në Statutin e USH-së.

Në USH ekziston debati konstruktiv, duke filluar që nga njësia bazë deri tek dekanati. Në nivel departamenti vendimet merren në mbledhje të departamenteve, ku secili anëtar shpreh mendimet e tij. E njëjta frymë diskutimi është edhe në dekanat. Në grupet e vetëvlerësimit janë të pranishëm studentë, ekspertë të jashtëm, të cilët gjenerojnë ide, me qëllim përmirësimin e cilësisë.

Departamentet hartojnë raportin mbi veprimtarinë mësimore-shkencore, ku shpalosen arritjet e departamentit. Secili anëtar i departamentit harton raportin e vet, pastaj përgjegjësi i departamentit harton raportin përfundimtar, i cili bëhet objekt diskutimi në një mbledhje të caktuar. Raporti, së bashku me problematikat e dala në mbledhje, i përcillet Dekanit nga secili përgjegjës i departamentit. Dekani dhe zv.dekania hartojnë raportin e punës mësimore-shkencore për të gjithë fakultetin dhe ky raport diskutohet në mbledhjen e Dekanatit. Pastaj raporti, pasi miratohet në dekanat, përcillet për në Rektorat.

Sigurimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një preokupim kryesor për të gjitha departamentet. Në Fakultete është ngritur NjSBC-ja e Fakultetit. GVB-të përkatëse hartojnë raportet e vlerësimit të brendshëm për secilin program studimi. Këto raporte diskutohen dhe miratohen në departamentet përkatëse, më pas në dekanat.

Fakultetet bëjnë përpjekje për të monitoruar programet e studimit që ofron. Krahas analizës vjetore të punës mesimore-shkencore, në fillim të vitit akademik secili departament miraton, në një mbledhje të veçantë, sylabuset e lëndëve që mbulon, duke raportuar ndryshimet e bëra dhe arsyet përkatëse. Gjithashtu, tashmë është kthyer në një traditë për fakultetet marrja e mendimit të studentëve që diplomohen. Në ditën e diplomimit, pasi të kenë përfunduar provimin apo prezantimin e punimit shkencor, ata plotësojnë pyetësorin lidhur me cilësinë e programit të studimit.

Fakultetet bëjnë përpjekje për hapjen e programeve të reja të studimit. Në vitin akademik 2021-2022 u hapen 9 programe studimi.

Departamentet angazhohen në proceset për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultete. Në

departamente janë të krijuara grupet e punës për hartimin e RVB-ve të programeve të studimit dhe në përbërje të këtyre grupeve janë të përfshirë pedagogë, studentë dhe ekspertë të fushës. RVB-të e hartuara kalojnë për miratim në departamentet përkatëse dhe më pas në Dekanat. Pasi miratohen në Dekanat, përcillen në Rektorat. Edhe raporti lidhur me programin e studimit, bazuar në të dhënat e përftuara nga pyetësi me studentët e sapodiplomuar, diskutohet në dekanat dhe nxirren konkluzionet përkatëse.

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen plotësisht.**





## II – BURIMET DHE PARTNERITETI

### **Standardi II.1 Institucion ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe të rekrutimit të burimeve njerëzore.**

Organigrama e USH-së bëhet publike. ( [ëëë.unishk.edu.al](http://eëë.unishk.edu.al))

USH-ja ndjek një politikë të qartë dhe të mirëstrukturuar për rekrutimin e pedagogëve, sipas Rregullores së Punësimit e miratuar me Vendimi i Senatit Akademik nr. 69, datë 10.03.2022 "Për miratimin e rregullores se punësimit në USH".

Pasi bëhet planifikimi i nevojave nga departamentet dhe përmbledhen si fakultet, dërgohen pranë rektoratit, i cili nëpërmjet zyrës së Burimeve Njerëzore bën lajmërimin on-line. Departamentet përkatëse bëjnë vlerësimin e kandidatëve me konkurs, i cili miratohet nga dekanit dhe rektori. Vendet vakante njoftohen tek Buletini i njoftimeve publike pranë Agjencisë së Prokurorimit publik dhe në [ëëë.unishk.edu.al](http://eëë.unishk.edu.al), duke u mbështetur në Rregulloren e punësimit. Njoftimi përmban pozicionin, përshkrimin e vendit të punës, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, dokumentet që duhet të paraqesin kandidatët, afatin brenda të cilit do të kryhen aplikimet, vendin e dorëzimit të dokumentacionit dhe mënyrën e konkurrimit. Më pas, institucioni ndjek procedurat e rekrutimit të stafit sipas afateve dhe kriterëve të shpallura. Konkursi drejtohet nga një komisioni ad hoc, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësisë bazë përkatëse. Kandidatët fitues nënshkruajnë kontratën e punës me Rektorin, mbështetur në legjislacionin për Arsimin e Lartë dhe Kodin e Punës të RSH-së. Dokumentacioni dhe vendimet arkivohen dhe janë të disponueshme në Zyrën e burimeve njerëzore të USH dhe në Sekretarinë e dekanit të fakultetit.

Evidenca 2.1 Rregullore e punësimit në USH

<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-senatit-akademik>

<https://unishk.edu.al/njoftime-per-punesim/mundesi-punesimi-per-pedagoget-e-jashtem>;

<https://unishk.edu.al/punesime/mundesi-punesimi-per-pedagoget-e-brendshem>

<https://unishk.edu.al/njoftime-per-punesim/mundesi-punesimi-per-staf-joakademik>

### **Standardi II.2 Institucion ndjek një politikë integruese të personelit akademik, personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ.**

USH bën përpjekje për të zbatuar një politikë integruese të personelit. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakulteteve si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme, si p.sh., konferenca, aktivitete të ndryshme, etj. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme që e zhvillojnë lëndën, që në hartimin e sylabuseve, mënyrën e vlerësimit, zhvillimin e seminareve, hartimin e testeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, vlerësimin etj. Stafi akademik me kohë të pjesshme mund të marrë pjesë në mbledhjet e departamentit, raporton për veprimtarinë mësimore-shkencore, etj. Po kështu, për realizimin me sukses të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon me sekretarinë mësimore



për çdo aspekt që lidhet me sekretarinë. Nga ana tjetër, edhe personeli administrativ është gjithmonë i gatshëm për të asistuar pranë stafit për çdo problem teknik apo për ta pajisur stafin me guida ndihmëse, si p.sh. Udhëzues për platformën Teams.

Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme. Në disa programe studimi zhvillojnë mësim kolegë nga fakultetet e tjera. Cdo fillim viti akademik, bazuar në nevojat e departamenteve, përgjegjësit hartojnë shkresat përkatëse dhe i dërgojnë tek Dekani. Dekani dërgon shkresat për nevojat për pedagogë tek fakultetet përkatëse dhe, në këtë mënyrë, studentit i sigurohet mësimdhënia e duhur, me specialistë të fushës.

USH-ja nxit integrimin e personelit të tij në shumë veprimtari akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. Mes tyre mund të sjellim shkëmbimet dhe bashkëpunimet reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivelin universitar dhe pasuniversitar; (seminareve dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët; realizimin e projekteve të përbashkëta; trajnime të përbashkëta të stafit administrativ dhe akademik në institucione brenda dhe jashtë vendit.

USH operon në kuadër të disa projekteve si Erasmus + (Tempus), Erasmus Mundus dhe CEEPUS. Universiteti promovon këto lloj veprimtarish përmes materialesh me karakter informativ, siç janë manualët e studentëve dhe broshurat informuese. Në kuadrin e projekteve ndërkombëtare USH ndjek një politikë të mbështetjes jo vetëm të stafeve akademike por edhe të personelit administrativ dhe ndihmës mësimor-shkencor me mobilitete nga ku ata kanë mundësi të përfitojnë kualifikime dhe eksperiencë ndërkombëtare.

Evidence 2.2 Shkrese e Dekanit Fakulteteve

Evidence 2.3 Lista e projekteve

Evidencë 2.4 Mobilitet e stafit akademik dhe administrativ

### **Standardi II.3 Institucion ndjek një politikë të vlerësimit të aftësive të personelit të tij dhe fokusohet në zhvillimin e mëtejshëm të tyre.**

Secili Fakultet në USH bën përpjekje për të vlerësuar aftësitë e personelit. Politika e Fakulteteve në këtë drejtim konsiston në disa pika, të tilla si: a) marrja e fidbekut lidhur me programin e studimit nga studentët që diplomohen; b) analizimi i raporteve të vetëvlerësimit të programeve të studimit në departamentet përkatëse e, më pas, në dekanat; c) analiza e punës mësimore-shkencore në departamente e në dekanat; d) diskutimi dhe miratimi i sylabuseve të lëndëve në mbledhje të departamentit, etj. Duhet theksuar se ka përpjekje për vlerësimin e performancës, por akoma nuk kemi një produkt të mirëfilltë, me të gjitha aspektet dhe mënyrat e matjes së performancës.

USH-ja inkurajon trajnimet e personelit akademik në kualifikime të ndryshme: konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, trajnime brenda dhe jashtë vendit, mësimdhënie në universitetet perëndimore, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat e mundshme, trajnimet nëpërmjet projekteve etj.

Në këtë drejtim FE ka angazhuar profesorë të huaj në trajnimin e stafit akademik, si p.sh. në rastin e trainimit të stafit akademik në "Metoda Bashkohore të Mesimdhënieve" nga pedagogë amerikan të CERGE-EI, Prague. Gjithashtu, ky fakultet në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e SIUC (Southern Illinois University at Carbondale), SCC

(Sandhills Community College), Universitetin e Bolonjes, Universitetin e Varshaves, Universitetin e Ebersäldit janë realizuar disa botime dhe punime kërkimore të stafit të FE me stafet perkatese të këtyre Universiteteve Perëndimore.

Për të përmirësuar performancën akademike, FGJH ka organizuar trajnime të përbashkëta me institucione të tjera edhe në kushtet e zhvillimit të mësimin online siç është ëorkshopi i organizuar nga Departamenti i gjuhes angleze me Departamentin e Gjuheve të Huaja në Universitetin e Korçës<sup>2</sup>. Në kuadër të projektit Virtual Albanian European Universities Exchange - VALEU-X (<https://unishk.edu.al/kerkimi-shkencor/projekte/valeux-project>), u trajnuan disa pedagoge që përfaqësonin programin e studimit të tyre, ndër to dhe pedagogë të programit të studimit “Gjuhë Italiane”. FGJH ndjek një politikë të përfshirjes së studjuesve të rinj në projekte kërkimore. I tillë është projekti Erasmus KA-107 për trajnimin e stafit akademik për mësimdhënje<sup>3</sup>. FGJH ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore shkencore. E tillë është marrëveshja GREM<sup>4</sup> apo angazhimi i lektoreve të gjuhës frënge në mësimdhënieje/pjesëmarrje në kërkim shkencor në Fakultetin e Shkencave Humane, Universiteti Haute Alsace<sup>5</sup>.

Evidence 2.5 Trajnim i stafit akademik FE

Evidence 2.6 Artikull shkencor me bashkëautorë të huaj partner FE

#### **Standardi II.4 Institucion ndjek një politikë të zhvillimit social.**

Të gjitha departamentet e Fakulteteve në USH i kushtojnë vëmendje zhvillimit të veprimtarive të ndryshme me studentët. Studentët nxiten që të marrin pjesë në veprimtari ekstrakurrikulare, të marrin pjesë në veprimtari të përbashkëta të realizuara me organizata të ndryshme. Po kështu, vlen të theksohet pjesëmarrja e studentëve tanë në veprimtari artistike dhe sportive, si dhe vullnetarizmi i shfaqur nga studentët tanë në drejtime të ndryshme, si dhurim gjaku, etj.

Universiteti organizon dhe mbështet veprimtari të tilla, si: panairë, forume, takime sensibilizuese, donacione, ekspozita, shfaqje, diskutime tematike, olimpiada, konkurse, takime promovuese etj. Përmes veprimtarive të ndryshme sociale synohet të nxitet dhe të fuqizohet dialogu, mendimi i lirë dhe kreativiteti i studentëve. Veprimtari të tilla zgjojnë interesim dhe kanë ndikim direkt në sferën emotive, shoqërizuese dhe edukative.

[https://unishk.edu.al/njoftimi-plote?tx\\_neës\\_pi1%5Baction%5D=detail&tx\\_neës\\_pi1%5Bcontroller%5D=Neës&tx\\_neës\\_pi1%](https://unishk.edu.al/njoftimi-plote?tx_neës_pi1%5Baction%5D=detail&tx_neës_pi1%5Bcontroller%5D=Neës&tx_neës_pi1%5B)

[5Bnees%5D=948&cHash=bbf028e1336dcb96fe3e4867d2214fde](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=948&cHash=bbf028e1336dcb96fe3e4867d2214fde)

FE ka qënë vazhdimisht aktiv në planin social duke angazhuar pedagogët në bashkëpunim me studentët në veprimtari të ndryshme sociale me impakt në Rajonin e Shkodrës, të tilla si fokus grupet dhe panairët në fushën e turizmit, vizitat në shtëpinë e të moshuarve, aktivitetet e dhurimit të gjakut, aktiviteti krijues me studentët “Doing Great Things” dhe aktivitete të tjera argëtuese. Gjithashtu në vazhdim të përpjekjeve për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të veriut e me tej, Fakulteti Ekonomik i Universitetit të Shkodrës, realizoi në këto ditë të para të Qeshorit takime me maturanët e shkollave të mesme në Bashkinë Shkodër dhe Bashkinë Vaudejës, mbi ndërjegjësimin e të rinjve për rolin dhe mundësitë e tyre për të kontribuar individualisht dhe së bashku në realizimin e 17 Objektivave të OKB të Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Një rol të rëndësishëm luan dhe Shoqata Sportive e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me drejtues pedagog nga Departamenti i Edukimit Fizik dhe sporteve, FSHE, ku në mjediset e palestrës së Universitetit ka realizuar shumë aktivitete sportive gjatë gjithë vitit akademik sidomos në ditë të rëndësishme kombëtare.

[https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx\\_nees\\_pi1%5Baction%5D=detail&tx\\_nees\\_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx\\_nees\\_pi1%5Bnees%5D=658&cHash=224b05f25c8bf841567bcaf56549f412](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=658&cHash=224b05f25c8bf841567bcaf56549f412)

Një ndër aktivitetet më të rëndësishme të kësaj shoqate ka qënë aktiviteti i përbashkët mes Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe Federatës së Shoqatave Sportive, ku u përfshinë një numër i konsiderueshëm pedagogësh e studentësh. Pas disa ndeshjesh të volejbollit dhe basketbollit u realizua një ndeshje miqësore ndërmjet pedagogëve të Universitetit në volejball. Në përfundim të aktivitetit për studentët që u shpallën si lojtarët më të mirë të disiplinave si dhe ekipet fituese u shpërndanë certifikata. Ekipet e cilët u shpallën fitues të vendeve të para, iu dorëzuan kupat përkatësisht nga Rektorja e Universitetit Prof. Dr. Suzana Golemi, nga Presidenti Federatës së Shoqatave Sportive z. Besnik Veliu si dhe nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit Prof. As. Dr. Fatmir Vadohej. Gjithashtu Presidenti i Federatës së Shoqatave Sportive z. Besnik Veliu i dorëzoi një certifikatë mirënjohjeje Shoqatës Sportive Studentore “Luigj Gurakuqi” si model i përfaqësimit në Kampionatet Universitare si dhe në organizimin e aktiviteteve sportive pranë këtij Universiteti.


[https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx\\_nees\\_pi1%5Baction%5D=detail&tx\\_nees\\_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx\\_nees\\_pi1%5Bnees%5D=662&cHash=](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=662&cHash=2d107ffda04e89288aa05a14936feaac)

2d107ffda04e89288aa05a14936feaac

USH-ja, si çdo institucion tjetër publik, siguron pajisjen e stafit me librezë shëndetësore, si tregues i kontrollit të përvitshëm shëndetësor të personelit. USH vepron në përputhje me kuadrin ligjor dhe sigurimin shëndetësor dhe social, si dhe ofron mbështetje financiare në rastet e fatkeqësive familjare ose sëmundjeve të rënda (Evidenca 2.16).

Evidence 2.7 Lista e aktiviteteve me impakt social në FE

Evidence 2.8 Mbështetje financiare në rastet e fatkeqësive familjare ose sëmundjeve të rënda FSHE



**Standardi II.5 Institucioni siguron qëndrueshmëri afatgjatë të personelit akademik gjatë periudhës midis dy akreditimeve.**

Të gjitha departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në Rregulloren e punësimit. Tashmë, 10 programe studimi janë në procesin e akreditimit për herë të parë i cili do të fillojë në muajin Maj 2023, ku janë të përfshirë FSHE, FSHN, FE.

Evidencë 2.9 Lista emerore e stafit akademik sipas Fakulteteve

**Standardi II.6 Institucioni vlerëson dhe mbështet personelin e vet në përmbushjen e detyrimeve vjetore-akademike e administrative.**

Ka përpjekje nga USH për të mbështetur personelin për realizimin e detyrimeve dhe për rritjen profesionale të tij. USH bën përpjekje për të realizuar formimin e vazhduar si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Qendra e Ekselencës e miratuar me Vendim Senati nr.103, datë 18.03.2015, nr. 1160 prot., me iniciativën e Fakultetit Ekonomik dhe të Fakultetit të Shkencave të Edukimit, ndër të tjera ka si funksion edhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejtat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Me vendim Nr.249 të Senatit Akademik të datës 17.07.2019, në mbështetje të Ligjit nr.80, dt.22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Statutit të USH-së, emri i kësaj njësie ndryshon nga “Qendra e Ekselencës” në “Zyrë e Ekselencës”. Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve të kësaj zyre, zhvillohet trainimi vjetor “Metodat kërkimore sasiore dhe cilësore”.

Evidence 2.10 Aktivitete zyra e Ekselencës FE

**Standardi II.7 Institucioni disponon dhe menaxhon pasuritë e paluajtshme dhe fokusohet në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.**

USH-ja evidenton pasuritë e paluajtshme të tij. Dokumentacioni përmban elementet e domosdoshme sipas standardeve shtetërore në fuqi. USH-ja ka një plan afatmesëm për rehabilitimin, zgjerimin dhe ristrukturimin e pasurive të paluajtshme të tij. Vitet e fundit është realizuar mirëmbajtja e Godinës së Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe e Godinës së Fakultetit të Shkencave të Natyrës. Ka përfunduar ndërtimi i Godinës së Re të Fakultetit Ekonomik, i realizuar me fondet e FZHR dhe burimet e vetë USH-së. Gjithashtu është bërë një investim prej rreth 16 milionë lekësh për të bërë përshtatjen e të gjitha godinave me kushtet e mbrojtjes kundër zjarrit, sipas legjislacionit në fuqi.

Godina e FSHE-së ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm, gjë që pasqyrohet edhe në shkresat e dërguara. Është realizuar akti i ekspertizës për çatinë e godinës dhe pritet ndërhyrja për rregullimin e saj.

**Standardi II.8 Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore.**

USH-ja ka në dispozicion të mësimdhënies 8 godina të ndërtuara në periudha të ndryshme, nëpërputhje me normativat teknike dhe Legjislacionin e kohës së ndërtimit të tyre. Ato plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët, për personelin akademik e administrativ dhe mirëmbahen rregullisht nga ana e USH-së.

Fakultetet disponojnë mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore. Fakulteti i Shkencave të edukimit ka një godinë të përbashkët me Departamentin e Infermierisë. Në godinë është realizuar ndarja e sallave nëpërmjet departamenteve të FSHE dhe Departamentit të Infermierisë. Departamenti i Edukimit fizik e sporte tashmë ndodhet në godinën e FSHSH-së. Në varësi të specifikave të programeve të studimit të ofruara, krahas palestrës, shfrytëzohet edhe stadiumi i qytetit të Shkodrës dhe Fusha “Reshit Rusi” mbi bazën e marrëveshjes që ka USH me Bashkinë e qytetit.

Godina e Re e Fakultetit Ekonomik është projektuar dhe ndërtuar sipas normave modern antisizmike evropiane “Eurokodi 8” dhe garanton cilësi të larta ndaj ndonjë eventit sizmik tëmundshëm. Godinat e e Re e Fakultetit Ekonomik siguron akustikë të mirë, izolim të mirë nga zhurmat dhe luhatjet e temperaturës, falë materialeve me të cilat është ndërtuar dhe ndërhyrjeve të vazhdueshme që janë bërë për përmirësimin e treguesve të transmetimit të nxehtësisë dhe zhurmës. Sistemi e ngrohjes realizon një ambient normal pune. Ajo është vendosur në një zone qendrore të qytetit dhe jo afër zonave të zhvillimit industrial (të cilat në Shkodër nuk ekzistojnë) apo me ndotje mbi normat. Sipas matjeve të bëra nga organet e specializuara kombëtare rezultojnë që ndotja nga trafiku në Shkodër është kudo brenda normave të lejuara. Godina e Re e Fakultetit Ekonomik ka shkallë emergjence. Kjo godinë plotëson edhe kushtet e mbrojtjes nga zjarri, sipas ligjit. Ajo është e pajisur me fikëse zjarri, një për çdo 150 – 200 m që janë të kolauduara. Godina e e Re e Fakultetit Ekonomik disponon të gjitha ambientet e nevojshme për zhvillimin e aktivitetit të tij: auditorë mësimi; ambiente për laboratorë; ambiente për personelin pedagogjik; ambiente për personelin administrativ; ambiente teknike, salla audio-vizive, salla kompjuterash, salla multimediale etj., të kësaj natyre. Godina e re e Fakultetit Ekonomik dhe ambientet e saj janë vënë në dispozicion të mësimdhënies dhe studentëve duke përmirësuar cilësinë dhe standardin e një infrastrukture të përshtatshme, që në Shtator të vitit 2019. Në këtë mënyrë FS ka pasur një përmirësim të standardit për m<sup>2</sup> për student duke realizuar aktualisht një normë prej 3.5m<sup>2</sup>. Referuar numrit të pritshëm të studentëve, kuotave të pranimit për vitin akademik 2021-2022 kapacitetit të godinës të godinave dhe fushave të programeve të studimit rezultojnë se FS-ja ofron një normë mesatare të pritshme prej 3.5 m<sup>2</sup> (per t’u vlerësuar sërish për saktësi).

FSHSH ka infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë e procesit mësimor. Laboratorët kanë luajtur rol të rëndësishëm në projektet shkencore dhe në aktivitetet me studentët.

FGJH siguron mjedise dhe infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. Godina e FGJH, FSHN ku ndodhet dhe FD janë të vendosura në qendër të qytetit të Shkodrës në një distance të arritshme me godinat e tjera të USH. Ndërtesat plotësojnë kërkesat teknike për



mësimin e rregullt që i lidh me ndriçimin natyror dhe elektrik, orientimin e ndërtesave, hyrjen e ndërtesave, ngrohjen, etj. Ambjentet, departamentet, klasat, labororet, ambientet sanitare mirëmbahen me cilësi të lartë. Klasat kanë lehtësira themelore mësimore. Ambientet e dedikuara për procesin e mësimdhënies janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. Institucioni ka siguruar internet ëfi dhe pajisje si kompjutera videoprojektorë, në të gjithë godinën. Falë bashkëpunimeve me ente kombëtare dhe ndërkombëtare, janë siguruar përmirësime në infrastrukturë dhe logjistikë të cilat plotësojnë ato të siguruara nga institucioni.

Evidence 2.12 Marrëveshje me Bashkinë Shkodër për shfrytëzimin e fushës sportive

**Standardi II.9 Institucioni siguron mjedise komode pune - mësimore - laboratorike të përshtatshme për personelin akademik dhe studentët dhe personat me aftësi të kufizuara.**

USH kujdeset që asetet ekzistuese të sigurojnë kushte të përshtatshme për te vijuar procesin e mësimdhënies në mënyrë të pavarur dhe pa ndërprerje. USH zhvillon gjithashtu strategji për rritjen e cilësisë së aseteve për studentët. Çdo vit bëhen investime me qëllim që të riparohen ambientet për të krijuar lehtësira në shfrytëzimin e tyre nga studentët. Studentëve u sigurohet cilësia e akomodimit të ngrohjes së mjedisit. Sidoqoftë, objektet ekzistuese nuk ofrojnë kushte për qasje të pandërprerë për personat me aftësi të kufizuara dhe ambiente çlodhjeje për studentet, pushimi për oraret ndërmjet orëve të mësimin.

Siç, u përmend dhe më lart godina që ka nëvojë më urgjente për ndërhyrje aktualisht është Godina e FSHE, kati i tretë.

Evidence 2.11 Shkrese për mirembajtje FSHE dhe Akt ekspertize FSHE

**Standardi II.10 Për programet e studimit të fushave mjekësore, inxhinierike institucioni siguron laboratorë të standarteve të larta profesionale e shkencore.**

Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laborator në kuadër të projektitT@ask.

USH siguron shërbime të palëve të treta në përputhje me nevojat e tregut. Ekzistojnë laboratorë brenda njësive akademike në të cilat ato ofrojnë shërbime për njësitë institucionale të jashtme, si dhe shërbime të drejtpërdrejta për popullatën, siç është laborator mikrobiologjik dhe fizioterapi në FSHN.

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij; me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja bën përpjekje, në përputhje me mundësitë financiare për sigurimin e mjediseve në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik.

**Standardi II.11 Institucioni siguron mjedise të përshtatshme pushimi, sportive dhe argëtimi për personelin akademik dhe studentët e vet.**

USH ka në dispozicion të stafit dhe të studentëve sallën e madhe të aktiviteteve dhe

promovimeve, po ashtu ambientet kolektive në çdo kat të fakulteteve dhe oborri i përparëm përdoren si mjedise. USH ndjek një politikë të kujdesshme për menaxhimin të aseteve të tij. Ai kujdeset që asetet ekzistuese të sigurojnë kushte të përshtatshme për të vijuar procesin e mësimdhënies në mënyrë të pavarur dhe pa ndërprerje. USH zhvillon gjithashtu strategji për rritjen e cilësisë së aseteve për studentët. Cdo vit bëhen investime me qëllim që të riparohen ambientet për të krijuar lehtësira në shfrytëzimin e tyre nga studentët. Studentëve u sigurohet cilësia e akomodimit të ngrohjes së mjedisit. Sidoqoftë, objektet ekzistuese nuk ofrojnë kushte për qasje të pandërprerë për personat me aftësi të kufizuara dhe ambiente çlodhjeje për studentet, pushimi për oraret ndërmjet orëve të mësimi.

**Standardi II.12 Institucioni monitoron në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e infrastrukturës fizikë dhe angazhohet në përmirësimin e saj.**

USH përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevojë. Në përgjithësi, ambientet janë të pastra, me ngrohje, i kushtohet kujdes i madh pastrimit, ajrosjes dhe dezinfektimit të tyre. Ka ndërjegjësim në rritje për përmirësimin e aksesibilitetit të studentëve me aftësi të kufizuara. Vitet e fundit është realizuar një rampë për PAK në FSHE e cila është vendosur në katin e parë të godinës.

**Standardi II.13 Institucioni disponon dokumentacion të plotë të veprimtarisë akademike në letër (hardcopy) dhe në formë elektronike.**

Ruajtja e dokumentacionit në letër realizohet përmes sektorit të Protokoll- Arkivës, dhe Sekretarive mësimore të fakulteteve, të strukturuar dhe funksionale, në të cilën ruhet i gjithë dokumentacioni. USH-ja synon dixhitalizimin e të dhënave dhe ruajtjen e dokumentacionit në formë elektronike. Kjo punë realizohet nga Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë.

USH-ja ka një strukturë për mbledhjen e statistikave që kërkohen periodikisht nga MASr dhe INSTAT, Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë. USH-ja disponon një bazë të dhënash në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit etj., në përputhje me aktet nënligjore në fuqi. Institucioni disponon të dhëna të përgjithshme për programin, formën, planin e tij mësimor, shoqëruar me kreditet e detyrueshme të studimeve, të depozituara pranë njërive bazë dhe në Degën e kurrikulave, standardeve dhe kërkimit shkencor.

USH disponon një regjistër bazë të studentëve me të dhëna, që ruhet pranë sekretarive mësimore të çdo fakulteti. Ky regjistër, në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj.

Fakultetet disponojnë dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore. Në nivel departamenti ruhen dhe protokollohen të gjitha shkresat e ardhura dhe ato të dërguara, relacionet e mbledhjeve dhe procesverbalet e tyre, vendimet që merren, etj.

Pranë sekretarisë së dekanit ruhen dhe protokollohen të gjitha shkresat e ardhura nga Rektorati, nga departamente, apo nga studentët, si dhe shkresat e dërguara.

Pranë sekretarisë mësimore ruhen regjistrat bazë të studentëve me të dhënat e tyre. Ky regjistër,

në formë të shkruar dhe elektronike, pasqyron vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, të dhëna për diplomën ose diplomat e marra bashkë me suplementin e diplomës etj.

#### **Standardi II.14 Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimit në nivel institucional.**

U-Albania, University Albania" <https://ualbania.al>, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. SMAK <https://smak.unishk.edu.al/home>, është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. Programi mësimor i programeve të studimit mund të gjendet, gjithashtu, në këtë portal, por programet mësimore nuk janë të dukshme. IAL ka një ëebpage [ee.unishk.edu.al](http://ee.unishk.edu.al), ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësisive akademike, përkatësisht departamenteve të tyre, publikimin e dokumenteve të USH-së, si: Statuti i Universitetit, rregulloret funksionale dhe të tjera. Brenda USH-së, ekziston Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë e cila kujdeset për fushat e teknologjisë së informacionit, në këtë mënyrë duke pasqyruar veprimet e njësisive akademike dhe departamenteve të tyre me orare mësimore, orare të provimeve, njoftime për aktivitete akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit.

USH-ja kujdeset për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë së tij akademike, kulturore dhe shkencore, duke organizuar konferenca në nderim të figurave akademike të universitetit, vendosjen e emrave të personaliteteve akademike mjediseve universitare, duke i kujtuar personalitetet përmes veprave artistike dhe promovimit të librave të personaliteteve akademike. Gjithashtu, në bibliotekën universitare ruhen mjaft mirë botimet, ndërsa në muze dhe stenda të ndryshme, janë të ruajtura një pjesë e mirë e punës akademike dhe shkencore. Procesi i dixhitalizimit është në proces të vazhdueshëm, deri në dixhitalizimin e plotë të fondit arkiv. Ky proces ka filluar prej shumë vitesh, por që nga viti 2013 po ecën me hapa më të shpejtë si rezultat i pajisjes së Bibliotekës me teknologji bashkëkohore. Për realizimin e dixhitalizimit të fondit të rrallë (arkiv) është ngritur dhe grupi i punës prej 5 vetësh që realizon këtë proces. Softëare përkatës lejon arshivimin e të dhënave sipas standardit Dublin Core. Për paraqitjen e materialeve është përzgjedhur formati DjVu. Numërohen deri tani mbi 47.000 faqe on-line në këtë arkiv dixhital që mbajnë pronësinë e Bibliotekës Universitare. Biblioteka ka pësuar një ndryshim në organizimin e saj. Ajo operon sot me dy sektorë: 1.Sektori i klasifikatorë- restauratorëve (përgjegjësi +dy klasifikatorë +një restauratorë); 2.Sektori i bibliotekarë-arkivistëve (përgjegjësi + gjashtë bibliotekarë). Kjo risi organizimi ka dhënë impakt pozitiv në përmbushjen me sukses të detyrave nga stafi, sepse secili i përshtatet me kualifikimin përkatës pozicionit që mban. gjithë stafi i bibliotekës ka përfunduar shkollën dyvjeçare të bibliotekonomisë pranë Bibliotekës Kombëtare. USH-ja ndjek një politikë të vlerësimit dhe të zhvillimit të pasurive të tij akademike, kulturore dhe shkencore, përmes dhënies së titujve “Profesor Emeritus”, “Honoris Causa” nga Senati Akademik i USH-së.

Në këtë kuadër, FE ka sjell një risi dhe ka organizuar gjatë mbledhjeve të departamenteve dhe Asamblesë së FE edhe vlerësime dhe mirënjohje për pedagogët më të mirë të vlerësuar nga



pyetësorët e studentëve dhe të atyre pedagogëve me kontribute të qenësishme në zhvillimin e FE si çertifikata mirënjohje me rastin e 20 vjetorit, 25 vjetorit etj.

Evidence 2.12 Vlerësim mirënjohje nga F

**Standardi II.15 Institucioni bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit.**

USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimi, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifatat e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. (ëëë.[unishk.edu.al](http://unishk.edu.al)).

**Standardi II.16 Institucioni harton buxhetin në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe transparente.**

Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatit akademik

Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre në USH, bëhet në përputhje me rregullat dhe standardet e programimit buxhetor dhe menaxhimin financiar publik, në mbështetje të ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

Shpërndarja e burimeve financiare bëhet në përputhje me strategjinë afatmesme të buxhetit të përgjithshëm. Urdhrat për hartimin e buxhetit nxirren nga titullari i institucionit. Bashkëngjitur Urdhri i Administratorit nr.96, dt. 18.03.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e buxhetit 2019”.

Struktura e hartimit të buxhetit të USH-së bëhet sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit, të përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave, mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar). Struktura bazohet tek plani kontabël i llogarive dhe nga llogaritë specifike për institucionet publike.

Mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar), buxheti i propozuar është objekt diskutimi dhe miratimi në Senat dhe në Bordin e Administrimit.

Nga ana e rektoratit dërgohen shkresat deri në departamentet përkatëse lidhur me specifikimin e kërkesave buxhetore për financim.

Urdhri Prot 1359, dt.19.04.2021 është për miratimin e programit të transparencës:

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2020-](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-)

[2021/programi\\_i\\_transparences/Urdher\\_1359\\_Prot\\_dt\\_19.04.2021](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/programi_i_transparences/Urdher_1359_Prot_dt_19.04.2021)

Shih edhe rubrikën për buxhetin: <https://unishk.edu.al/universiteti/buxheti> ;  
për Bordin e Administrimit dhe Vendimet  
<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-bordit-te-administrimit>  
për Senatin dhe vendimet e tij:  
<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-senatit-akademik>

#### **Standardi II.17 Institucioni siguron mjetet e nevojshme për të zbatuar politikën financiare.**

Brenda Rektoratit, Drejtoria e financave ka përgjegjësi administrative për çështje financiare.

USH-ja ka të ngritur një strukturë të posaçme, (Urdhri nr. 244, dt. 11.08.2017) Grupin e Menaxhimit Strategjik (i ndryshuar), pjesë e të cilit janë strukturat drejtuese më të larta, si: Administratori dhe Drejtori Ekonomik, që shërben për menaxhimin financiar të tij dhe zbatimin e politikës financiare, mbështetur në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar). Për të zbatuar politikën e vet financiare USH-ja mbështetet në grandin e buxhetit të shtetit dhe nga të ardhurat e siguruara nga shërbimet ndaj të tretëve, projektet, donacione dhe sponsorizime.

USH-ja analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-bordit-te-administrimit>

Ka raste që krahas fondeve të Universitetit, Fakultetet gjejnë edhe sponsorë për të realizuar veprimtari shkencore apo aktivitete në favor të promovimit të punës.

#### **Standardi II.18 Institucioni ndjek një politikë të kontrollit buxhetor dhe financiar.**

USH i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjinale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-bordit-te-administrimit>

USH-ja si institucion i Arsimit të Lartë i nënshtrohet rregullave të ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, dt. 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (i ndryshuar). USH-ja i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm, dhe rezultatet në të dy rastet i prezantohen organeve kolegjinale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

Raporti i veprimtarisë financiare të USH-së miratohet në rektorat dhe pastaj nga dy organet kolegjinale, Senati dhe Bordi i Administrimit. Gjithashtu mendimi i studentëve merret edhe nga përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik dhe përfaqësuesi i tyre në Bordin e Administrimit.

<https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/vendime-te-bordit-te-administrimit> Vëndim Nr.9 datë 19.01.2022” Për miratimin e raportit vjetor të veprimtarisë financiare të USH-së për vitin akademik 2020-2021”

Raportet e KLSH-së, e auditit të MASH-it dhe e auditit të vetë institucionit, për IAL-të publike,

janë shqyrtuar në Bordin e Administrimit në mbështetje të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar).

**Standardi II.19 Institucioni ndjek një strategji të hapur për bashkëpunimin dhe partneritetin në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.**

Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi.

Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Disa nga këto marrëveshje kanë rezultuar shumë të rëndësishme për USH-në duke ndihmuar stafin e ri të universitetit në kualifikimin shkencor si dhe duke ndihmuar në ngritjen e disa laboratorëve mësimorë dhe shkencorë.

Institucioni merr parasysh nevojat e ekonomisë vendase dhe të tregut të punës në hapjen e programeve të reja ose hartimin e projekteve kërkimore shkencore. Çdo program i ri studimi që hapet në USH, hapet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë ku parashikohet kryerja e studimit të tregut të punës.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi i Universitetit të Shkodrës. Në këtë drejtim është punuar si në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të rajonit, Evropës apo dhe Amerikës ashtu si në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik. USH ka punuar intensivisht për tu përfshirë në projekte ndërkombëtare dhe për t’iu përgjigjur ofertave europiane duke u përfshirë në partneritete në kuadrin e projekteve europiane si CEEPUS, ERASMUS Mundus, Interreg (FOST INNO), IPA (HELIX), TEMPUS (EUREQA, CHTMBAL, MARED), Erasmus + (MARDS, FINAC, USIA). Gjithashtu nëpërmjet marrëveshjeve me Universitetet Perëndimore Europiane dhe me SHBA janë realizuar mobilitete të stafëve dhe studentëve si dhe janë siguruar bashkëpunime me strukturat kërkimore brenda këtyre Universitetve duke realizuar aktivitete të përbashkëta si publikime, konferenca, aplikim i kurrikulave më mbështje të stafëve cilësore dhe sigurim i infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor (libra dhe paisje).

Gjithashtu Universiteti Hoëest dhe Ho Gent të Belgjikës në kuadër të bashkëpunimit me Universitetin "Luigj Gurakuqi" kanë realizuar në Fakultetin Ekonomik me Departamentin Turizëm një aktivitet të përbashkët katër ditore nga data 21 deri 24 Mars 2022 duke sjellë paketa konkrete produktesh turistike inovative për Rajonin e Shkodrës duke përkrahur idetë e reja nga trendet e target grupeve dhe të tendencave të reja të lëvizjes turistike.

Evidence 2.13 Lista e marreveshjeve të USH

**Standardi II.20 Institucioni bashkëpunon me institucionet të tjera në mbështetje të veprimtarisë së tij akademike, administrative, kërkimore-shkencore/artisike dhe praktikave profesionale.**

USH-ja bashkëpunon me instanca të tjera për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve, në kuadrin e praktikave profesionale (me DAR Shkodër, Gjykata e rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokuroria e

Rrethit Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Shkodër, NGO etj.), ofrimin e akomodimit të studentëve (me SHA “Studenti”) etj.

USH-ja bashkëpunon me partnerë të tjerë për plotësimin e nevojave të veta në funksion të realizimit të programeve të studimeve si p.sh., Junus Emre Center etj., mbështetje nga ambasadat italiane, për të ndihmuar procesin e mësimdhënies së gjuhës së huaj në departamentet e gjuhëve të huaja; për lehtësimin e veprimtarive kulturore e sportive me Bashkinë Shkodër. Të gjithë fakultetet e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore, etj, si p.sh., me DAR Lezhë, ZVA Shkodër, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Prokurorinë e Rrethit Shkodër, Spitalin Rajonal të Shkodrës, OJQ, etj.), Fakulteti Ekonomik ka siguruar bashkëpunime me disa Institucione Publike si Bashkia Shkodër, Prefektura Shkodër, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Zyra e Punës Shkodër, Drejtoria Rajonale e Trashigimisë kulturore Shkodër dhe të bizneseve të Rajonit të Shkodrës në kuadrin e punës kërkimore dhe aktiviteteve të ndryshme që realizon si panairë biznesi, evente të promovimit të ofertave turistike etj.

Po ashtu, FSHSH ndjek një strategji të hapur bashkëpunimi dhe partneriteti në nivel vendor me institucionet vendore, si Bashkia Shkodër, Drejtorinë racionale të Arsimit, Zyrën Vendore të Arsimit, Institucionet kulturore; Në nivel kombëtar me institucionet homologe në Tiranë e rrethe, me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe me Akademinë e Studimeve Albanologjike; Në nivel ndërkombëtar me Universitete të Rajonit dhe me gjerë, po ashtu është pjesë e programeve europiane, si: Erasmus Plus dhe CEEPUS.

Evidence 2.13 Lista e marrëveshjeve të USH

Evidence 2.14 Marrëveshje me institucione FSHE

### **Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar. (Kreu III Standardi III.4)**

USH-ja dhe stafi akademik merr pjesë në aktivitete ndërkombëtare sa herë që është i ftuar dhe ka prezantuar kumtesa në konferenca, kongrese kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe organizon vetë aktivitete ndërkombëtare, si p.sh., konferenca shkencore, simpoziume, etj.

Universiteti ka lidhur një sërë marrëveshjesh formale, që iu ofrojnë stafit dhe studentëve mundësinë për të marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare. Pjesëmarrja e stafit dhe e studentëve në veprimtari ndërkombëtare është një element kyç, i cili ka dhe një peshë të madhe në strategjinë e zhvillimit të USH-së. Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Lidhur me këtë fakt janë rritur ndjeshëm aplikimet për secilën thirrje. Gjatë periudhës 2021-2022 universiteti ka pasur 15 mobilitete të stafit akademik për mësimdhënie dhe për trajnim administrativ, gjithashtu 19 mobilitete të studentëve.

Gjatë këtij viti akademik departamentet kanë kryer krahasime të kurrikulave që ofrojnë me kurrikula që ofrojnë Universitetet Perëndimore me të cilët USH-ja ka marrëveshje.

USH-ja ndjek një politikë për integrimin e personelit akademik të ftuar dhe të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të institucionit ashtu edhe të tyre. Personeli

akademik ftohet në kuadrin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë, në kuadrin e ligjëratave akademike për trajnimin e stafit akademik, në kuadrin e projekteve Erasmus + etj. (Evidence 1.25). Në kuadrin e projekteve ndërkombëtare ku është i përfshirë FE realizon në mënyrë të vazhdueshme mobilitete të stafëve akademike dhe të studentëve ku në mënyrë të veçantë një rol të rëndësishëm kanë luajtur projektete Erasmus +, CEEPUS dhe Marrëveshja me Sandhills Community College si një avantazh që FE e ka shfrytëzuar në aplikimet e të gjitha programeve të reja. Në kuadrin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e SIUC (Southern Illinois University at Carbondale), SCC (Sandhills Community College), Universitetin e Bolonjes, Universitetin e Varshaves, Universitetin e Ebersældit janë realizuar disa botime dhe punime kërkimore të stafit të FE me stafet perkatese të këtyre Universiteteve Perendimore (Evidencë 1.26, shkresa për mobilitetet e stafit e studentëve)

Evidence 2. 15 Pjesmarrje në konferenca FSHE

Evidence 2.16 Shkresa për mobilitetet e stafit e studentëve FE

### **Standardi II.22 Institucioni kryen studimin e tregut për realizimin e misionit dhe qëllimit të tij.**

Institucioni informohet në mënyrë të vazhdueshme për zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit, po ashtu dhe ndërmjet bashkëpunimeve me institucione të tjera apo dhe nga pjesëmarrja në konferenca të cilat trajtojnë çështje të zhvillimeve rajonale.

Institucioni monitoron punësimin e të diplomuarve të vet, nga njësia e departamentit në një periudhë 1- vjeçare nga mbarimi i studimeve. Prej tre vitesh USH kanë ngritur një bazë të dhënash për Alumnin. Zyra e Këshillimit të karrierës pasuron bazën e të dhënave çdo vit akademik.

Çdo fakultet ka ngritur një grup pune për hartimin e studimit në nivel universiteti për studimin e tregut punës, ku përfshihen të gjitha fakultetet me qëllim garantimin se programet e tyre vazhdojnë të jenë në përputhje me reformën dhe zhvillimet ekonomike në të gjithë vendin.

FE kryen studime mbi tregun lokal të punës për programet e studimit që ofron përpara hapjes së tyre, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës, e në veçanti nga komunikimi direkt me punëdhënësit gjatë Panairit të Punës. Në Fakultetin Ekonomik realizohen studimet e tregut të punës në kuadrin e aplikimit në MAS për hapjen e programeve të reja të studimit në nivel Bachelor, Master apo Doktorature por me mbështetje financiare të dedikuar këto studime duhet të bëhen periodike për të kuptuar ndryshimet në nevojat e tregut dhe për t'iu adoptuar me ofertën akademike të përditësuar në kohë.

Ka përpjekje në FSHE për të bërë studimin e tregut të punës si dhe përpjekje për të kryer monitorimin e punësimit të të diplomuarve ndër vite, megjithatë duhet që institucioni të angazhohet më shumë për realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut.

Në mënyrë periodike FSHSH kryen studimin e tregut mbi bazën e Strategjisë të Studimit të Tregut, të miratuar nga Universiteti i Shkodrës më 2017: dhe të ripunuar më 2022. Studimi i



tregut nuk kryhet vetëm në nivel institucional, por edhe për programe të veçanta studimi.

Evidencë 2.17 Studimi i tregut të punës

Evidencë 2.18 Shkresa për Panairin e Punës FE

### **Përfundimet dhe Vlerësimi**

USH zhvillon një procedurë transparente lidhur me rekrutimin e personelit, bazuar në Rregulloren e punësimit. Të gjitha njoftimet publikohen në faqen zyrtare të USH-së, si dhe në Buletinin e APP-së (Agjencia e Prokurimit Publik).

USH bën përpjekje për të zbatuar një politikë integruese të personelit. Ka një bashkëveprim të mirë mes stafit akademik me kohë të plotë dhe atij me kohë të pjesshme, mes departamenteve dhe fakulteteve si për realizimin e procesit mësimor, ashtu edhe për realizimin e veprimtarive të ndryshme, si p.sh., konferenca, aktivitete të ndryshme, etj. Po kështu, për realizimin me sukses të procesit mësimor, stafi akademik bashkëpunon me sekretarinë mësimore për çdo aspekt që lidhet me sekretarinë. Nga ana tjetër, edhe personeli administrativ është gjithmonë i gatshëm për të asistuar pranë stafit për çdo problem teknik apo për ta pajisur stafin me guida ndihmëse, si p.sh. Udhëzues për platformën Teams, SMAK etj.

Ka një bashkëveprim të mirë për koordinimin e punës mes dekanateve të fakulteteve të ndryshme. Në disa programe studimi zhvillojnë mësim kolegë nga fakultetet e tjera. Cdo fillim viti akademik, bazuar në nevojat e departamenteve, përgjegjësit hartojnë shkresat përkatëse dhe i dërgojnë tek Dekani. Dekani dërgon shkresat për nevojat për pedagogë tek fakultetet përkatëse dhe, në këtë mënyrë, studentit i sigurohet mësimdhënia e duhur, me specialistë të fushës.

USH bën përpjekje për të vlerësuar aftësitë e personelit. Politika e secilit Fakultet në këtë drejtim konsiston në disa pika, të tilla si: a) marrja e fidebikut lidhur me programin e studimit nga studentët që diplomohen; b) analizimi i raporteve të vetëvlerësimit të programeve të studimit në departamentet përkatëse e, më pas, në dekanat; c) analiza e punës mësimore-shkencore në departamente e në dekanat; d) diskutimi dhe miratimi i sylabuseve të lëndëve në mbledhje të departamenti, etj. Duhet theksuar se ka përpjekje për vlerësimin e performancës, por akoma nuk kemi një produkt të mirëfilltë, me të gjitha aspektet dhe mënyrat e matjes së performancës.

Të gjitha departamentet i kushtojnë vëmendje dhe zhvillimit të veprimtarive të ndryshme me studentët. Studentët nxiten që të marrin pjesë në veprimtari ekstrakurrikulare, të marrin pjesë në veprimtari të përbashkëta të realizuara me organizata të ndryshme. Po kështu, vlen të theksohet pjesëmarrja e studentëve tanë në veprimtari artistike dhe sportive, si dhe vullnetarizmi i shfaqur nga studentët tanë në drejtime të ndryshme, si dhurim gjaku, etj.

Të gjitha departamentet kanë në përbërjen e tyre staf të kualifikuar, me kohë të plotë, që realizon programet e studimit të ofruara prej tyre. Po kështu, edhe përzgjedhja e stafit akademik me kohë të pjesshme bëhet mbi bazën e rankimit të kandidatëve, bazuar në Rregulloren e punësimit. Tashmë, disa programe studimi janë në procesin e akreditimit për herë të parë.

Ka përpjekje nga institucioni për të mbështetur personelin për realizimin e detyrimeve dhe për rritjen profesionale të tij.

Godina e FSHE-së ka nevojë për përmirësim të vazhdueshëm, gjë që pasqyrohet edhe në shkresat e dërguara. Është realizuar akti i ekspertizës për çatinë e godinës dhe pritjet ndërhyrja për rregullimin e saj.

Fakulteti disponon mjedise dhe infrastrukturën e duhur për veprimtarinë akademike-shkencore. Duhet theksuar se ka vend për përmirësim.

USH përpiqet të menaxhojë mirë asetet që ka në dispozicion, duke u kujdesuar për mirëmbajtjen e tyre dhe për ristrukturimin e tyre në rast nevojë. Në përgjithësi, ambientet janë të pastra, me ngrohje, i kushtohet kujdes i madh pastrimit, ajrosjes dhe dezinfektimit të tyre. Ka ndërgjegjësim në rritje për përmirësimin e aksesibilitetit të studentëve me aftësi të kufizuara.

USH disponon dokumentacion të plotë. Ruajtja e dokumentacionit është në nivel departamenti, në nivel dekanati dhe në sekretarinë mësimore, Zyra Protokoll-arkiva.

Institucioni ve në përdorim sisteme të informimit dhe të menaxhimi në nivel institucional.

U-Albania, University Albania" <https://ualbania.al>, është një portal që përfshin të gjitha informacionet dhe shërbimet në lidhje me universitetet në Shqipëri. Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), i cili i ofron Universitetit një hapësirë të dhënash për mësimdhënie, mësim, hulumtim, menaxhimin e burimeve njerëzore, financiare dhe administrative. SMAK <https://smak.unishk.edu.al/home>, është një program aplikimi akademik për rezultatet e nevojshme për menaxhimin akademik. Programi mësimor i programeve të studimit mund të gjendet, gjithashtu, në këtë portal, por programet mësimore nuk janë të dukshme. IAL ka një ëebpage [ee.unishk.edu.al](http://ee.unishk.edu.al), ku publikohen statistika periodike për programet e studimit, veprimtaritë e Universitetit dhe njësive akademike, përkatësisht departamenteve të tyre, publikimin e dokumenteve të USH-së, si: Statuti i Universitetit, rregulloret funksionale dhe të tjera. Brenda USH-së, ekziston Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë e cila kujdeset për fushat e teknologjisë së informacionit, në këtë mënyrë duke pasqyruar veprimet e njësive akademike dhe departamenteve të tyre me orare mësimore, orare të provimeve, njoftime për aktivitete akademike dhe vendime të ndryshme të Universitetit.

USH-ja punon për informatizimin në çdo hap të punës student - sekretari mësimore- staf akademik. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë në USH bashkërendon veprimtaritë në fushën e teknologjisë së informacionit, duke pasqyruar përmes tyre oraret e mësimin, datat e provimeve, strukturën organizative, organigramën, detyrimet e studentit, tarifën e studimit, vlerësimet e studentëve, veprimtarinë akademike dhe sociale të USH-së. ([ee.unishk.edu.al](http://ee.unishk.edu.al)).

Universiteti në hartimin e buxhetit bazohet në kërkesat e sjella nga fakultetet. Dekanatet i bazojnë kërkesat e tyre në nevojat e departamenteve, të cilat specifikohen në një mbledhje të veçantë. Më pas bëhet miratimi në Senatit akademik.

Fakulteti i nënshtrohet auditit financiar të brendshëm dhe të jashtëm dhe rezultatet, në të dy rastet, u prezantohen organeve kolegjiale në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë", (i ndryshuar).

Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë

lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Edhe FSHE e ka një objektiv të tillë.

Departamentet e vlerësojnë shumë bashkëpunimin me institucionet e tjera. Ka një sërë marrëveshjesh të natyrave të ndryshme, si: bashkëpunim si partner në projekte të ndryshme, bashkëpunim për realizimin e praktikave mësimore. Mobiliteti i stafit në USH realizohet përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme shkencore, si: konferenca, mësimdhënie, pjesëmarrje në projekte të ndryshme, etj.

Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.

Ka përpjekje në USH për të bërë studimin e tregut të punës si dhe përpjekje për të kryer monitorimin e punësimit të të diplomuarve ndër vite, megjithatë duhet që institucioni të angazhohet më shumë për realizimin e një studimi të mirëfilltë të tregut.

**Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen kryesisht.**



### **III – PROGRAMET E STUDIMIT, MËSIMDHËNIA DHE VLERËSIMI**

#### **Standardi III.1 Institucioni ofron programe në përputhje me misionin, strategjinë e tij të zhvillimit dhe kërkesat e tregut.**

IAL ofron programe studimi në tre ciklet e studimit. Programet e studimit janë të njohura për publikun, dhe janë gjithashtu të disponueshme në faqen e internetit të Universitetit të Shkodrës.

<https://unishk.edu.al/studimi-ne-unishk/cikli-i-pare-i-studimeve-bachelor/2021-2022>

USH organizon aktivitete të rëndësishme nën moton "Ditët e Hapura" në shkollat e mesme të qytetit dhe më gjerë, si dhe vendos kontakte të drejtpërdrejta me drejtorët e shkollave të mesme.

[https://unishk.edu.al/en/full-activity?tx\\_nees\\_pi1%5Baction%5D=detail&tx\\_nees\\_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx\\_nees\\_pi1%5Bnees%5D=755&cHash=52551ae781739eff1ae217b4f93ab7c2](https://unishk.edu.al/en/full-activity?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=755&cHash=52551ae781739eff1ae217b4f93ab7c2)

IAL ofron një gamë të gjerë të programeve bachelor të studimit në mënyrën që ato sintetizohen në atë variant, që pasi të ketë përfunduar studimet, studenti ka mundësinë të punojë në tregun e punës ose të vazhdojë nivelin e Masterit në programe afërsisht paralele.

#### **Standardi III.2 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me objektivat kombëtarë dhe ndërkombëtarë.**

Programet e studimit në USH janë në përputhje me bazën ligjore dhe në përputhje me objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Programet e studimit kanë ngjashmëri me programe të ngjashme në vend bazuar në Ligjin nr.80/2015 datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Kurrikulat e programeve janë hartuar duke marrë parasysh edhe kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda vendit apo jashtë tij. Ata, gjithashtu, kanë mundësi punësimi jashtë vendit.

Institucioni ka të parashikuar në strategjinë e tij politikën e bashkëpunimit. USH ka një sërë lidhjesh me Universitete të huaja të shprehura në marrëveshje bashkëpunimi. Disa nga këto marrëveshje kanë rezultuar shumë të rëndësishme për USH-në duke ndihmuar stafin e ri të universitetit në kualifikimin shkencor si dhe duke ndihmuar në ngritjen e disa laboratorëve mësues dhe shkencorë.

Institucioni merr parasysh nevojat e ekonomisë vendase dhe të tregut të punës në hapjen e programeve të reja ose hartimin e projekteve kërkimore shkencore. Çdo program i ri studimi që hapet në USH, hapet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë ku parashikohet kryerja e studimit të tregut të punës.

Një ndër prioritetet e Universitetit është ndërkombëtarizimi i Universitetit të Shkodrës. Në këtë drejtim është punuar si në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes

Universitetit të Shkodrës dhe Universiteteve të tjera të rajonit, Evropës apo dhe Amerikës ashtu si në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik.

USH bën përpjekje për të siguruar koherencë me programe të ngjashme studimi të universiteteve të tjera në vend e më gjerë, në rajon. Multikulturaliteti, gjithashtu, si koncept, përveçse me module të veçanta, zë vend edhe përmes lëndëve të veçanta të cilat ofrojnë mësimin e gjuhës së huaj. Përfshihen kulturat që flasin anglisht, italisht, frëngjisht, gjermanisht, gjuhën malazeze etj. Në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të FE-së, projekti FINAC është finalizuar me hapjen e masterit në "Menaxhim Financiar, Kontabilitet dhe Kontroll në Administratën Publike". Po kështu edhe projekti MARDS, në bashkëpunim me universitete prestigjioze europiane është finalizuar me hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë Doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm i Qëndrueshëm".

Programet e studimit në USH janë në përputhje me bazën ligjore dhe në përputhje me objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Është hapur tashmë programi i studimit Bachelor në Gjeografi dhe zhvillim territori i cili është në përputhje me objektivin kombëtar të zhvillimit të vendit drejt parimeve të qëndrueshmërisë.

Evidenca 3.1-Planet mësimore FSHE

**Standardi III.3 Programet kanë objektiva të përcaktuar qartë dhe rezultatet e tyre të të nxënit përputhen me nivelin e profilit kualifikimit që ofrojnë.**

Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit, informacioni që jepet në këto programe është i plotë, duke filluar që me emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, vendimet e hapjes, objektivat formues, karakteristikat, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, plani mësimor, etj. (Evidenca 3.1).

Programet e studimit u bëhen të ditura studentëve çdo fillim viti akademik, ku njihen me elemente bazë të tij, si dhe me parimet bazë të Kodit të Etikës të USH-së për pjesën që i përket studentëve. Në rast transferimi të studimeve studentët pajisen me të gjitha të dhënat nga Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standardeve.

Programet e studimit kanë të përcaktuara qartë objektivat e tyre. Ato kanë hartuar objektiva të përcaktuar qartë në lidhje me përfshirjen e dijeve, njohurive dhe zotësive që duhet të përvetësojë një student i programit përkatës. Lëndët dhe ngarkesat e tyre në kurrikula përputhen me objektivin e programit për të përgatitur specialistë të zotë në fushën përkatëse.

USH, ofron programe studimi në përputhje me profilit e institucionit, duke i miratuar ato. Oferta akademike e programeve të studimit është në përputhje me të gjithë komponentët e strategjisë për zhvillimin e USH. Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit mund të themi se ato janë lehtësisht të kuptueshme. Informacioni që jepet në to është i plotë, duke filluar që me emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, planin mësimor, objektivat formues, literaturën, vendimet e hapjes, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse, strukturat bashkëpunuese, etj.

Programet respektojnë Vendimin Nr. 879, dt. 18.12.2019 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". [VKM Nr.879, date 18.12.2019.pdf](#)

([google.com](http://google.com))

#### **Standardi III.4 Institucioni përcakton qartë dhe ndjek procedurat për miratimin e programeve të reja.**

Rritja e nevojave të vendit për specialistë të ndryshëm të programeve të studimit që mbulon USH, ka qenë një shtysë e veçantë për hapjen e programeve të reja. USH ka bërë përpjekje të vazhdueshme për ofrimin e programeve të tjera të studimit, në fusha të tilla, si: turizëm, redaktori, territor, trashëgimi kulturore, fushën e shkencave të natyrës, shkencave të edukimit etj., në përputhje me zhvillimin e vendit dhe kërkesat e tregut. USH ndjek procedura të caktuara për hartimin dhe miratimin e programeve të studimit në Përputhje me Udhëzimin Nr. 1, datë 14.01.2020 për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë. [Udhëzimi-nr.-1-dt.-14.01.2020..pdf \(arsimi.gov.al\)](#). Aplikimi për programet e reja e merr fill në departament, i cili e propozon dhe punon për përpilimin e tij, kalon miratimin në njësinë kryesore, në senat, bordin e administrimit dhe më pas vazhdon procedura e aplikimit në u-Albania.

Evidenca 3.2-Vendim hapje program studimi FSHE

#### **Standardi III.5 Programet e studimeve ofrohen në përputhje me kapacitetet e institucionit.**

Programet e studimit në USH janë në përputhje me kapacitetet e fakultetit, si ato akademike, ashtu edhe kapacitete infrastrukturore.

Ngarkesa mësimore e pedagogut në USH është ngarkesa e plotë vjetore prej 1536 orësh. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në USH janë: a)mësimdhënie; b)kërkimi shkencor ose artistik; c)kontribut institucional; d)kontribut profesional. Në fakultete ka pasur vazhdimisht rekrutime të stafit akademik me kohë të plotë, me qëllim që pjesa më e madhe e lëndëve të mbulohen me pedagogë me kohë të plotë. Normalisht, ka edhe staf akademik me kohë të pjesshme, në varësi edhe të specialiteteve që mbulojnë, me qëllim që studentëve t'u ofrohet cilësi sa më e mirë në mësimdhënie. Edhe kapacitetet infrastrukturore mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit në USH.

Departamentet, çdo fillim viti akademik diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës, bazuar tek Udhëzimi nr.20, datë 09.05.2008 "Për veprimtarinë e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë" (për vitin akademik 2017-2018) dhe tek Udhëzimi Nr.29, datë 10.09.2018: "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë". Udhëzimi Nr.36, datë 23.11.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë",

Evidenca 3.4-Model kontrate pedagogu USH

### **Standardi III.6 Programet e studimit janë të organizuar në cikle studimi.**

Programet bachelor të ciklit të parë të studimit u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e njëjta Master pas përfundimit të studimeve. Programet e studimit të ciklit të parë lejojnë studentin të mbledhë kredite (ECTS) për programin e veçantë dhe të aplikojë për studime të mëtejshme në nivelin e Masterit. Studimet Master ofrojnë trajnime themelore të studentëve duke zgjeruar fushat e studimit në një masë dhe thellësi më të madhe. Pas përfundimit të studimeve bachelor, studentët kanë mundësinë të hyjnë në tregun e punës për punësim. Universiteti ka krijuar gjithashtu Alumni i cili do të jetë një pasqyrim i studentëve të punësuar në tregun e punës pas diplomimit.

Fushatat paraprake të IAL-ve duke filluar nga maturantët e shkollave të mesme e deri tek studentët e kolegjit janë jashtëzakonisht të dobishme për studentët në orientim. Ekzistojnë udhëzues të përgatitur (Guida studentore) të cilët janë të dobishëm për studentët në orientim. Orientimi më i lehtë për studentët është faqja e internetit e Universitetit.

Angazhimi i stafit akademik në departamentet e tyre përcaktohet me përparësi nga mësimdhënia dhe kërkimi. Kontributi i pedagogëve është gjithashtu në nevojat e shërbimeve të ndryshme për përpilimin e raporteve të ndryshme të punës si RVB, rregulloret etj.

Programet e nivelit master janë hartuar bazuar në nevojat e tregut të punës dhe si dhe në vazhdimësinë e studimeve nga niveli bachelor. Për realizimin e programeve të tilla USH bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike, dhe kryesisht në drejtim të praktikave.

Gjithashtu, USH ofron dy programe studimi të ciklit të tretë të studimeve, përkatësisht në FSHSH dhe FE. Këto programe synojnë të nxisin kërkimin shkencor në një fushë ose në një nënfushë të caktuar, duke u orientuar drejt krijimit, thellimit, rikonceptimit dhe riintegritimit të njohurive shkencore për të sjellë risi në mendimin shkencor.

Evidence 1.20 Lista e programeve të reja të hapura në USH viti akademik 2021-2022

### **Standardi III.7 Programet e studimeve nga cikli në cikël hartohen me qëllim mirëorientimin dhe përfundimin gradual të njohurive nga studentët.**

Programet bachelor u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e cikleve pasardhëse falë njohurive solide që u ofrojnë studentëve. USH krijon të gjitha lehtësitat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kritereve akademike dhe infrastrukturore dhe fillimin e një cikli të ri studimesh. Secili tip i veprimtarisë (veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm, veprimtari në disiplina të formimit karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme ose dhe integruese, disiplina me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës) ka në përbërjen e tij lëndët përkatëse, të cilat bazohen në sylabuse bashkëkohore, të ngjashme me ato të universiteteve të huaja. Sylabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatuara të huaja dhe të viteve të fundit.

Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në

programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.

Programet e studimeve “Master i Shkencave“ hartohen në mbështetje të politikave kërkimore të Universitetit dhe në përputhje me strategjitë e këtij institucioni, të cilat janë sanksionuar si tek Statuti i USH-së 2011, ashtu dhe tek Strategjia e USH-së .

Studentët mbikëqyren për mbarëvajtjen e tyre në procesin mësimor, këshillohen për kërkimin shkencor dhe shkrimin e eseve, këshillohen për vështirësitë që ata ndeshin, si dhe për përgatitjen e temës së diplomës, me qëllim përfundimin me sukses të vitit respektiv të studimit apo të diplomimit për studentët e vitit të fundit. Pedagogët dhe studentët, gjithashtu, përdorin edhe komunikimin on-line.

Në programet e disa lëndëve parashikohen edhe minikërkime shkencore apo dhe projekte kursi me natyrë kërkimore, të organizuar nga vetë studentët dhe të mbikëqyrura nga pedagogu i lëndës.

Evidenca 3.3- Model sylabusi

### **Standardet III.8 Institucioni ofron programe të të nxënit gjatë gjithë jetës.**

Universiteti ka ngritur Zyrën e Ekselencës, që, ndër të tjera, ka si funksion edhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor:  
<file:///C:/Users/Hp/Desktop/Printim%202/Rregullore%20e%20Zyres%20se%20Ekselences.PDF>

Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar është pjesë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, të Universitetit “Luigj Gurakuqi”, i krijuar në kuadër të Projektit “Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të mësuesve në Shqipëri” (TEAVET) (ERASMUS+) **Maj 2019-Qershor 2020**. Disa fakultete kanë qenë pjesë e grupit të punës të përfshirë në projektin Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Shqiptare – Europiane VALEU-X, në kuadër të të cilit u ngrit edhe Laboratori. Në kuadër të këtyre projekteve janë realizuar vazhdimisht trajnime me stafin akademik dhe jo-akademik për çështje të mësimdhënies, të kërkimit shkencor, hartimit të projekteve dhe sigurimit të cilësisë: Valeurx Project (unishk.edu.al). Implementation of VCL modules under VALEU-X project (unishk.edu.al) Projekti “EntrAL”.

Të nxënësit gjatë gjithë jetës si terminologji të politikëbërjes, USH nuk e sheh të lidhur vetëm me parimin e programeve të studimeve përtej universitare, apo me krijimin e Qendrave të Edukimit të vazhduar brenda juridiksionit të Universitetit por edhe me filozofinë e mësimdhënies si dimension i shtrirjes të të nxënit.

Pedagogët e FSHSH përpiqen t’i aktivizojnë studentët jo vetëm brenda mureve të Fakultetit, por edhe në veprimtarinë shkencore e kulturore të qytetit e më gjërë, nëpërmjet veprimtarive e botimeve të ndryshme, si veprimtarë apo ndjekës. Shih *botimet e pedagogëve dhe studentëve të*

Gegnia: [http://ëëë.bibliotekashkoder.com/gegna\\_info.php?idm=356124](http://ëëë.bibliotekashkoder.com/gegna_info.php?idm=356124) ;  
[http://ëëë.bibliotekashkoder.com/gegna\\_info.php?idm=356124](http://ëëë.bibliotekashkoder.com/gegna_info.php?idm=356124)

**Standardi III.9 Programet e studimeve mbështeten në profilin kërkimor dhe profesional të njësisë dhe realizohen në bashkëpunimin me aktorë të fushës.**

Programet e studimeve synojnë të përgatisin profesionistë të aftë, duke gërshtuar anën teorike me atë praktike. Një gjë e tillë pasqyrohet në tipat e disiplinave të cilat jepen në formatin e përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Angazhimi i stafit akademik në departamentet e tyre përcaktohet me përparësi nga mësimdhënia dhe kërkimi. Kontributi i pedagogëve është gjithashtu në nevojat e shërbimeve të ndryshme për përpilimin e raporteve të ndryshme të punës si RVB, rregulloret etj.

Programet e studimit të ciklit të parë realizojnë një formim bazë të studentit, duke lejuar një kalim progresiv nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë, pa pasur përsëritje nga njëri cikël tek tjetri. USH krijon të gjitha lehtësirat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kriteve akademike dhe infrastrukturore dhe fillimin e një cikli të ri studimesh.

Programet e nivelit master janë hartuar bazuar në nevojat e tregut të punës dhe si dhe në vazhdimësinë e studimeve nga niveli bachelor. Për realizimin e programeve të tilla USH bashkëpunon me aktorë të fushës ekonomike, dhe kryesisht në drejtim të praktikave.

Secili departament i USH-së ofron programe studimi në përputhje me profilin e tij.

Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve dhe rregullores së programit të studimit (**Evidenca 3.6 në AMS**).

Objektivat e programeve të studimeve synojnë formimin e njohurive bazë tek studentët, me qëllim aftësimin e tyre për tregun e punës.

Baza ligjore për zbatimin e koherencës mbështetet tek LAL (80/2015) si dhe tek Statuti dhe Rregullore e USH-së. USH në përmbajtjen e saj harmonizon kompetencat e përgjithshme me ato profesionale. Aktivitetet e parashikuara në secilën disiplinë shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e këtyre kompetencave. USH garanton kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve në ambientet e USH-së dhe në bashkëpunim me institucione të tjera lokale si ato publike dhe private. Institucionet vendore shtetërore me të cilat bashkëpunohet janë: Bashkia Shkodër, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, DAR, Spitali rajonal Shkodër, organizata të shoqërisë civile jofitimprurëse, institucione të nivelit lokal, institucione financiare, zyra finance dhe kontabiliteti etj.

Evidenca 3.6-Model diplome dhe suplementi

Evidence 2.13 Lista e marreveshjeve të USH

Formim praktik i studentëve është realizuar edhe në institucione jashtë vendit të parashikuara



nga marrëveshja e nënshkruar me Sandhills Community College, në Karolinën e Veriut, SHBA dhe nga ky bashkëpunim edhe në resorte prestigjioze amerikane për intership një-vjeçar i studentave të turizmit në SHBA.

Në disa raste marrëveshjet e bashkëpunimit parashikojnë krahas stazhit profesional edhe kurse trajnimi dhe integrim me tregun e punës.

USH mbikëqyr praktikën profesionale nën drejtimin e pedagogëve të caktuar me ngarkesën përkatëse sipas planit mësimor bazuar në Rregulloren e Studimeve të USH-së.

Praktikat profesionale mbikëqyren nga pedagogët përkatës të cilët raportojnë për ecurinë e zhvillimit të saj pranë departamentit përkatës mbështetur në programet përkatëse të studimit.

Përpara fillimit të praktikës studentët pajisen me një dokument të lëshuar nga Fakulteti që i drejtohet institucioneve ku do të zhvillohet praktika, duke u kërkuar atyre gatishmërinë për pranimin e studentëve dhe angazhimin e tyre si praktikantë. Mbas përfundimit të praktikës, studentët pajisen nga institucioni ku kanë zhvilluar praktikën me një dokument që vërteton angazhimin e tyre pranë këtij institucioni. Pas këtij prezantimi ata vlerësohen me notën përkatëse, e cila bazohet në rezultatet e mbikëqyrjes nga ana e pedagogut si dhe në prezantimin final.

#### **Standardi III.10 Programet e studimeve monitorohen në mënyrë periodike.**

Programet e studimeve janë në monitorim të vazhdueshëm, si nga ana e Rektoratit, ashtu dhe nga departamentet që i ofrojnë.

Fakultetet sigurojnë organizimin dhe dokumentimin efikas të planit mësimor, programeve të studimeve për Ciklin e parë dhe Ciklin e dytë. Programet e studimit të ofruara nga USH plotësojnë kriteret strukturore, organizative si dhe kriteret lidhur me personelin akademik, duke u mbështetur në nevojat e tregut të punës si dhe në objektivat e zgjerimit të sistemit të arsimit të lartë. Procesi i hartimit dhe mbikëqyrjes së planeve mësimore është evidentuar në Rregulloren USH-së.

Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së çdo programi të studimeve nëpërmjet Analizës mësimore që realizohet çdo vit. USH ka një paketë me instrumente për sigurimin e cilësisë që përbëhet nga: raporte, CV, pyetësorë. Çdo vit hartohen Raportet e Vlerësimit të Brendshëm që i shërbejnë monitorimit periodik.

#### **Standardi III.11 Programet e studimeve janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të rritjes së cilësisë.**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programet e studimeve përmirësohen, bëhen ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikëkrediteve, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një kurrikul bashkëkohore .

Departamentet e USH në Fakultetet përkatëse organizojnë për çdo vit akademik mbledhje të veçanta me tematikë "Analiza e punës mësimore", "Analiza e punës shkencore", "Rezultatet e vlerësimit të procesit mësimor nga studentët" etj. Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet puna e bërë nga pedagogët për zbatimin e lëndëve sipas programeve të studimit dhe puna shkencore e

secilit pedagog. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës. Studentët e USH-së përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe në atë të programeve të studimeve. Realizohen edhe pyetësorë anonimë me studentët për të vlerësuar aspekte të ndryshme të punës mësimore. Kështu dy herë në vit, në përfundim të semestrit të parë dhe të dytë realizohen anketime me studentë, të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, lidhur me vlerësimin e procesit mësimor dhe punës së pedagogut të realizuar në lëndët/modulet përkatëse. Për pedagogët e rinj të rekrutuar realizohen kontrole nga departamenti gjatë procesit mësimor si dhe analizohet puna shkencore e pedagogut.

Për të gjitha programet e studimit, diskutimi dhe miratimi i planeve mësimore për vitin akademik pasardhës bëhet fillimisht në departament. Në këtë fazë diskutohet plani mësimor dhe pedagogët titullarë të lëndëve të dhëna paraqesin propozimet përkatëse për ndryshim të ngarkesës. Mbas mbledhjes së departamentit, përgjegjësi i tij harton planin e ri me ndryshimet përkatëse të cilat paraqiten më pas në Dekanat e prej aty në Senat për miratimin përfundimtar në mbledhjen përkatëse të Senatit të USH-së.

Studentët e USH-së përmes dhënies së feedback-ut të tyre në lidhje me procesin mësimor, bazuar në plotësimin e pyetësorëve në fund të çdo semestri kontribuojnë në përmirësimin e realizimit dhe zbatimit të programeve të studimit. Rezultatet e pyetësorëve dhe sugjerimet e studentëve bëhen objekt diskutimi në mbledhjet e njësive bazë. Këto rezultate, gjithashtu, janë pjesë e integruar e vlerësimit të brendshëm dhe ndihmojnë në realizimin e analizës SËOT që i bëhet çdo program studimi në përfundim të tij.

Cilësia e programeve të studimeve vlerësohet edhe nga statistikat e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi. Institucioni monitoron punësimin e të diplomuarve të vet, nga njësia e departamentit në një periudhë 1-vjeçare nga mbarimi i studimeve. Një rol të rëndësishëm luan edhe hartimi dhe përditësimi i "Strategjisë së studimit të tregut të punës".

Evidenca 3.5 -Ndryshime në programin e studimit

Evidenca 3.6-Model diplome dhe suplementi

### **Standardi III.12 Institucioni ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.**

Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes:

-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në departament (**Evidenca 3.5**). Pedagogët sugjerojnë ndryshimet përkatëse në programin e studimit. Më pas shkresa kalon në Dekanat dhe më pas në Senat. Senati akademik, në një mbledhje të veçantë miraton ndryshimet e propozuara, nëse e gjon të arsyeshme.

-marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve që diplomohen (**Evidenca 1.18**).

-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore". Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet puna e bërë nga pedagogët për zbatimin e lëndëve sipas programeve të



studimit dhe puna shkencore e secilit pedagog. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh, me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës.

-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e sylabuseve", ku secili pedagog pasqyron verbalisht sylabuset e lëndëve dhe ndryshimet që ka bërë krahasuar me vitin akademik paraardhës, duke i argumentuar ato ndryshime që ka bërë (**Evidenca 3.3**).

-Diskutimin dhe miratimin çdo vit të RVB-ve për secilin program studimi (**Evidenca 1.17**).

Edhe Dekanati e ndjek këtë proces. Në dekanat analizohet puna mësimore-shkencore e Fakultetit, miratohen ndryshimet që departamentet sjellin për programet e studimit, miratohen RVB-të e programeve të studimit. USH ka krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që e monitorojnë cilësinë, siç janë GVB-të e programeve të studimit dhe NjSBC-ja e Fakulteteve.

Për të garantuar trajnim të vazhdueshëm për përmirësimin e mësimdhënies FE në bashkëpunim me FSHE ka përmirësuar punën e Qendrës së Ekselencës. Kjo qendër ka organizuar (**Evidenca 4. 14 në AMS**) aktivitete të ndryshme trajtuese për pedagogët në bashkëpunim edhe me Institucione të tjera. Së fundmi, me vendim të Senatit Akademik nr. 249, datë 17.07.2019 është miratuar ndryshimi i emërimit në Zyrën e Ekselencës.

### **Standardi III.13 Programet e studimeve të shpallura zbatohen sipas strukturave të miratuara në nivel institucional dhe kombëtar.**

Secili departament ofron programe studimi specifike dhe është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtyre programeve.

USH ofron programe të studimeve në përputhje me Procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme sipas sistemit: Bachelor, Master,

Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Në përmbajtjen e tyre përfshihet informacion i mjaftueshëm i cili krijon një ide të qartë për vëzhgues vendas apo të huaj. Ato përfshijnë informacion të detajuar lidhur me disiplinat, lëndët apo modulet, kompetencat, kriteret e pranimit, disiplina me zgjedhje të studentit, me njohuri formuese dhe tezë diploma, të gjitha këto në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Vendosija e krediteve përbën një hap të rëndësishëm për të arritur standardet evropiane të arsimit të lartë.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar (**Evidenca 3.18 në AMS**).

Stafi i secilit Fakultet bën përpjekje që programet e studimit të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70% me programe të së njëjtës fushë studimi, në përputhje edhe me Ligjin nr.80/2015, datë 22.7.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 86 pika 2. Studentët, gjithashtu, informohen edhe për mundësinë e studimit në vende të huaja.

Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lehtësimin e studentëve për të ndjekur në vazhdimësi studimet e mëtejshme edhe në universitete të tjera në arenën ndërkombëtare.

Mësimi i gjuhëve të huaja është në përputhje me politikën e internacionalizimit të studimeve. Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njëra nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, gjuhë malazeze, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, bazuar në Udhëzim Nr. 52, datë 3.12.2015 *azhornuar me Udhëzimin nr. 5, datë 16.02.2017, Udhëzimin nr. 11, datë 10.04.2017, Udhëzimin nr. 20, datë 22.09.2017* “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”.

Evidenca 3.6-Model diplome dhe suplementi

### **Standardi III.14 Programet e studimeve mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive dhe aftësive të fituara nga studentët në kurset teorike.**

Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e sylabuseve të lëndëve. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve dhe seminareve. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara edhe orë laboratorit. Diskutimet dhe projektet e kursit i ndihmojnë studentët që ta ruajnë informacionin e fituar edhe pas mbarimit të kursit. Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e sylabuseve të lëndëve edhe përmes bashkëpunimit me institucione vendore dhe OJF-ve, duke krijuar mundësinë që ekspertë të fushave përkatëse të sjellin praktikat dhe ekspertizën e tyre tek studentët. Disa programe studimi zhvillojnë praktika dhe ekspedita në terren.

Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës.

Bazuar tek Udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë”, dhe tek Vendim Nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, një nga tipat e veprimtarisë është “Përgatitje e tezës së diplomës”. USH ka përgatitur Udhëzues për këtë. Me Vendimi SA nr 393, datë 22.11.2019 ka miratuara “Paketën e udhëzimeve të provës finale në Universitetin e Shkodrës”

(E

vlefshme

tek:

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/Vendime\\_Senati/4139\\_12062020121508.PDF](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/Vendime_Senati/4139_12062020121508.PDF)

Fakulteti ka përgatitur udhëzues më të detajuar për studentët për përgatitjen e punimeve të

diplomave për tre llojet e programeve të studimit që ofron.

Secili nga departamentet, me mbledhje të veçanta në semestrin e parë cakton pedagogët udhëheqës për studentët duke u bazuar në: preferencat e studentëve, disiplinat e studimit dhe përshtatjen e tyre me profilin dhe kualifikimin e pedagogut udhëheqës. Pas miratimit të temave/fushës së studimit dhe pedagogëve udhëheqës, listat përkatëse depozitohen pranë Dekanatit. Pedagogët udhëheqës organizojnë punën me studentët sipas një grafiku të përcaktuar në bashkëpunim me studentët, si dhe përmes komunikimit on-line.

USH-ja bën përpjekje për përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Studentët e USH-së, gjithashtu, kanë marrë pjesë në mbështetjen e njësisive bazë për organizimin e Konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare të organizuara në këtë institucion. Stafi i USH-së, gjithashtu, ndjek politika mbështetëse për pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete kulturore dhe edukative, të organizuara nga fakultetet të cilat ndihmojnë në formimin profesional të tyre. Janë organizuar disa aktivitete të kësaj natyre si konferenca ndërkombëtare, aktivitetet për 25 vjetorin e FE-së, Panairi i punësimit, Ëorkshopi i Studentëve 'Sfidat e Zhvillimit rajonal', ëorkshopi i studentave të turizmit 'Ruajtja dhe përmirsimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të Shqipërisë në kushtet e krizes aktuale ekonomike'. dhe trainimet në fushën e fiskaliteteve dhe trainimi për Export Manager, trajnimi në sektorin e mikëpritjes, ku studentët janë angazhuar si mbështetës apo edhe përfitues të këtyre trajnimeve

Në Qershor 2022 u organizua nga studentët e FSHSH Gjeografisë konferenca "Gjeografia vlen". Organizimi i kësaj Konference është kthyer tashmë në traditë për studentët e programeve të gjeografisë. (1) Facebook. Gjithashtu, edhe Fakultetet e tjera kanë organizuar aktivitete të larmishme.

Evidence 2.7 Lista e aktiviteteve me impakt social në FE

Evidenca 3.1-Planet mësimore FSHE

### **Standardi III.15 Programet zhvillohen me qëllim përfshirjen aktive të studentëve në përfitim të kompetencave.**

Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e lëndëve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në sylabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave u mundëson përvetësimin më mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehjetë punës së pavarur. Programet e studimit, në përgjithësi, kanë të parashikuara edhe praktika profesionale . Praktikatat profesionale realizohen në kuadër të marrëveshjeve institucionale me institucione vendore publike si dhe përmes bashkëpunimit me sektorin privat. Institucionet vendore shtetërore me të cilat bashkëpunohet janë: Bashkia Shkodër, DAR, Shërbimi i Provës, Zyra vendore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Drejtoria Rajonale e SH.S.SH-së Shkodër, OJF "THE DOOR", Fototeka "Marubi", Muzeu Historik Shkodër, organizata të shoqërisë civile, jofitimprurëse dhe

me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut.

Programet e studimeve të FSHSH synojnë që studentët në përfundim të studimeve të zotërojnë kompetencat të cilat janë të pasqyruara në Rregulloren e Studimeve e datës 25.05.2019. Vendimi i Senatit akademik nr. 182 date 28.05.2019.pdf (unishk.edu.al) Në aspektin e kompetencave, programi formon dhe zhvillon kompetenca të përgjithshme, speciale dhe të transferueshme, të cilat mundësojnë menaxhim dhe transformim të konteksteve të punës, qëndrim të pavarur, performancë të efektshme.

Evidenca 3.1-Planet mësimore FSHE

Evidenca 3.2-Vendim hapje program studimi FSHE

### **Standardi III.16 Programet e studimeve synojnë përgatitjen e studentëve për punësim.**

Duke iu referuar përmbajtjes së programeve të studimit në USH konstatohet se lëndët e modulet e përfshira në këto programe formojnë profesionistë në fushat përkatëse.

Në përgjithësi, programet e studimit përmbajnë praktika mësimore. Praktika kryhet në institucione dhe shoqata me të cilat USH-ja ka marrëdhënie bashkëpunimi.

Të gjitha programet janë të organizuara sipas tipeve të veprimtarive të përcaktuar tek Udhëzimi nr.15, datë 04.04.2008 "Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë" dhe tek Vendim Nr.41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".

Gjithashtu për herë të parë Universiteti i Shkodrës realizon bërjen e një intershipi 1-vjecar në SHBA në fushën e turizmit për studentë që ndjekin studimet Bachelor e Master në fushën e Turizmit. Për vitin akademik 2021-2022 kanë kryer 11 studentë intershipin 1-vjecar në SHBA tek OLD EDWARDS Resort (E vlefshme në linkun: Aktivitete të ëbsite të USH: Mbi ceremoninë promovuese më 18.06.2021) Në kuadrin e programit të intershipit 'Italian Summer' në sektorin e turizmit në shtetin italian mori pjesë një studentë Bachelor Turizmit për intership 3 muaj në rrjetin e hoteleve me 5 vje në shtetin italian. Në kuadrin e projektit belg 'EOË Albania' Universiteti HoËest dhe HoGent të Belgjikës në bashkëpunim me Universitetin "Luigj Gurakuqi" kanë realizuar në Fakultetin Ekonomik me Departamentin Turizëm një aktivitet të përbashkët katër ditorë nga data 21 deri 24 Mars 2022 duke sjellë paketa konkrete produktesh turistike inovative për Rajonin e Shkodrës duke përkrahur idetë e reja nga trendet e target grupeve dhe të tendencave të reja të lëvizjes turistike.

Gjithashtu 22 studenta të turizmit kanë marrë pjesë në trajnimin në kuder të projektit "Trajnimi në punë në sektorin e mikpritjes dhe të agroindustrisë" të realizuar nga qeveria gjermane përmes GIZ-SRD në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Ky projekt synonte orientimin në karrierë të studentëve të turizmit dhe trajnimin e tyre në bizneset hotelerike të suksesshme dhe të qëndrueshme në sektorin e turizmit për të ofruar shërbime bazuar në standardet ndërkombetare ISO për këtë industri

Evidence 2.13 Lista e marreveshjeve të USH

### **Standardi III.17 Programet e studimeve synojnë të nxisin mobilitetin e studentëve shqiptarë dhe të huaj.**

Në USH, ashtu si në të gjithë instituconin, ofrohen programe të studimeve në përputhje me Procesin e Bolonjës. Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Në përmbajtjen e tyre përfshihet informacion i mjaftueshëm i cili krijon një ide të qartë për vëzhgues vendas apo të huaj. Ato përfshijnë informacion të detajuar lidhur me disiplinat, lëndët apo modulet, kompetencat, kriteret e pranimit, disiplina me zgjedhje të studentit, me njohuri formuese dhe tezë diploma, etj.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar.

Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lehtësimin e studentëve për të ndjekur në vazhdimësi studimet e mëtejshme edhe në universitete të tjera në arenën ndërkombëtare.


Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njëren nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, gjuhë malazeze, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimi edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.

Ka pasur përmirësim në drejtim të mobilitetit të studentëve gjatë vitit akademik 2021-2022.

Studentët e FE-së në të gjitha nivelet e studimit, kanë aplikuar për studime në universitete perendimore në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare me partnerë perëndimore në rrjetin **CEEPUS dhe Erasmus +**.

Çdo vit, një ose dy studentë të programit të gjeografisë zhvillojnë një ose dy semestra në Universitetin e Vechta-s në Gjermani. Përshtatja e tyre me programin atje ka qenë në rrjedhë normale dhe pa vështirësi. Deri tani nga ky program shkëmbimi kanë përfunduar 7 studentë.

Evidenca 3.6-Model diplome dhe suplementi



**Standarde III.18 Institucionet pajisin studentët që kanë shlyer të gjitha detyrimet e një programi studimi, me diplomën përkatëse, e cila është dokument zyrtar.**

Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në Rregulloren e studimeve.

Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit.

Rregullat dhe kërkesat e provimit të diplomës, janë të miratuara nga strukturat universitare përgjegjëse dhe janë të njohura për të gjithë përmes "Rregullores së studimeve", të shpallur publikisht në ëbsite-n e USH-së si dhe në mjediset e Fakulteteve.

USH bën të njohura kriteret dhe procedurat e diplomimit duke i shpallur në stendat e fakultetit përkatës brenda afateve të përcaktuara në mbledhjet e departamenteve. Sistemi i vlerësimit në USH bazohet në rregulloret e studimit të lartpërmendur, në një kohë që regjistrimi i studentëve për mbrojtjen e diplomës bëhet paraprakisht on-line në sistemin Pitagora.

Bazuar në nenin 30 të Rregullores së Studimeve në USH-së dhe në Rregulloren e USH-së anonimiteti është i respektuar gjatë korrigjimit të provimeve nëpërmjet sistemit të sekretimit të materialeve të provimit. Pas vlerësimit me pikë të tezës së provimit, bëhet ç'sekretimi në prani të komisionit, i cili i jep përgjigjen secilit prej studentëve sipas afateve të përcaktuara po në këto rregullore.

Studenti ka të drejtë të ankohet për vlerësimin e tij të pamerituar. Ankesa bëhet me shkrim sipas procedurës së përcaktuar në rregulloret e sipërpërmendura. Nëpërmjet sistemit "Pitagora" studentët në USH kanë akses në rezultatet personale të provimeve duke respektuar plotësisht parimin e konfidencialitetit. <https://ushk.pitagora.rash.al/login>

**Evidenca 3.6-Model diplome dhe suplementi**

**Standardi III.19 Institucioni siguron laboratorë të dedikuar në mbështetje të programeve të studimit dhe kërkimi shkencor/artistik.**

USH siguron shërbime të palëve të treta në përputhje me nevojat e tregut. Ekzistojnë laboratorë brenda njësive akademike në të cilat ato ofrojnë shërbime për njësitë institucionale të jashtme, si dhe shërbime të drejtpërdrejta për popullatën, siç është laboratorit mikrobiologjik dhe fizioterapia në FSHN.

USH-ja ka një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të tij; me salla leksionesh, seminaresh, biblioteka, laboratorë, sekretari, zyra për pedagogët etj. USH-ja bën përpjekje, në përputhje me mundësitë financiare për sigurimin e mjediseve në dispozicion të veprimtarisë së personelit akademik.

Në FSHE ka laboratorë cilësorë, të tillë si: Laboratori i Trajnimeve të Edukimit të Vazhduar, (krijuar me vendim të Senatit Akademik të USH nr. 264, datë 15.07.2019), laboratorit në kuadër të projektit T@ask.



FSHSH ka laboratorët e informatikës (Gis) në Gjeografi, të Gazetarisë, të Gjuhës, të Formimit të vazhduar që kanë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimit.

Evidenca 3.8-Projekti T@sk

Evidenca 3.9 Labororet FSHSH

**Standardi III.20 Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime në mbështetje të programeve të studimit.**

USH vazhdimisht pajis kërkuarit me mjete dhe materiale që ndihmojnë në punën e tyre si ndërtimi i laboratorëve kërkimorë shkencorë dhe ndihmon edhe vijimësinë e tyre duke ndihmuar me bazë materiale.

**Standardi III.21 Biblioteka, infrastruktura dhe shërbimet e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore të lidhur me fushat e studimit dhe kërkimit në programe.**

Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale.

Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, Ulibrary. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT-së së Universitetit të Shkodrës ka mundësuar aksesin ndaj shërbimit të kësaj librerie dixhitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e Universitetit.

Revista “Buletini Shkencor”, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on -line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë.

USH ka një bibliotekë që ofron literaturë për studentët ku secili fakultet ka fondin e tij të librave në shërbim të studentëve. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask. Vitin e fundit, 4 libra të fushës së ekonomisë, në versionin origjinal, por të përkthyer në gjuhën shqipe, i janë dhuruar asaj nga projekti CleanScore i financuar nga AADF (5 kopje për secilin). Ato i janë dhuruar gjithashtu edhe pedagogëve të këtij fakulteti, të cilët kanë filluar t’i përdorin pasi përbëjnë literaturën më të fundit e më cilësore që përdoret sot në fushën e menaxhimit dhe financës.

Akt Dhurim AADF Albana Borici BN - Shortcut.lnk

Programet e lëndëve kanë të mirëpërcaktuar literaturën bazë dhe atë ndihmëse Literatura bazë për mbulimin e lëndëve në programet e studimit sigurohet nga pedagogët përkatës përmes librave në gjuhën shqipe apo cikleve të leksioneve. Pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët në sigurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj.

Evidenca 3.10-Lista e librave T@sk-kontratë shtesë

Evidenca 3.11-Aksesi në bibliotekën online U library

Evidenca 3.12-Njoftim Buletini i Shkencave të Edukimit



## **Përfundimet dhe Vlerësimi**

Në USH ofrohen programe studimi në tre cikle, cikli i parë dhe cikli i dytë (Master i Shkencave dhe master profesional) dhe cikli i tretë. Këto programe janë në përputhje me misionin e Fakultetit që i ofron.

Programet e studimit në USH janë në përputhje me bazën ligjore dhe në përputhje me objektivat kombëtarë e ndërkombëtarë. Programet e studimit kanë ngjashmëri me programe të ngjashme në vend bazuar në Ligjin nr.80/2015 datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Kurrikulat e programeve janë hartuar duke marrë parasysh edhe kurrikulat e programeve të ngjashme të huaja. Në këtë mënyrë, studentët tanë kanë mundësi studimi të mëtejshëm në universitete të tjera brenda vendit apo jashtë tij. Ata, gjithashtu, kanë mundësi punësimi jashtë vendit.

Bazuar në elementet përbërëse të programeve të studimit, informacioni që jepet në këto programe është i plotë, duke filluar që me emërtimin, kohëzgjatjen, pikëkreditet, vendimet e hapjes, objektivat formues, karakteristikat, mundësitë për punësim, struktura akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, plani mësimor, etj.

Programet e studimit në USH janë në përputhje me kapacitetet e fakulteteve, si ato akademike, ashtu edhe kapacitete infrastrukture.

Ngarkesa mësimore e pedagogut në USH është ngarkesa e plotë vjetore prej 1536 orësh. Veprimtaritë që kryen personeli akademik në IAL janë: a)mësimdhënie; b)kërkimi shkencor ose artistik; c)kontribut institucional; d)kontribut profesional. Në fakultete ka pasur vazhdimisht rekrutime të stafit akademik me kohë të plotë, me qëllim që pjesa më e madhe e lëndëve të mbulohej me pedagogë me kohë të plotë. Normalisht, ka edhe staf akademik me kohë të pjesshme, në varësi edhe të specialiteteve që mbulojnë, me qëllim që studentëve t’u ofrohet cilësi sa më e mirë në mësimdhënie. Edhe kapacitetet infrastrukture mundësojnë zhvillimin e programeve të studimit në USH.

Programet bachelor u japin mundësi studentëve që të ndjekin studimet në programet e cikleve pasardhëse falë njohurive solide që u ofrojnë studentëve. USH krijon të gjitha lehtësitat për përfundimin e studimeve në kushte të mira brenda kriterëve akademike dhe infrastrukture dhe fillimin e një cikli të ri studimesh. Secili tip i veprimtarisë (veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm, veprimtari në disiplina të formimit karakterizues, veprimtari në disiplina të ngjashme ose dhe integruese, disiplina me zgjedhje, njohuritë tjera formuese dhe teza e diplomës) ka në përbërjen e tij lëndët përkatëse, të cilat bazohen në sylabuse bashkëkohore, të ngjashme me ato të universiteteve të huaja. Sylabuset janë, gjithashtu, të bazuara në literatuara të huaja dhe të viteve të fundit. Programet e studimit janë të hartuara në mënyrë të atillë që lejojnë mundësinë e transferimit në programe të tjera homologe, bazuar në kreditet e fituara. Burimi i informacionit merret përmes rregullores përkatëse të studimeve.

Programet e studimeve “Master i Shkencave“ hartohen në mbështetje të politikave kërkimore të Universitetit dhe në përputhje me strategjitë e këtij institucioni, të cilat janë sanksionuar si tek Statuti i USH-së 2011, ashtu dhe tek Strategjia e USH-së .



USH-ja bën përpjekje për të realizuar formimin e vazhduar si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Zyra e Ekselencës, ndër të tjera, ka si funksion edhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies përmes trajnimeve të pedagogëve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejtat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", programet e studimeve përmirësohen, bëhen ndryshime në emërtimin e lëndëve, në numrin e pikëkrediteve, në mënyrë që studentëve t'u ofrohet një kurrikul bashkëkohore.

USH ndjek një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Një objektiv të tillë departamentet e realizojnë përmes:

-diskutimit dhe miratimit të ndryshimeve për programet e studimit në një mbledhje të veçantë në departament. Pedagogët sugjerojnë ndryshimet përkatëse në programin e studimit. Më pas shkresa kalon në Dekanat dhe më pas në Senat. Senati akademik, në një mbledhje të veçantë miraton ndryshimet e propozuara, nëse e gjykon të arsyeshme.

-marrjes në konsideratë edhe të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve që diplomohen.

-organizimit çdo vit të mbledhjes "Analiza e punës mësimore dhe shkencore". Gjatë këtyre mbledhjeve analizohet puna e bërë nga pedagogët për zbatimin e lëndëve sipas programeve të studimit dhe puna shkencore e secilit pedagog. Evidentohen arritjet, problematikat dhe vështirësitë të cilat bëhen objekt diskutimesh, me qëllim përmirësimin e tyre dhe përcaktohen objektivat për vitin pasardhës.

-organizimit çdo vit të mbledhjes me tematikë "Miratimin e sylabuseve", ku secili pedagog pasqyron verbalisht sylabuset e lëndëve dhe ndryshimet që ka bërë krahasuar me vitin akademik paraardhës, duke i argumentuar ato ndryshime që ka bërë.

-Diskutimin dhe miratimin çdo vit të RVB-ve për secilin program studimi.

Edhe Dekanati e ndjek këtë proces. Në dekanat analizohet puna mësimore-shkencore e Fakultetit, miratohen ndryshimet që departamentet sjellin për programet e studimit, miratohen RVB-të e programeve të studimit. Cdo fakultet ka krijuar dhe janë funksionale mekanizmat që e monitorojnë cilësinë, siç janë GVB-të e programeve të studimit dhe NjSBC-ja e Fakultetit.

Studentët e USH-së përfshihen në vlerësimin e programeve të studimeve.

Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e sylabuseve të lëndëve. Lëndët dhe modulet e programeve të studimit, në përgjithësi, realizohen nëpërmjet orëve të leksioneve dhe seminareve. Në disiplina të veçanta janë të parashikuara edhe orë laborator. Diskutimet dhe projektet e kursit i ndihmojnë studentët që ta ruajnë informacionin e fituar edhe pas mbarimit të kursit. Stafi bën përpjekje për integrimin e elementëve praktikë në realizimin e sylabuseve të lëndëve edhe përmes bashkëpunimit me institucione vendore dhe OJF-ve, duke krijuar mundësinë që ekspertë të fushave përkatëse të sjellin praktikat dhe ekspertizën e tyre tek studentët. Disa programe studimi zhvillojnë praktika dhe ekspedita në terren. Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës.

Programet e studimit kanë në përmbajtjen e tyre informacion të mjaftueshëm dhe koherent për studentët. Në programet e studimeve janë të paraqitura rubrikat përkatëse në përputhje me bazën ligjore. Programet e lëndëve përditësohen me prurjet më të reja të literaturës bashkëkohore. Pedagogët kanë të parashikuara në sylabuset e tyre edhe projekte kursi për vlerësimin e studentëve, zhvillimi i të cilave u mundëson përvetësimin më të mirë të lëndës dhe zhvillimin e shprehjetë punës së pavarur. Programet e studimit, në përgjithësi, kanë të parashikuara edhe praktika profesionale. Praktikant profesionale realizohen në kuadër të marrëveshjeve institucionale me institucione vendore publike si dhe përmes bashkëpunimit me sektorin privat. Institucionet vendore shtetërore me të cilat bashkëpunohet janë: Bashkia Shkodër, DAR, Shërbimi i Provës, Zyra vendore Shkodër, Spitali Rajonal Shkodër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, Drejtoria Rajonale e SH.S.SH-së Shkodër, OJF "THE DOOR", Fototeka "Marubi", Muzeu Historik Shkodër, organizata të shoqërisë civile, jofitimprurëse dhe me institucione të tjera të sektorit privat dhe shtetëror që operojnë në zonën e Veriut.

Duke iu referuar përmbajtjes së programeve të studimit në USH konstatohet se lëndët e modulet e përfshira në këto programe formojnë profesionistë në fushat përkatëse.

Në përgjithësi, programet e studimit përmbajnë praktika mësimore. Praktika kryhet në institucione dhe shoqata me të cilat USH-ja ka marrëdhënie bashkëpunimi.

Në USH, ashtu si në të gjithë institucionin, ofrohen programe të studimeve në përputhje me Procesin e Bolonjës. Programet e studimit përmbajnë objektiva të qarta dhe përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programeve të studimit. Në përmbajtjen e tyre përfshihet informacion i mjaftueshëm i cili krijon një ide të qartë për vëzhgues vendas apo të huaj. Ato përfshijnë informacion të detajuar lidhur me disiplinat, lëndët apo modulet, kompetencat, kriteret e pranimit, disiplina me zgjedhje të studentit, me njohuri formuese dhe tezë diploma, etj.

Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar.

Programet dhe planet mësimore janë objekt diskutimesh e përmirësimesh të vazhdueshme dhe u janë nënshtruar rishikimeve, në përputhje jo vetëm me kërkesat e akteve të reja nënligjore, por edhe duke reflektuar sugjerime që vijnë nga stafi akademik, studentët apo institucionet me të cilat bashkëpunohet. Hartimi i programeve është realizuar edhe në bazë të konsultimeve me programe të ngjashme studimi kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bërë të mundur lehtësimin e studentëve për të ndjekur në vazhdimësi studimet e mëtejshme edhe në universitete të tjera në arenën ndërkombëtare.

Studentët që përfundojnë një program studimi të nivelit Bachelor zhvillojnë dy gjuhë të huaja, përkatësisht: në vitin e parë të studimeve zhvillojnë gjuhën angleze, në vitin e dytë të studimeve zhvillojnë njërin nga gjuhët e huaja: frëngjisht, italisht, gjermanisht, turqisht, gjuhë malazeze, në formën e lëndës me zgjedhje. Studentët e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë kanë kriter pranimit edhe njohjen e dokumentuar të një nga pesë gjuhët e huaja: anglisht,

frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.

Pasi kanë kryer të gjitha detyrimet, studentët kanë të drejtën e diplomimit, provim me shkrim apo punim teme, bazuar në Rregulloren e studimeve.

Pas marrjes së vlerësimit pozitiv, studentët pajisen me diplomën përkatëse, e shoqëruar me suplementin. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe ka informacion të hollësishëm rreth programit të studimit dhe vlerësimit të studentit.

Në USH ka laboratorë cilësorë në secilin Fakultet, ku kryesisht në FSHN këta laboratorë janë në funksion edhe të ofrimit të shërbimeve për palë të treta.

Infrastruktura duhet përmirësuar. Ky fakt është prezantuar dhe në shkresat e dërguara.

Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale.

Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, Ulibary. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT-së së Universitetit të Shkodrës ka mundësuar aksesin ndaj shërbimit të kësaj librerie dixhitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e Universitetit.

Revista “Buletini Shkencor”, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on -line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë.

Vlerësimi i fushës: **Standardet përmbushen plotësisht.**



## IV- AKTIVITETI SHKENCOR / ARTISTIK DHE INOVACIONI

### **Standardi IV.1 Institucioni përcakton fushat parësore të aktiviteteve kërkimore, shkencore/artistike.**

Në strategjitë e US-së janë përcaktuar dhe qëllimet dhe objektivat kryesore si:

- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies, me qëllim formimin e specialistëve të aftë.
- Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët.
- Monitorimi i cilësisë së programeve të studimit.
- Përmirësimi i aksesit për studentët me nevoja të veçanta.
- Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.
- Rritja e bashkëpunimit me komunitetin

Fushat parësore të aktiviteteve kërkimore shkencore janë përcaktuar nga Senati i Universitetit të Shkodrës në vendimin nr. 97, datë 29.03.2022, "Për miratimin e fushave prioritare kërkimore në Universitetin e Shkodrës", ku përcaktohen si parësore Albanologjia, Biodiversiteti dhe ndotja e mjedisit, Ekonomi dhe turizëm i qëndrueshëm, Integrimi evropian, Reforma në drejtësi, Shkencat sociale dhe pedagogjike dhe studimet territoriale. Në varësi të fushave dhe karakteristikave të secilit Departament, USH i përmbahet këtyre pikave në zhvillimin e aktivitetit kërkimor.

Fakultetet kanë miratuar planin strategjik 2022-2026. Misioni i Fakulteteve vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimdhënies dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushat përkatëse. Secili fakultet në USH punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimdhënie të kualifikuar, të krijojë kushte për mësim dhe kërkim shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon USH.

Evidenca 1.10 Planet strategjike të FSHE, FE

Evidenca 4.1 Senati akademik. Miratimi i fushave prioritare kërkimore-shkencore.

### **Standardi IV.2 Institucioni zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor.**

Çdo vit secili departament zhvillon analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës.

USH vazhdimisht pajis kërkuesit me mjete dhe materiale që ndihmojnë në punën e tyre si ndërtimi i laboratorëve kërkimorë shkencorë dhe ndihmon edhe vijimësinë e tyre duke ndihmuar me bazë materiale. USH zbaton prioritetet e aktivitetit kërkimor shkencor përmes organizimit të konferencave

shkencore me karakter kombëtar dhe ndërkombëtar, realizimit të mobilitetit të stafit akademik dhe botimit periodik të Buletinit Shkencor. Stafi i USH duke u fokusuar në disiplinat shkencore, në të cilat është i specializuar, mbështet personelin, që është në procesin e doktoraturës, për të përfunduar studimet brenda dhe jashtë vendit duke i krijuar hapësirat e nevojshme për organizimin e ngarkesës vjetore në mënyrë fleksibël.

Evidencë 4.1 Lista e aktiviteteve me impakt social.

Evidencë 4.2 Ftesë në aktivitetin e Bibliotekës Universitare me Departamentin e Letërsisë

### **Standardi IV.3 Institucioni inkurajon zhvillimin, dinamizmin e veprimitarive kërkimore / artistike dhe shkencore.**

Tashmë institucioni mbështet financiarisht stafin akademik lidhur me pjesëmarrjen në konferenca dhe botime artikujsh, gjë që e rrit motivimin për punë shkencore. Ai mbështet vazhdimisht grupet dhe projektet kërkimore shkencore të reja përmes nxitjes së politikave të kërkimit shkencor në mënyrë që stafet të prodhojnë dije e kërkime të reja shkencore. Bashkëpunimi me institucione të tjera kërkimore dhe shkencore brenda dhe jashtë vendit synon përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor, projekte kërkimore etj. Departamentet bashkëveprojnë me njëra-tjetrën dhe me institucione të ndryshme publike apo private brenda dhe jashtë vendit duke ndikuar kështu në përmirësimin e cilësisë së kërkimit shkencor. Me marrjen e vendimit të SA nr. 143 ,datë 14.07.2022 "Për financimin e botimeve dhe pjesëmarrjes në Konferenca Shkencore të stafit akademik të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi " do bëhet e mundur të inkurajohet më shumë kërkimi shkencor i stafit akademik.

FE inkurajon kërkimin shkencor edhe të studentëve nëpërmjet organizimit të përvitshëm të Ëorkshopit : "Sfidat e zhvillimit rajonal". Gjithashtu Departamenti i Turizmit i Fakultetit Ekonomik me datën 06.05.2022 organizoi Ëorkshopin: 'Ruajtja dhe përmirësimi i atraktivitetit turistik në rajonin verior të Shqipërisë në kushtet e krizes aktuale ekonomike' ku studentët e vitit të tretë Bachelor në turizëm, që janë në prag të diplomimit si specialist të turizmit, prezantuan vlerësimin aktual të atraktivitetit të nëntë zonave turistike në rajonin verior të Shqipërisë, ngritën problematikat e konstatuara në këto zona që e gërryejnë cilësinë e atraktivitetit turistik të zonës dhe dhanë ide për zgjidhje, si dhe ide për mundësi potencialesh të tjera turistike të zonave. Gjithashtu, Departamenti i turizmit ka organizuar dy fokus grupe për të inkurajuar studentët për të zhvilluar metoda shkencore në marrjen e opinionëve të aktorëve të turizmit rreth çështjeve me rëndësi për zhvillim turizmi të qëndrueshëm.

FSHSH, FGJH si dhe Fakultetet e tjera inkurajojnë zhvillimin e konferencave shkencore, botimin e artikujve nga pedagogët në Buletinin Shkencor, krijojnë kushtet për formimin e mëtejshëm akademik të stafit të pedagogëve përmes marrëveshjeve me institucione të tjera me karakter shkencor e kulturor. Organizimi i konferencave dhe i botimeve zhvillohet duke ndarë përgjegjësitë shkencore me secilin departament.

Evidencë 4.3.1 Financimi në Konferenca Shkencore

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim\\_nr\\_143\\_dt\\_14-07-2022.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2021-2022/vendime/senati/Vendim_nr_143_dt_14-07-2022.pdf)

Evidencë 4.2 Sfidat e zhvillimit rajonal FE

Evidencë 4.3 Miratimi i rregullores së zyrës së ekselencës, (17/7/2019) e cila nxit kërkimin shkencor të studentëve të Masterit, nëpërmjet punimit të Diplomës:



file:///C:/Users/Hp/Desktop/Dokumente%20per%20akreditimin%20Istutic%202023/Rregullore%20e%20Zyres%20se%20Ekselences.PDF

Evidencë 4.4. Marrëveshje bashkëpunimi për projektin *Clean Score*

Evidencë 4.5. Marrëveshje me Marubin

file:///C:/Users/Hp/Desktop/Dokumente%20per%20akreditimin%20Istutic%202023/Rregullore%20e%20Zyres%20se%20Ekselences.PDF

**Standardi IV.5 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.**

USH ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmendim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e Strategjisë së Zhvillimit. Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike.

Pronësia intelektuale garantohej nga Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të tjera të drejta të lidhura me to”. USH siguron zbatimin e këtij ligji përmes formimit të redaksive shkencore, të cilat marrin vendime mbi botimin e artikujve shkencorë, kumtesave në konferenca etj. Këto Këshilla Shkencore kontrollojnë zbatimin e parimeve të pronësisë intelektuale, marrjen e masave kundër plagjiaturave etj.

**Standardi IV.6 Në zbatim të prioriteteve të kërkimit shkencor/artistik, institucioni kanalizon veprimtaritë e kërkimit në nivel departamenti.**

Në zbatim të Statutit të USH-së (neni 9, pika 2.1) departamentet nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, artistike dhe sportive. Ato kanë grupuar disiplinat mësimore në kuadër të zbatimit të programeve të studimit që mbulojnë. Secili departament planifikon punën e vet shkencore për vitin në vijim, ka edhe bashkëpunime ndërmjet tyre për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera. Në zbatim të Statutit të USH-së (neni 9, pika 2.1) departamentet nxisin, bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, artistike dhe sportive. Mbi bazën e lëndëve dhe punimeve shkencore që bëjnë, stafi akademik krijon eksperiencë në fusha specifike të studimit.

Evidenca 4.6.1 Konferenca shkencore “Jehonë auditorësh”

Evidencë 1.1 Statuti i USH.

Evidencë 4.9 Raport mbi konferencat shkencore [DYSESD 19-20.pdf](#)

Evidencë 4.10 Puna kërkimore shkencore.

Evidencë 4.11 Kopertina e botimit të punës së pedagogëve ndër vite

**Standardi IV.7 Institucioni miraton objektiva të qarta për njësitë, grupet kërkimore / artistike dhe personelin akademik.**

USH ka objektiva të qarta të punës kërkimore, të mishëruara në strategjitë sektoriale, në Strategjinë e përgjithshme.

Nëpërmjet programeve e projekteve, sidomos të QSA, parashtron edhe një politikë të përgjithshme shkencore në vite



Evidencë 4.12 Strategji sektoriale në USH

Evidencë 4.13 Strategji e përgjithshme në USH

**Standardi IV.8 Institucioni synon rritjen e vazhdueshme të veprimtarive kërkimore/artistike e shkencore dhe garanton gjithëpërfshirjen e personelit akademik dhe studentëve të ciklit të dytë dhe të tretë.**

Në USH janë zhvilluar një sërë veprimtarish shkencore, artistike dhe sportive, si dhe veprimtari të tjera në përpjekje për përmirësim të vazhdueshëm duke vendosur si një nga objektivat e punës në vitet në vazhdim rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor.

Në mënyrë periodike, universiteti organizon konferenca shkencore të përbashkëta të pedagogëve dhe studentëve, në mënyrë që të integrojë edhe studentët në kërkimin shkencor në fusha të ndryshme, si psh në: gazetari, histori, albanologji, letërsi, gjuhësi, gjeografi të terrenit, rajone etj.

Evidencë 1.10 Strategjia e FSHE

Evidencë 4.14 Aktivitetet e paraqitura on-line të studentëve

**Standardi IV.9 Institucioni bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor/artistik.**

Rezultatet e veprimtarisë shkencore analizohen në mbledhje të veçanta në nivel departamenti, dekanati dhe më pas në Senat çdo vit.

Institucioni organizon vazhdimisht aktivitete që nxisin debatin shkencor në fushat parësore të kërkimit shkencor, nëpërmjet organizimit leksioneve të hapura, ku stafi akademik angazhohet dhe jep kontributin e tij. Departamentet organizojnë vazhdimisht leksione të hapura me ekspertë të jashtëm në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.

Rezultatet në fushën e kërkimit shkencor bëhen të njohura përmes botimeve të revistave shkencore, promovimit të monografive shkencore të personelit shkencor, konferencave shkencore, raporteve dhe analizave shkencore të përvitshme.

**Evidencë 4.15 Raportim per leksionet e hapura Fe.pdf**

**Evidencë 4.16 Kopertina e botimit të punës së pedagogëve ndër vite.**

**Standardi IV.10 Institucioni është përgjegjës për garantimin e cilësisë së punimeve shkencore/artistike dhe integritetin e tyre në nivel institucional.**

Cilësia e punimeve shkencore përcaktohet nga Këshillat Shkencore dhe komisionet shkencore të formuara nga secili departament. Institucioni vazhdimisht pajis kërkuesit me mjete dhe materiale që ndihmojnë në punën e tyre si ndërtimi i laboratorëve kërkimorë shkencorë dhe ndihmon edhe vijimësinë e tyre duke ndihmuar me bazë materiale.

Evidencë 4.17 Këshillat dhe bordet shkencore të botimit

Evidencë 4.18 2.15 Lista e aktiviteteve me impakt social.pdf





**Standardi IV.11 Institucioni i llojit universitet/akademi përcakton qartë detyrimet për personelin akademik në kuadër të pjesëmarrjes në veprimtari kërkimore, studime, publikime e botime dhe i mbështet për përmbushjen e tyre.**

Çdo vit akademik USH planifikon veprimtaritë shkencore dhe merr masat e nevojshme për menaxhimin e tyre, duke krijuar grupet e punës si struktura mbështetëse dhe logjistike. Në funksion të këtyre veprimtarive vihen auditoret kryesore, të cilat ofrojnë kushte të mira pune. USH ka organizuar konferenca ndërkombëtare dhe ka mundësuar publikimin e materialeve të këtyre konferencave. Së fundmi, inkurajohet stafi për botime dhe pjesëmarrje në konferenca.

Për çdo konferencë apo revistë shkencore, USH përcakton dhe informon qartë pedagogët, përmes faqes zyrtare të institucionit dhe përmes email-it zyrtar mbi kriteret dhe kushtet për pranimin dhe botimin e artikujve dhe kumtesave shkencore.

Evidenca 4.19 Vendim i SA për financim botime e konferenca.

Evidenca 4.20 Ftesë për botim në revistë shkencore austriake në faqen e Universitetit

Evidenca 4.21. Njoftim on-line për botimin e artikujve te seria e shkencave të edukimit.

**Standardi IV.12 Institucioni që ka përcaktuar në strategjinë e vet si prioritet kryesor kërkimin shkencor, fokusohet në ndërkombëtarizimin e kërkimit dhe veprimtarive që lidhen me të.**

Në strategjinë e USH-së rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare, përmirësimi i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, USH ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me universitete të ndryshme evropiane dhe amerikane. Bashkëpunimi mes institucioneve respektive nxit aktivitetet e mëposhtme:

Shkëmbime dhe bashkëpunime reciproke të profesorëve, kërkuesve, studentëve dhe stafit administrativ në nivelin universitar dhe pasuniversitar, organizimi i shkollave verore, seminareve, dhe formave të tjera shkëmbimi njohurish nga palët, shkëmbim literature, teksteve dhe publikimeve universitare, realizimi i projekteve të përbashkëta, shkëmbime eksperiencash.

Janë organizuar vazhdimisht konferenca shkencore dhe stafi akademik i tij ka marrë pjesë në konferenca të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

USH mbështet konferenca dhe veprimtari shkencore ndërkombëtare. Çdo vit akademik, fakultetet dhe stafi administrativ ndërveprojnë mes tyre dhe stafeve të institucioneve homologe duke krijuar borde dhe komitete organizative, për krijimin e kushteve të përshtatshme për mbajtjen e konferencave.

Gjithashtu janë nënshkruar marrëveshje mes USH dhe IAL-ve brenda vendit, marrëveshjen bilaterale me universitete në SHBA, Bashkimin Evropian apo dhe rajonin.

Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Një pjesë e konsiderueshme e botimeve të punimeve të pedagogëve realizohen në revistën "Buletin shkencor" të Universitetit të Shkodrës 'Luigj Gurakuqi' rivlerësuar edhe si i tillë me Urdhër të MASH nr.98, datë 28.03.2000, mbështetur në vendimin nr. 4, datë 1.7.03.2000 të

Komisionit të Rikondensimit të Periodikëve Shkencorë. Personeli akademik nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës si dhe promovon njëkohësisht edhe vlerat dhe traditën e fakultetit përkatës.

Gjithashtu kemi pjesëmarrjet në projekte shkencore në bashkëpunim me universitete apo intitucione të tjera shkencore jashtë vendit. Disa herë në vit organizohen konferenca shkencore ndërkombëtare në FSHSH me pjesëmarrjen e personelit akademik nga vende të tjera. Stafi akademik merr pjesë aktive në konferenca shkencore të organizuara jashtë vendit dhe si botues ne revista shkencore.

Evidencë 4.22 [Sandhill 20130001.pdf](#)

Evidencë 4.23 [Informacion mbi buletin shkencor.pdf](#)

Evidencë 4.24 [Raport mbi konferencat shkencore DYSESD 19-20.pdf](#)

Evidencë 4.25 Thirrje për botim artikujsh on-line

Evidencë 4.26 Shembull botimi në një revistë shkencore në Graz

#### **Standardi IV.13 Institucioni ka prioritet përfshirjen në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të personelit të huaj akademik dhe diasporës..**

Përfshirja e stafit akademik të huaj në veprimtaritë mësimore realizohet kryesisht duke përfshirë si pjesë të stafit pedagogë nga vendet e rajonit apo diaspora arbëreshe me status “të jashtëm” ose “të ftuar”. Përfshirja e tyre në aktivitetet shkencore realizohet përmes bashkëpunimit të vetë Fakultetit ose të departamenteve me personel akademik të huaj në organizimin e konferencave shkencore, ekspozitave me karakter artistiko-shkencor, revistave shkencore etj.

Evidencë 4.27 Shembull aktivizimi në projekt

#### **Standardi IV.14 Institucioni ka prioritet mobilitetin e personelit akademik dhe studentëve dhe siguron mekanizmat për përfshirjen sa më shumë të tyre.**

Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.

Shumë profesorë për periudha të shkurtra studimi japin mësim dhe realizojnë kërkim shkencor në universitete të huaja. Kjo eksperiencë realizohet, pa cënuar procesin mësimor të tyre.

Institucioni përpiket të integrojë kërkuesit shkencorë të huaj nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me studiues të huaj, si: në mësimdhënie, konferenca ndërkombëtare dhe evente të tjera.

Prioriteti është rekrutimi i personelit akademik të kualifikuar në fushën e kërkimit shkencor në funksion të strategjisë për zhvillim të institucionit. USH synon të rekrutojë në fushën e kërkimit shkencor, veçanërisht personat që kualifikimin e kanë kryer në universitete të huaja dhe mbështet stafin aktual në proces kualifikimi jashtë vendi. Një pjesë e mirë e stafit ka kryer të paktën një nivel studimi në universitetet europiane apo dhe në SHBA. Gjithashtu të gjithë janë pjesëmarrës në mësimdhënie në universitete me të cilat USH ka marrëveshje.

Evidencë 4.28 Shembull aktivizimi në projekt

Evidencë 4.29 Marrëveshja me Universitetin e Messinës. Vizitë e prof. M.Geraci.

**Standardi IV.15 Institucioni siguron vazhdimësi dhe rritje të impaktit të tij në fushën e kërkimit shkencor/artistik.**

Në USH ka vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor/artistik, falë kapacitetve të duhura që secili departament ka. Stafi merr pjesë në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, organizon verpimtari artistike dhe sportive me studentët, merr pjesë në projekte të ndryshme, në borde të ndryshme editoriale, etj.

Institucioni ndjek një politikë integruese duke dërguar ftesa kërkuesve të huaj kur vetë institucioni organizon konferenca shkencore apo leksione të hapura. Këto ftesa bëhen në kuadër të ndërkombëtarizimit të universitetit si dhe të bashkëndarjes së njohurive në fusha të caktuara me institucione kombëtare private dhe publike bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit.

Shumë profesorë për periudha të shkurtra studimi japin mësim dhe realizojnë kërkim shkencor në universitete të huaja. Kjo ekspriencë realizohet, pa cënuar procesin mësimor të tyre. Janë organizuar konferenca ndërkombëtare duke mundësuar publikimin e materialeve të këtyre konferencave

USH publikon tërë punimet shkencore të stafit akademik në “Buletinin e shkencave” (i njohur nga të gjitha IAL-të në Shqipëri). USH-ja është pajisur nga Biblioteka Kombëtare me numër ISBN-je, ndërsa për revistat shkencore është i pajisur me numër ISSN-je. Kërkimi shkencor pasqyrohet më së miri në monografitë dhe periodikët që boton çdo vit personeli akademik i USH-së.

Rritja e botimit të artikujve dhe librave sjell edhe rritje të impaktit.

Rritja e impaktit sigurohet edhe me rritjen e numrit të botimeve në revista e botime me faktor të lartë impakti. USH e inkurajon këtë, nëpërmjet pagesës së punimeve, stimulimit të projekteve, sigurimit të lidhjeve me Universitete e Rrjete etj.

Evidencë 4.30 [Raport mbi konferencat shkencore DYSESD 19-20.pdf](#)

Evidencë 4.31 [Informacion mbi buletin shkencor.pdf](#)

**Standardi IV.16 Institucioni siguron transferimin e rezultateve të veprimtarive kërkimore e shkencore në funksion të zhvillimit të vendit, ekonomisë dhe shoqërisë.**

Institucioni ka një veprimtari të pasur shkencore, artistike dhe sportive. Në këtë mënyrë, impakti tek komuniteti është shumëdimensionalësh.

Vlerësimin e rezultateve të kërkimore shkencor e kryejnë departamentet nëpërmjet analizës së punës kërkimore shkencore dhe diskutimeve në kuadrin e aktiviteteve të përqendruara në kërkimin shkencor.

Redaksitë e ngritura në universitet, gjatë procesit të shqyrtimit të artikujve dhe punës kërkimore-shkencore, kujdesen që kjo punë shkencore të jetë origjinale, si dhe të ruhet pronësia intelektuale.

Institucioni mbron pronësinë intelektuale duke dhënë të drejta ekskluzive për studiuesit dhe promovon veprimtarinë kërkimore botuese.

Ndiqet politika e nxitjes së përfshirjes së studiuesve të rinj në projektet kërkimore. USH aktivizon studentët e ciklit të dytë të studimeve me pjesëmarrje në konferenca shkencore të organizuara nga institucioni.

Në kuadër të transferimit të rezultateve në fushën e kërkimit shkencor USH-ja ka nënshkruar marrëveshje me institucione private dhe publike brenda vendit. Një pjesë e madhe e praktikave profesionale të studentëve realizohen pranë bizneseve të ndryshme që veprojnë në rajonin e Veriut të Shqipërisë, si: Dhoma e Tregtisë, banka të nivelit të dytë, kompani, shkolla dhe institucione të tjera të ndryshme, etj.

Buletini i shkencave ekonomike i USH-së ka fituar një përhapje të gjerë geografike duke botuar jo vetëm artikuj nga USH-ja, por nga të gjithë universitetet shqiptare si dhe nga universitetet nga rajoni, si: ai i Podgoricës, Prishtinës, Tetovës, Sarajevës, Zagrebit etj. Ndërkombëtarizimi i "Buletinit shkencor" të USH-së është trajtuar si një ndihmesë në rritjen e nivelit të artikujve të botuar në të si dhe në njohjen e punës shkencore që zhvillon stafi i USH-së.

Institucioni informohet për veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij nëpërmjet analizës së punës shkencore dhe kualifikuese çdo vit.

Programet u sigurojnë studentëve qëndrime dhe vlera që i bëjnë ato të vlefshëm për shoqërinë dhe zhvillimin e vendit.

Evidenca 4.32 MA ëith ROZAF Hotel, Shkoder.PDF

Evidenca 4.33 Raporti i punës shkencore 2021- 2022 FE

Evidenca 4.34 Përshkrim i disa aktiviteteve shkencore nga FSHSH

#### **Standardi IV.17 Institucioni garanton pronësinë intelektuale të arritjeve dhe rezultateve në fushën e kërkimit shkencor dhe i përdor ato me qëllim zhvillimin ekonomik dhe financiar të tij.**

Institucioni ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të institucionit. Mund të përmedim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit të USH-së. Me mjaft interes është dhe zëvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike.

Punimet e pedagogëve mbledhen periodikisht, analizohen, vlerësohen dhe reklamohen. Ato inkurajohen në favor të krijimit të një atmosfere pune dhe respekti për arritjet, por edhe në favor të tërheqjes së studentëve.

#### **Përfundimet dhe Vlerësimi**

USH ka miratuar planin strategjik 2022-2026. Misioni i institucionit vjen në të njëjtën linjë me misionin e USH, duke synuar krijimin, zhvillimin, mbrojtjen dhe transmetimin e dijeve me anën e mësimit dhe të punës kërkimore shkencore, formimin e specialistëve të lartë dhe përgatitjen e shkencëtarëve të rinj në fushën e mësimit në arsimin parashkollor, në arsimin fillo, edukimin fizik, në fushën e arteve dhe në fushat e shkencave sociale me specialitet psikologjinë dhe punën sociale. USH punon në realizimin e objektivave me qëllim që të sigurojë një mësimit të kualifikuar, të krijojë kushte për mësimit dhe kërkimit shkencor si dhe të përgatisë specialistë të aftë në të gjitha disiplinat që mbulon institucioni.

Janë përcaktuar dhe qëllimet dhe objektivat kryesore, që janë:

- Përmirësimi i cilësisë së mësimit, me qëllim formimin e specialistëve të aftë.

- Rritja e cilësisë së kërkimit shkencor.
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për studentët.
- Monitorimi i cilësisë së programeve të studimit.
- Përmirësimi i aksesit për studentët me nevoja të veçanta.
- Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit.

Rritja e bashkëpunimit me komunitetin.

Cdo vit secili departament zhvillon analizën e punës mësimore shkencore, ku, krahas rezultateve të arritura, përcaktohen dhe prioritetet për vitin pasardhës.

Cdo vit Senati Akademik realizon analizën e punës mësimore e shkencore dhe nxjerr në pah pikat e forta e të dobëta, me qëllim përmirësimin e punës. Gjithashtu, çdo vit Senati miraton raportin e vlerësimit të brendshëm. Edhe Dekanati, në mbledhje të veçanta, bën analizën e punës mësimore-shkencore dhe të raportit të vetëvlerësimit.

USH ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të instiucionit. Mund të përmednim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit. Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike.

Secili departament planifikon punën e vet shkencore për vitin në vijim. Ka edhe bashkëpunime ndërmjet departamenteve për organizime konferencash apo veprimtarish të tjera..

Në planin strategjik të USH-së 2022-2026 rritja e cilësisë së kërkimit shkencor përbën një nga objektivat e punës në vazhdim. Theksi vihet tek botimet në revista prestigjioze, Organizimi i një konference ndërkombëtare në nivel fakulteti, Rritja e numrit të pedagogëve pjesëmarrës në borde editoriale ndërkombëtare. Përmirësim i angazhimit të studentëve në punë kërkimore-shkencore.

Duhet punuar më shumë në drejtim të përfshirjes në veprimtaritë mësimore e shkencore/artistike të peronelit të huaj akademik dhe diasporës.

Zyra e marrëdhënieve me jashtë publikon informacione të vazhdueshme në faqen e USH-së në lidhje me veprimtaritë ndërkombëtare, duke përfshirë mundësitë për mobilitetin e stafit dhe studentëve.

USH ka shumë resurse të cilat duhet të përdoren për rritjen financiare të instiucionit. Mund të përmednim ngritjen e Klinikës së shërbimit psikologjik dhe social, që përbën dhe një nga objektivat e strategjisë së zhvillimit.. Me mjaft interes është dhe zhvillimi i trajnimeve në fushën e mësuesisë, apo zhvillimi i veprimtarive sportive e artistike.

USH-ja siguron organizimin dhe dokumentimin efikas të planeve mësimore të cikleve të ndryshme të studimit, në përmbajtjen e programeve harmonizojnë kompetencat e përgjithshme me ato profesionale. Kjo përmbajtje është në qendër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Institucioni vë në dispozicion kapacitete të mjaftueshme për realizimin e formimit praktik e profesional të studentëve. USH garanton tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë të huaj.

Institucioni ka ngritur struktura ndihmëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Për t'iu përgjigjur standardeve të mësimdhënies është e domosdoshme të përditësohet teknologjia në përputhje me standardet bashkëkohore. Një praktikë e mirë është bashkëpunimi ndërmjet departamenteve në organizimin e aktiviteteve trajnuese.

FE-ja mbështet mobilitetin pedagogëve në universitete të tjera jashtë vendit nëpërmjet projekteve lidhur me eksperimentimin e mësimdhënies.

Departamentet, bazuar në profilin dhe traditën e tyre, kanë grupuar disiplinat mësimore në kuadër të zbatimit të programeve të studimit që mbulojnë. Ato inkurajojnë dhe nxisin përpjekjet për kualifikim të mëtejshëm shkencor të stafit. FE-ja ka një përvojë të pasur në fushën e kërkimit shkencor dhe vazhdimisht e ka ndihmuar zhvillimin e tij duke i dhënë prioritet partneritetit me institucione kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni mbështet organizimin e konferencave dhe veprimtarive shkencore. Personeli akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës si dhe promovon njëkohësisht edhe vlerat dhe traditën e fakultetit përkatës. Shpesh iniciativat individuale kthehen në projekte institucionale. USH-ja bashkëpunon me organizma shkencorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë. FE përpiqet të integrojë kërkuesit shkencorë të huaj nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit me studiues të huaj, si: në mësimdhënie, konferenca ndërkombëtare dhe evente të tjera të organizuara.

**Vlerësimi i fushës: Kjo fushë përmbush standardet kryesisht.**



## V – STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### **Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimit dhe përzgjedhjen e studentëve..**

Baza e politikave të pranimit të studentëve në USH është "Strategjia e USH 2022-2026" i cili është dokumenti ku përcaktohen objektivat e institucionit të arsimit të lartë apo të njësisve përbërëse të tij, si dhe mjetet e mënyrat e realizimit të tyre për pesë vitet e ardhshme. Procedurat e pranimit të studentëve në programet e tre cikleve të studimeve bazohen në ligjin Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në "Statutin e USH-së" dhe në Rregulloren e studimeve për çdo cikël studimi.

USH-ja nëpërmjet njësisve bazë dhe njësisve kryesore (fakulteteve dhe departamenteve), si dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës bazuar në Statut dhe rregulloret ofron informacion për studentët e ardhshëm (maturantë), për politikën e pranimit të studentëve dhe për organizimin e programeve të studimit. Kriteret e pranimit të studentëve në programet e cikleve të studimeve përcaktohen nga MAS (udhëzimet dhe kuotat e përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse që nxjerr Këshilli i Ministrave apo MAS për vitin akademik përkatës), Rregullorja e studimeve të USH (Evidence: *Rregullore Studimesh USH.nr. 182 date 28.05.2019 Evidence 1.7 Ndryshime në Rregullore të Studimeve USH Evidenca 1.17.7* ( tre herë ndryshime 22.01.2020, 26.11.2021, 7.11.2022), *Rregullorja e FE Evidence 1.11*).

Procesi i rekrutimit të studentëve të rinj fillon që me prezantimet e programeve të USH tek maturantët e shkollave të mesme të rajonit. Ky mision kryhet çdo vit nga grupe stafi akademik të ngritura në fakultet, nëpërmjet takimeve të organizuara sipas një axhende paraprake, me maturantë të shkollave të mesme në kuadrin e "Ditëve të hapura". Njësitë bazë, në bashkëpunim me njësinë kryesore, përcaktojnë pedagogët përkatës për secilën prej shkollave të mesme të Shqipërisë së Veriut. Gjatë këtyre takimeve bëhet informimi i të rinjve në lidhje me kuotat dhe kriteret e pranimit, si dhe mundësitë e ndryshme të studimit që USH ofron, duke parashtruar dhe eksploruar secilën alternativë studimi. Për secilin prej programeve të studimit pedagogët paraqesin edhe mundësitë që ofron tregu i punës në përputhje me formimin e studentëve të ardhshëm. Në këtë mënyrë nxënësit janë më të qartë paraprakisht për drejtimet që mund të ndjekin pasi përfundojnë studimet Bachelor. Ata marrin përgjigje mbi çdo pyetje që kanë dhe mundësitë e punësimit që secili program studimi ofron. Gjatë këtyre takimeve merren përgjigje mbi pyetjet e ngritura nga nxënësit, diskutimet të ndryshme, etj. Prezantimet në media të aktiviteteve të organizuara nga USH janë gjithashtu pjesë e politikës promovuese ndaj maturantëve.

Rregullorja e USH përmban në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikën e trajtimit të studentëve që nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të studimeve apo transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë



dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit. Kriteret e përgjithshme hartohen duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë dhe në formimin që marrin studentët në maturën shtetërore, duke iu dhënë më shumë përparësi formimit të përgjithshme të studentëve nga shkolla e mesme. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. Informacione të vazhdueshme mbi kriteret e pranimit dhe listat e fituesve sipas rundeve të aplikimeve në USH paraqiten në faqen online të [ëëë.unishk.edu.al](http://ëëë.unishk.edu.al). Pranimi i studentëve në ciklin e dytë të studimeve në programet Master Shkencor dhe Profesional është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të miratuara nga Senati Akademik pas propozimit nga departamentet. Kuotat dhe kriteret bëhen publike për të gjitha programet e studimit që ofron USH duke u shpallur online në faqen [ëëë.unishk.edu.al](http://ëëë.unishk.edu.al) dhe në ambjentet e godinave të fakulteteve.

Çdo cikël i studimeve në USH ndiqet dhe nga studentët e huaj, kryesisht nga trojet shqiptare jashtë territorit kombëtar, bazuar në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe (theksuar kjo në rregulloret e studimeve dhe statutin e USH-së të përmendura më sipër). Procedura për pranimin e studentëve nga trojet shqiptare bazohet në udhëzimin e MAS Nr. 26, dt. 30.07.2018 (Ref. [link](#)). Në faqen [ëeb](#) (Ref.[link](#)) pasqyrohen vazhdimisht informacionet për kuotat dhe kriteret e pranimit ku përfshihen edhe kuotat e studentëve nga trojet dhe të huaj. Në kuotat e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në USH për vitin akademik 2021-2022, përveç kuotave të kandidatëve brenda vendit, janë të parashikuara edhe kuotat e kandidatëve nga trojet (Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë, kandidatëve të huaj, personat me aftësi të kufizuara, me statusin e jetimit, Romë dhe ballkano egjiptian (Ref. [link](#)).

Fakulteti ofron gjithashtu mundësi për studentët e huaj që të ndjekin studimet të lëndëve ekonomike të programeve në gjuhën angleze. Ata kryejnë eksperiencë shkëmbimesh akademike mësimore ose kërkimore nëpërmjet programeve Erasmus dhe CEEPUS. Psh rasti i një studenti nga Universiteti i Varshavës, Poloni që ka ndjekur studimet gjatë një semestri akademik në Fakultetin Ekonomik, Shkodër në kuadër të projektit Erasmus me titull "Sigma". Fakulteti Ekonomik siguron kushtet e nevojshme për mbarëvajtjen e studimeve të tyre.

: [Link https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80](https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80)

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2020-2021/senati/2486\\_senati.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/2486_senati.pdf)

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2020-2021/senati/vendimi\\_nr\\_98.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/vendimi_nr_98.pdf)

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/Vendime\\_Senati/Kritere\\_2021-2022.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/Vendime_Senati/Kritere_2021-2022.pdf)

[https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2020-2021/senati/miratimi\\_i\\_kuotave.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/miratimi_i_kuotave.pdf)

: [https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/2020-2021/senati/vendimi\\_nr\\_98.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/2020-2021/senati/vendimi_nr_98.pdf)

<https://unishk.edu.al/aktiviteti-i->


[plote?tx\\_nees\\_pi%5Baction%5D=detail&tx\\_nees\\_pi%5Bcontroller%5D=Nees&tx\\_nees\\_pi%5Bnees%5D=755&cHash=52551ae781739eff1ae217b4f93ab7c2](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi%5Bnees%5D=755&cHash=52551ae781739eff1ae217b4f93ab7c2)

Evidencë 5.1 Miratimi i kuotave

Evidencë 5.2 [3.2 Relacion ditet e hapura 12 qershor 2019.PDF](#)

Evidencë 5.3 Rregullore e sekretarive mesimore,

Evidencë 5.4 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit.



## **Standardi V.2 Institucioni u ofron mbështetje nëpërmjet shërbimeve universitare për të lehtësuar ecurinë e tyre .**

USH ka pjesë të punës së tij të vazhdueshme mënyrën e organizimit të mësimdhënies, mbështetjen dhe kontrollin e këtij procesi nëpërmjet një plani të caktuar, sistemin e tutoriatit dhe të koordinatorëve të programeve të studimit. Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Bachelor është 3 vite akademike. Numri total i krediteve që duhet të grumbullojë një student për finalizimin e këtij cikli studimi është 180 ECTS. Studentët e këtij programi studimi diplomohen me provim diplome ose tezë diplome. Në përfundim të programit të studimit lëshohet diploma përkatëse.

Nëpërmjet Rregullores së USH dhe Rregullores së studimeve, lektorët informojnë qartësisht studentët lidhur me syllabuset e planin kalendar të lëndëve, kriteret për vlerësimin e dijeve në lëndë të ndryshme të programit të studimit, duke përfshirë këtu: sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit të dijeve, kushtet për hyrjen në provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimit, zhvillimin e provimit, shpalljen e rezultateve, te provimit, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Studenti informohet edhe në mënyrë elektronike përmes emaileve zyrtare të pedagogëve

Personeli akademik i USH është gjithnjë i gatshëm që të komunikojë me kontakt direkt apo email në lidhje me informacionin për leksionet e lëndëve përkatëse, rastet studimore, detyrat e kursit e materiale të tjera. Pedagogët organizojnë seanca konsultimi mbështetëse për studentët për lëndët që ato mbulojnë, në lidhje me vështirësitë që mund të kenë pasur gjatë procesit mësimor. Konsultimet kryhen rregullisht nga pedagogët sipas orareve që afishohen në departamentet përkatëse. Gjithashtu sekretaritet mësimore kanë orare të caktuara pritjeje çdo ditë për nevoja apo sqarime të çështjeve administrative si regjistrime, data, etj.

Secili departament aplikon shërbimin e tutoriatit për studentët. Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin e Etikës, etj. Cdo shqetësim i studentëve përcillet nga pedagogu në departament, ku, zakonisht, gjen zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera.

USH ndjek një politikë të informimit të studentëve nëpërmjet platformës on-line, si dhe ka vendosur një klimë pozitive komunikimi ndërmjet studentëve dhe pedagogëve, i informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit në programet e studimit, sipas Rregullores së studimeve në USH 2013, Kreu IV ([Link](#)), Rregullores së Studimeve në USH 2019, Kreu IV ([Link](#)). Ky informacion është lehtësisht i qasshëm nga të gjithë të interesuarit nëpërmjet faqes së USH-së, ku gjendet i publikuar. Ai u vihet në dispozicion dhe u prezantohet studentëve që ditën e parë të fillimit të studimeve, nga tutorët e më pas u bëhet i njohur edhe gjatë prezantimit të syllabuseve nga pedagogët përkatës.

Burimet e informimit të studentëve janë të shumëllojshme. Në faqen e USH-së publikohen të gjitha vendimet, urdhrat, njoftimet etj. të MASR-së, Senatit Akademik dhe të Rektoratit të USH-së që lidhen me procesin mësimor dhe studentët: <https://unishk.edu.al/>. Në këtë faqe publikohen edhe njoftimet dhe lajmet për aktivitete të ndryshme:

<https://unishk.edu.al/aktivitete> Platformat e ndryshme si Teams, LMS, Pitagora përdoren me qëllim të komunikimit sa më të mirë me studentët dhe lehtësimit të procesit të mësimdhënies. Studentët, personeli akademik dhe ai administrativ janë të pajisur me një adresë e-maili personale që e lehtëson dhe përshpejton komunikimin e tyre. Një pjesë e departamenteve kanë hapur llogari në rrjetet e ndryshme shoqërore:

<https://ëëë.facebook.com/profile.php?id=100057327502193>

<https://ëëë.facebook.com/departamentihistorise.universitetishkodres> duke i njoftuar studentët e tyre me informacione të nevojshme për ta.

Krahas kësaj, në shërbim të studentëve janë sekretariatë mësimore, që ofrojnë shërbime të ndryshme për studentët.

Evidencë 5.5 Tutoriati

Evidencë 5.6 Orë e hapur me studentët e vitit të parë

Evidencë 5.7 3.2 Relacion ditet e hapura 12 qershor 2019.PDF

Evidencë 1.5 Regullore e studimeve ne USH

Evidencë 5.8 Faqe e zyrtare e ush

Evidencë 5.9 Faqe zyrtare e aktiviteve

Evidencë 5.10. Shkresë për ndryshim date provimi

Evidencë 5.11. Formular regjistrimi

Evidencë 5.12 Kalendar i takimeve pedagog- student;

Evidencë 5.13 Orare të pritjes

Evidencë 5.14 Kalendar i konsultimeve

### **Standardi V.3 Institucioni përdor sistem efikas informimi për studentët.**

USH-ja realizon informimin e studentëve nëpërmjet faqes zyrtare të tij. Me qëllim informimin sa më cilësor të studentëve institucioni ka hartuar guidën përkatëse ku studentët marrin informacion për programet e studimit që ofron.

Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e Dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të.

Secili departament përcakton pedagogët tutorë për secilin program studimi që mbulon

Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.

USH ka krijuar një traditë shumë pozitive lidhur me politikën e komunikimit studentë-pedagogë. Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve "ESSE3", i adoptuar nga USH që nga viti akademik 2013. Tashmë kemi sistemin e Pitagorës.

USH-ja disponon faqen e tij ëëb e cila përditësohet vazhdimisht me njoftime në lidhje me çdo aktivitet të institucionit.

Në ambientet e USH-së ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit.

Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të

brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

Studentëve të çdo viti u caktohet tutor një pedagog i brendshëm i departamentit. Pedagogu tutor ndjek nga afër studentët që ka nën kujdestari dhe është në shërbim të tyre për çdo paqartësi që ata kanë. Çdo fillim viti akademik organizohen takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, gjetjen dhe pajisjen me literatura, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore. Çdo vit akademik, vihet në dispozicion të studentëve Manuali Studentor si një guidë e studimeve.

Evidenca 5.15 Tutoriati

Evidenca 5.16 Orë e hapur me studentët e vitit të parë

Evidenca 5.17 Broshura e USH-së

Evidenca 5.18 -Platforma e komunikimit nëpërmjet programit LMS dhe Moodle

Evidencë 5.20 Udhëzues për përdorimin e Strukturës së teknologjisë së informacionit.

Evidencë 5.21 Manuali Studentor

Evidencë 5.22 “ESSE3 Sistem online i menaxhimit të studentëve

Evidencë 5.23 Sistemi Pitagora

Evidencë 5.24 Vendim departamenti për tutorët e studentëve

**Institucioni inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jetën institucionale.**

*(Kreu I Standardi III.7)*

Institucioni garanton dhe krijon kushtet e përshtatshme dhe të sigurt, si dhe merr përsiper përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik.

Një student nga çdo cikël studimi është pjesë e njësisë së vlerësimit të brendshëm në USH. Ato janë anëtarë të grupeve të vlerësimit të brendshëm për programet e dy cikleve të studimit. Institucioni garanton vazhdimisht përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.

Përfaqësuesit e studentëve janë të ftuar të marrin pjesë në të gjitha takimet dhe të shprehin mendimin dhe propozimet e tyre, rreth kurrikulave, programeve të studimit dhe rregulloreve.

**Standardi V.5 Institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të studentëve.**

Struktura kryesore për orientimin dhe këshillimin e studentëve në USH është Zyra e këshillimit të Karrierës.

Informimi dhe orientimi i studentëve arrihet edhe nëpërmjet teknologjisë informative. Në ëeb faqen e Universitetit publikohen të gjitha informacionet e nevojshme për studentët. Në faqen

ëeb studentët mund të gjejnë informacione në lidhje me procesin mësimor, oraret e mësimit, provime, riprovime, ndryshime të strukturës, njoftime të llojeve të ndryshme që i përkasin aspektit mësimor, por edhe për mundësi të mobiliteteve si dhe aktivitetet ekstra-kurrikulare. USH-ja vë në dispozicion të studentëve materiale informuese.

Në fillim të çdo viti akademik, pedagogët prezantojnë para studentëve të çdo viti planin mësimor dhe programin mësimor për çdo lëndë, sistemin e vlerësimit, detyrimet, kërkesat lidhur me literaturën, dhe metodologjinë e mësimdhënies.

Informimi dhe orientimi i studentëve arrihet edhe nëpërmjet ëeb faqes së Universitetit ku publikohen të gjitha informacionet e nevojshme për studentët (Ref. [link](#)). Përveç mësimit të rregullt, çdo departament në Fakultet ka të shpallur një orar për konsultime me studentët për këshillimin e tyre. Fakulteti vë në dispozicion të studentëve materiale informuese si p.sh., rregulloret për çdo program studimi, guidën e fakultetit, programin e temave që përfshihen në provimin e diplomës, manual udhëzues për përgatitjen e diplomës etj. Në faqen ëeb studentët mund të gjejnë informacione në lidhje me procesin mësimor, oraret e mësimit, provime, riprovime, ndryshime të strukturës, njoftime të llojeve të ndryshme që i përkasin aspektit mësimor, por edhe për mundësi të mobiliteteve si dhe aktivitetet ekstra-kurrikulare. Thirrjet për trajnime, për aplikime kombëtare dhe ndërkombëtare jashtë vendi, për mundësi shkëmbimesh eksperiencë mësimore dhe kulture në vende të huaja, shpallen dhe përditësohen vazhdimisht në faqen ëeb të USH-së si dhe në faqet e mediave sociale të vetë Fakultetit (Ref. [link](#)). Informacioni i hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e avancimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin paraqitet qartë në Rregulloren e Studimit si dhe në programin e studimeve.

Në ditën e parë të vitit akademik studentët marrin pjesë në një takim me stafin akademik, ku ata njihen me burime informacioni mbi kurrikulën. Informacioni thelbësor për programet e tyre të studimit, rregulloret, manualin udhëzues për studentët e rinj, dhe një manual i përgatitjes së diplomës dhe librat udhëzues në fakultet në përputhje me rregullat e studimit të USH. Orientimi dhe këshillimi i duhur i studenëve është një ndër përparësitë e institucionit.

#### **Standardi V.6 Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për kategori sociale të veçanta dhe aktivitete jashtëkurrikulare.**

Institucioni respekton të drejtat e personave me aftësi ndryshe dhe i mbështet ato gjatë gjithë programit të studimit, duke krijuar sipas mundësive edhe kushte lehtësuese dhe ambiente të përshtatshme për ta. Ndërtesat e reja janë pajisur me rampë në hyrjen e godinës dhe me ashensor, me qëllim lehtësimin e aksesueshmërisë për studentët me aftësi ndryshe. Gjithashu kjo kategori studentësh përfiton edhe lehtësira financiare sipas udhëzimit të MAS-it që është publikuar edhe në faqen zyrtare të universitetit. (Ref. [link](#)). Po në faqen zyrtare të universitetit shpallen vazhdimisht edhe datat e aplikimit dhe të regjistrimit për studentët që kanë mundësinë e përfitimit të lehtësirave financiare sikurse studentët nga trojet, të verbër, me status të veçantë, aftësi të kufizuar, jetimë, romë, egjiptianë, tetraplegjikë, paraplegjikë. ofron mbështetje dhe lehtësira shtesë për studentët me aftësi ndryshe, si p.sh. studentët me dëmtime shikimi vlerësohen në provime me zë, në rastet kur programi i lëndës parashikon provim me shkrim në metodat e vlerësimit. Po ashtu, për studentët paraplegjikë provimi zhvillohet në katin e parë në rast nevojë për këtë kategori (Ref. [link](#)).



Fakulteti inkurajon studentët që angazhohen në aktivitete sportive të niveleve të larta kombëtare dhe ndërkombëtare në sporte si futboll, volejbol, basketboll.

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit ([https://unishk.edu.al/fileadmin/user\\_upload/perjashtim nga tarifa 2018-](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/perjashtim nga tarifa 2018-2019/VKM/vkm nr.780 dt.26.12.2018 reduktim tarifa.pdf)

[2019/VKM/vkm nr.780 dt.26.12.2018 reduktim tarifa.pdf](https://unishk.edu.al/fileadmin/user_upload/perjashtim nga tarifa 2018-2019/VKM/vkm nr.780 dt.26.12.2018 reduktim tarifa.pdf)) dhe akteve të tjera nënligjore.

USH është pjesë e projektit IDEA, në kuadër të të cilit zhvillohen aktivitete të ndryshme, si tryezat e rumbullakëta me qëllim të ndërgjegjësimit të të gjithë aktorëve për realizimin me sukses të procesit të gjithëpërfshirjes së të rinjve me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë.

Pjesë e projektit IDEA janë edhe studentët dhe pedagogët e FSHSH-së. Në këtë kuadër USH shënon për çdo vit 3 dhjetorin, Ditën Ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar ([https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=690&cHash=f397d095cfa82809a966ee08a4b8f46b)

[plote?tx\\_nees\\_pi1%5Baction%5D=detail&tx\\_nees\\_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx\\_nees\\_pi1%5Bnees%5D=690&cHash=f397d095cfa82809a966ee08a4b8f46b](https://unishk.edu.al/aktiviteti-i-plote?tx_nees_pi1%5Baction%5D=detail&tx_nees_pi1%5Bcontroller%5D=Nees&tx_nees_pi1%5Bnees%5D=690&cHash=f397d095cfa82809a966ee08a4b8f46b)).

#### **Standardi V.7 Institucioni ofron literaturë bazë dhe ndihmëse për studentët.**

Secili pedagog ka të përcaktuar në sylabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen sylabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyer etj.

Edhe Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask

Burim mjaft i rëndësishëm për shfhtëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, Ulibary. Në bashkëpunim me RASH-in, Drejtoria e IT-së së Universitetit të Shkodrës ka mundur aksesin ndaj shërbimit të kësaj librerie dixhitale për të gjithë pedagogët dhe studentët e Universitetit

Revista “Buletini Shkencor”, shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët. Ai mund të gjendet në bibliotekën e Universitetit, ashtu sikurse edhe on -line në faqen zyrtare të universitetit, me akses të hapur për të gjithë.

USH ka një bibliotekë që ofron literaturë për studentët ku secili Fakultet ka fondin e tij të librave në shërbim të studentëve. Vitin e fundit, 4 libra të fushës së ekonomisë, në versionin origjinal, por të përkthyer në gjuhën shqipe, i janë dhuruar asaj nga projekti CleanScore i financuar nga AADF (5 kopje për secilin). Ato i janë dhuruar gjithashtu edhe pedagogëve të këtij fakulteti, të cilët kanë filluar t'i përdorin pasi përbëjnë literaturën më të fundit e më cilësore që përdoret sot në fushën e menaxhimit dhe financës.

Programet e lëndëve kanë të mirëpërcaktuar literaturën bazë dhe atë ndihmëse Literatura bazë për mbulimin e lëndëve në programet e studimit sigurohet nga pedagogët përkatës përmes librave në gjuhën shqipe apo cikleve të leksioneve. Pedagogët orientojnë dhe ndihmojnë studentët në sigurimin e literaturës bazë dhe ndihmëse që është në gjuhë shqipe si dhe gjuhë

të huaj.

Personeli akademik vë në dispozicion të studentëve literaturën bazë. Pedagogët ofrojnë për studentët e këtij programi studimi literaturë bazë dhe ndihmëse përmes leksioneve, ëbsiteve, librave apo cikleve të leksioneve të rifreskuara, të cilat garantojnë marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit. Në dispozicion të studentëve përmes formave të ndryshme, elektronike dhe hard-copy, vihen tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, por dhe tekste alternative.

Institucioni vë në dispozicion të studentëve Bibliotekën Universitare ([Link](#)), e cila ofron për përdoruesit e saj një sërë shërbimesh, si: shërbimin e informacionit dhe të huazimit, mediatekën, si dhe tri salla leximi. ([Link](#)) Pedagogët i informojnë studentët për mundësitë e përdorimit të Bibliotekës dhe i nxisin studentët që të regjistrohen. ([Link](#)).

Biblioteka ofron për studentët literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaj, libra apo faqe online dhe libra online të nevojshme. Kjo literaturë është e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore në fushën e gjuhës, letërsisë, historisë, gjeografisë, gazetarisë dhe komunikimit, dhe në fushat tjera që lidhen me programin e studimit. ([Link](#)), ([Link](#)), ([Link](#)).

Biblioteka Universitare ofron qasje të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online. Ajo ofron po ashtu arkiv të digjitalizuar ([Link](#)), ([Link](#)) si dhe ofron faqen e Bibliotekës ([Link](#)), ku mund të gjendet informacion i përgjithshëm për bibliotekën dhe për OPAC ([Link](#)), që lejon kërkimin në gjithë fondin e BUSH-it. Po ashtu në shërbim të studentëve është ofruar edhe shërbimi elektronik U-library ([Link](#)).

Biblioteka e Universitetit përmes strukturave të saj orientuese bën të mundur qasjen e studentëve në revistën “Buletini Shkencor i Shkencave Shoqërore” (me seritë përkatëse), që publikon artikujt dhe studimet shkencore të pedagogëve, të cilat shërbejnë edhe si burim literature ndihmëse për studentët, si në formën e librave ashtu edhe online në faqen zyrtare të Universitetit, me qasje të hapur për të gjithë ([Link](#)).

Institucioni nëpërmjet financimeve të projektit T@ask/ Erasmus+ ka bërë një punë të mirë për shtimin e zërave në bibliotekë dhe përditësimin e fondit ekzistues në shërbim të njësie bazë të FSHSH-së. Një kontribut të veçantë në pasurimin e fondit të studimeve albanologjike dhe letrare japin edhe pedagogët e FSHSH-së, duke i dhuruar Fondit të Albanologjisë në BUSH, botimet e tyre, si monografi, ashtu edhe tekste universitare.

Pranë Departamentit të Gjermanistikës është Biblioteka me një fond prej më shumë se 3000 librash, cdo student mund të hyjë lirisht në bibliotekë, të studiojë aty dhe/ose të huazojë libra. Biblioteka pasurohet cdo vit me mbështetjen e lektorëve austriak, të cilët kanë të parashikuar një fond të caktuar për sigurimin e librave të nevojshme në mësimdhënie.

Gjithashtu, Biblioteka Austriake pranë BUSH, ka një fond shumë të pasur librash, dhe kjo bibliotekë pasurohet cdo vit me tituj të rinj, falë mbështetjes së vazhdueshme të Ambasadës Austriake, Tiranë<sup>6</sup>.

Evidenca 5.25 Raporti i punës mësimore-shkencore





Evidenca 5.26 Miratim RVB e Fakultetit

Evidenca 5.27 Përshkrim i disa aktiviteteve shkencore nga FSHSH, shoqëruar me linket përkatëse.

Evidenca 5.28 Akt dhurimi i librave nga Instituti Italian i Kulturës për Departamentin Romanistikë

Evidencë 5.29 Marrëveshje Bashkëpunimi me OEAD

### **Standardi V.8 Institucioni favorizon punësimin e studentëve.**

Qendra e Karrierës dhe Alumni ndjekin ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Qendra e Karrierës dhe Alumni është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësitë e punësimit, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Linku<sup>7</sup>: <https://unishk.edu.al/studentet/alumni/regjistrohem>

USH bën përpjekje për të favorizuar punësimin e studentëve. Ka përpjekje nga departamentet për të realizuar një studim të tregut të punës, por, duhet theksuar se stafi ka nevojë për asistencë për realizimin e një studimi të tillë.

Cdo Fakultet hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe të tjerë aktorë, zhvillimit të praktikave, panairit të punës, etj.

Në favor të punësimit të studentëve është edhe USH, sepse shumë ish-studentë të USH-së janë tashmë pjesë e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitet.

Dekani i studentëve, pranë Zyrës së Këshillimit të Karrierës, është struktura që mbledh dhe disponon të dhëna statistikore për punësimin e studentëve. Mbledhja e të dhënave realizohet nëpërmjet mbledhjes së të dhënave nga regjistrat, sistemi ESSE 3 (tashmë Pitagora) dhe nga pyetësi on-line i hedhur në faqen zyrtare të universitetit. Drejtoria e IT-së ka skanuar dhe përpunuar gjithashtu deri më tani 47 regjistra të amzave që nga viti 1957 e në vazhdim, që përbëjnë 2/3 e numrit total të regjistrave.

Zyra e Këshillimit të Karrierës në faqen e ALUMNI-t ka hedhur tashmë formularin e regjistrimit të studentëve që kanë përmbyllur studimet në Universitetin e Shkodrës. Pasi formulari plotësohet, të gjitha të dhënat ruhen në databazën e USH-së. Në njërin nga pikat kërkohet punësimi aktual i të diplomuarit. Kjo pyetje është vënë me qëllimin që këto të dhëna të analizohen në të ardhmen dhe të eksplorohej përputhshmëria horizontale e programit dhe punësimit duke hedhur kështu hapat e parë drejt një studimi të hollësishëm të tregut të punës dhe procesit të gjurmimit të Aluminit (Ref. [link](#)).

Link<sup>7</sup>: <https://unishk.edu.al/studentet/alumni/regjistrohem>

Studimi i tregut të punës gjithashtu kryhet me qëllimin për të analizuar dinamikën e tij dhe për të gjetur mënyrën e përshtatjes së programeve që USH-ja ofron me kërkesat e këtij tregu kaq dinamik.

Fakulteti Ekonomik zhvillon çdo vit Panairin e Punës në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, DRSHKP-në Shkodër dhe Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë. Ai krijon mundësinë e ndërmjetësimit dhe takimit në mes punëdhënësve (Firmave të biznesit të ndryshme) dhe punëkërkesve (studentëve) nëpërmjet vendosjes së kontakteve direkte mes tyre. Kjo tashmë është një praktikë e përvitshme për Fakultetin.

Përvojë pozitive në ndihmë për integrimin e studentëve në punësim kanë edhe projektet në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër (në hartimin e strategjisë së zhvillimit të qytetit), në bashkëpunim me Qarkun (për strategjinë e zhvillimit të turizmit në zonën e Dukagjinit), me TEULEDEN (për organizimin e panairove të artizanatit), me Dhomën e Tregtisë, REC-in dhe Bashkinë Shkodër (për organizimin e disa panairove të turizmit). Në marrëveshjet e nënshkuara me institucione të rajonit, si Bashkia, Perfektura e Qarkut Shkodër, Banka, Biznese private, etj., studentët realizojnë praktikën duke hedhur kështu hapat e parë të kontakteve drejt punësim të mundshme. Për aktivitete të tilla jepen informacione të hollësishme dhe publikime në media.

Në favor të punësimin të studentëve është edhe vetë FE i USH-së, ku nga 30 pjesëtarë të stafit akademik të punësuar me kohë të plotë pranë këtij universiteti 25 janë ish- studentë të diplomuar në auditoret e tij.

Fakulteti përpiqet të mbajë kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit pranë auditoreve të tij. Takime të organizuara me ALUMNI realizohen edhe në përvjetore të USH-së dhe të Fakulteteve.

Zyra e Këshillimit të Karrierës organizon vazhdimisht aktivitete informuese për mundësitë e punësimin të rinjve brenda dhe jashtë vendit (Ref. [link](#)).

Programet e studimeve që ofrojnë njësitë bazë të FSHSH-së hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur punësimin e studentëve dhe zhvillimin ekonomik lokal dhe kombëtar, mbështetur në Ligjin për Arsimin e Lartë 80/2015 ([Link](#)); Statutin e USH-së ([Link](#)), Strategjinë e studimit të tregut të punës ([Link](#)), si edhe në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Shkodrës 2017-2021. ([Link](#))

Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më të mirë me kërkesat e tregut të punës, personeli akademik konsultohet dhe merr parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe të partnerëve nga tregu i punës, si koordinatorët apo mentorët e praktikave profesionale që zhvillohen në ciklin e dytë të studimeve dhe stafi i Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, me të cilët zhvillojnë konsultime dhe bashkëpunime.

Përmendim edhe një herë se një ndër politikat e strategjisë së tregut të punës është pikërisht vendosja e kontakteve e studenteve të sapodiplomuar me aktore të ndryshme të bizneseve që vetë universiteti ka marrëveshje. (Shih Strategjia e studimit tregut të punës, fq 5, pika 4, 4,3)<sup>8</sup>

Evidencë 5.30 Platforma e komunikimit nëpërmjet programit LMS dhe Moodle

Evidencë 5.31 Udhëzuesi i platformës Teams

<sup>8</sup> <https://unishk.edu.al/universiteti/dokumentet/strategjite>

Evidencë 5.32 Projekti IDEA

Evidencë 5.33 [Akhenda e 25 vjetorit aktivitetet.PDF](#)

Evidencë 1.9 Strategjia e Tregut të Punës

Evidencë 5.34 Konferencë e programit të Gjuhës Frënge me AUF.

Evidencë 5.35 Panair pune “Eork and Study”.

### **Standardi V.9 Institucioni ruan lidhje të vazhdueshme me ish-studentët e tij.**

Siç u lartpërmend, ka përpjekje nga USH për të ruajtur lidhjet me ish-studentët. Disa prej tyre janë të punësuar në USH, si pjesë e administratës apo e stafit akademik. Disa të tjerë janë pjesë e GVB-ve dhe NJSBC-së së fakultetit. Ish-studentët ftohen në aktivitetet që organizojnë njësitë bazë. Po ashtu kohë pas kohe realizohen hulumtime në formën e pyetësorëve me ish-studentë për t’u njohur me shkallën e punësimit të tyre. Këto rezultate përdoren për studimin e tregut të punës në nivel të njësisë bazë.

Evidencë 1.13 Vendim NJSBC në fakultete

Evidencë 5.9.1. Shembull i mbajtjes së lidhjes me studentët

### **Përfundimet dhe Vlerësimi**

Për pranimin e studentëve të rinj USH ndjek një politikë të caktuar. Fillimisht kriteret e pranimit dhe numri i studentëve propozohet nga departamentet, miratohet në dekanat dhe pastaj kalon në Senat dhe miratohet nga Senati Akademik. Faqja zyrtare e institucionit siguron informacion mbi kuotat dhe kriteret e pranimit, përfshirë studentët nga Shqipëria dhe nga jashtë. Po kështu, në faqen zyrtare publikohen listat e fituesve për secilin program studimi.

Ka një larmi burimesh informimi për studentët., krahas faqes zyrtare, si p.sh., guida përkatëse, broshurë informuese e USH-së. Po kështu, Dekanati, sekretaria mësimore dhe sekretaria e Dekanatit, si dhe njësitë bazë të fakultetit kanë orarin e pritjes së studentëve, me qëllim ofrimin e informacionit dhe sigurimin e mbështetjes së tyre për procesin mësimor apo problematika të tjera të lidhura me të. Secili departament në fakultete përcakton pedagogët tutorë për secilin program studimi që mbulon.

Çdo fillim viti akademik organizohet takime me studentët e viteve të para ku ofrohet informacion për organizimin e programeve të studimit, duke specifikuar objektivat dhe strukturën e moduleve, sistemin e vlerësimit në lidhje me kontrollin e dijeve përmes komponentëve të vlerësimit, kërkesat lidhur me literaturën, frekuentimin, detyrimet dhe metodologjinë e mësimdhënies si dhe me çështje etike të lidhura me aspekte studentore.

Një rol të konsiderueshëm luan edhe sistemi i menaxhimit të studentëve “PITAGORA”, i adoptuar nga USH në vitin akademik 2021.

Në ambientet e fakulteteve ka postera informimi ku pasqyrohen kurrikulat, oraret mësimore dhe njoftime të ndryshme. Gjithashtu, pjesa më e madhe e departamenteve kanë krijuar faqet

e tyre në rrjete të ndryshme sociale si elementë të rëndësishëm të përcjelljes së informacionit.

Secili pedagog, stafi administrativ dhe studentët janë të pajisur me një adresë elektronike të brendshme të personalizuar, gjë që lehtëson komunikimin pedagog-student-staf administrativ. Në ndihmë të komunikimit sa më cilësor dhe të rritjes së cilësisë së mësimdhënies janë edhe platformat LMS, Moodle dhe Teams në institucionin tonë.

Në secilin fakultet sekretaria mësimore orienton studentët që dëshirojnë të transferojnë programet e studimeve. Procesi është i dokumentuar dhe arkivuar edhe për të gjitha prurjet e studentëve nga IAL të tjera apo anasjelltas.

USH mbështet kategori sociale të veçanta, pjesë e të cilave janë edhe studentë nga FSHE, duke krijuar edhe kushte lehtësuese, dhe ambiente të përshtatshme për ta. Cdo vit akademik akordohen bursa studimi. Të gjitha informacionet si dhe mënyrat e aplikimit publikohen në faqen zyrtre të Universitetit.

Secili pedagog ka të përcaktuar në sylabusin e lëndës literaturën bazë dhe ndihmëse dhe e evidenton në mbledhjen e departamentit ku miratohen sylabuset e lëndëve. Në përgjithësi, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve tekste të autorëve të njohur në fushat përkatëse, leksione të shtypura, materiale ndihmëse të printuara, tekste të botuara nga pedagogët e tij dhe nga pedagogë të universiteteve të tjera, tekste të përkthyer etj.

Edhe Biblioteka e USH-së ofron literaturë të pasur në shkencat psiko-sociale. Tashmë Biblioteka është pasuruar më tej me libra të fushës psiko-sociale në kuadrin e projektit T@ask. Burim mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin e literaturës së huaj është edhe biblioteka digjitale, Ulibary.

Revista “Buletini Shkencor”, seria e Shkencave shërben edhe si burim literature ndihmëse për studentët.

Secili departament në USH aplikon shërbimin e tutoriatit për studentët. Me studentët e viteve të para organizohen orë të hapura, ku studentët njihen me programin e studimit, me Rregulloren, Kodin e Etikës, etj. Cdo shqetësim i studentëve përcillet nga pedagogu në departament, ku, zakonisht, gjen zgjidhje përmes bashkëpunimit me strukturat e tjera.

Në përbërjen e strukturës së Njësisë për Vlerësimin e Brendshëm të fakulteteve merr pjesë edhe një student. Gjithashtu, studentët kanë përfaqësues të tyre edhe në grupet e vlerësimit të brendshëm për programet e studimeve.

Këtë vit akademik u realizuan votimet për Këshillat Studentore të fakulteteve të USH-së dhe Këshillin Studentor Institucional të Universitetit të Shkodrës. Këto organizime krijojnë mundësinë që studentët të paraqesin në organet drejtuese të USH-së mendimet dhe opinionet e tyre në lidhje me gjithë veprimtarinë akademike dhe shkencore në USH.

USH-ja ka pjesë të politikave të saj mbështetjen shumëdimensionale të studentit. Secili Fakultet kontribuon në këtë drejtim përmes përfshirjes dhe mbështetjes së studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv. Në këtë mënyrë, Fakulteti përmes këtyre aktiviteteve kontribuon në përmirësimin e jetës

studentore dhe plotësimin e saj me aktivitete ekstrakurrikulare.

Ka përpjekje nga departamentet për të realizuar një studim të tregut të punës, por, duhet theksuar se stafi ka nevojë për asistencë për realizimin e një studimi të tillë.

Secili Fakultet hedh, gjithashtu, bazat e punësimit të studentëve pas diplomimit përmes bashkëpunimit me institucione të ndryshme të rajonit sikurse lidhjeve me DAR-in, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Shkodrës dhe të tjerë aktorë, zhvillimit të praktikave, panairit të punës, etj.

**Vlerësimi i fushës: Standardet përmbushen kryesisht.**

## **Përfundimet dhe vlerësimi përgjithshëm**

Në USH ka ndarje të qarta të veprimtarisë së organeve dhe autoriteteve drejtuese dhe personelit akademik dhe atij administrativ. Kompetencat janë të detajuara në statutin e USH-së si dhe në Rregulloren e USH konform legjislacionit përkatës në fuqi. Strategjia, statuti i USH-së dhe Rregullorja e USH garantojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit në përputhje me ligjin e arsimit të lartë.

Programet e studimit të USH janë në përputhje të plotë me misionin dhe objektivat e USH-së. USH-ja e harton politikën e vet në përputhje me politikat kombëtare. USH bën përpjekje për të siguruar koherencë me programe të ngjashme studimi të universiteteve të tjera në vend e më gjerë, në rajon.

Sekretaritetë mësimore të USH janë të pajisura me një regjistër bazë, në formë të shkruar dhe elektronike ku ruhen të dhënat e studentëve. Diplomat që jepen në përfundim të programeve të studimeve të ciklit të parë dhe të dytë shoqërohen me suplementin/shtojcën e diplomës. Suplementi është në shqip dhe në anglisht dhe përmban informacion të detajuar. FE promovon veprimtarinë e tij përmes materialesh me karakter informativ, siç janë manualët e studentëve dhe broshurat informuese.

USH ofron programe studimi të tre cikleve të studimit. Departamentet bëjnë përpjekje të vazhdueshme për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës.

Programet e studimit ndjekin me rigorozitet bazën ligjore përkatëse dhe në përmbajtjen e tyre harmonizojnë komponentët e tyre. USH bën përpjekje për përmirësimin e programeve të studimeve duke marrë për bazë rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe nga studentët. Institucioni bën përpjekje të vazhdueshme që programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë të realizohen në masën 70% nga staf i brendshëm.

Departamentet, çdo fillim viti akademik diskutojnë dhe miratojnë ngarkesën mësimore vjetore të normuar dhe kohën vjetore të punës, mbështetur në bazën ligjore përkatëse. Programet e studimit u bëhen të ditura studentëve çdo fillim viti akademik, ku njihen me elemente bazë të tij, si dhe me parimet bazë të Kodit të Etikës të USH. Fakultetet kanë manuale për studentët. Pedagogët dhe studentët, gjithashtu, përdorin edhe komunikimin online. Programet e studimit kanë hartuar objektiva të përcaktuar qartë në lidhje me përfshirjen e dijeve, njohurive dhe zotësive që duhet të përvetësojë një student i programit përkatës. Lëndët dhe ngarkesat e tyre në kurrikula përputhen me objektivin e programit për të përgatitur specialistë sa më të zotë në fushën përkatëse.

Në USH organet drejtuese lehtësojnë vendim-marrjen nëpërmjet favorizimit të debatit konstruktiv në departamente ku ka përfaqësi nga të gjitha grupet e interesit.

Një ndër prioritetet e USH është ndërkombëtarizimi. Gjatë kësaj periudhe është punuar në aspektin e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndryshme mes Universitetit të Shkëndrës dhe universiteteve të tjera në Rajon dhe më gjerë si në zbatimin e projekteve të përbashkëta me karakter akademik. USH ndjek një politikë të integritetit të personelit akademik të ftuar si dhe

të studiuesve të huaj, e cila është në harmoni me kërkesat dhe nevojat si të Institucionit ashtu edhe stafeve të përfshira.

Është e rëndësishme që USH -ja të fillojë procesin e akreditimit të programeve të studimit, si një proces i cili garanton grupet e interesit për cilësinë e programeve që ofrohen.

USH ndjek një politikë të qartë dhe të mirëstrukturuar për rekrutimin e pedagogëve në përputhje me rregulloren. Vendet vakante njoftohen tek rubrika e njoftimeve në ëbsit-in e USH-së.

USH ka një infrastrukturë të përshtatshme dhe në përmirësim të vazhdueshëm për zhvillimin e aktivitetit të tij.

USH ka të punësuar pjesën më të madhe të stafit akademik me tituj Dr, Prof. As, dhe Prof. Stafi akademik angazhohet në veprimtari akademike, kërkimore-shkencore dhe administrative, si brenda vendit ashtu edhe jashtë tij. USH mbështet mobilitetin e pedagogeve në universitete të tjera jashtë vendit. Nëpërmjet projekteve institucioni synon të përmirësojë infrastrukturën logjistike dhe administrative të përshtatshme që i përgjigjet metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Strukturat drejtuese të USH-së angazhohen në marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore publike e private. Nga këto marrëveshje sigurohen realizimet e praktikave profesionale të studentëve në vitin e fundit të studimeve.

USH ka intensifikuar përpjekjet për informimin e studentëve lidhur me mundësinë e studimit në vende të huaja. Ndër vite ka mobilitetet të studentëve gjatë semestreve akademike. Institucioni ofron, gjithashtu, mundësinë që disa lëndë në programe të ndryshme studimi të ofrohen në gjuhën angleze.

Departamentet vazhdimisht organizojnë dhe nxisin pjesëmarrjen e studentëve në aktivitete jashtë kurrikulës. USH bën përpjekje për përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter social, kulturor dhe sportiv.

Në buxhetin e USH-së parashikohen fonde për kërkimin shkencor si dhe financimin e Qendrave Kërkimore Shkencore pranë USH. USH ka një përvojë të pasur në fushën e kërkimit shkencor dhe vazhdimisht e ka ndihmuar zhvillimin e tij duke i dhënë prioritet partneritetit me institucione kërkimore-shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni mbështet organizimin e konferencave dhe veprimtarive shkencore. Personeli akademik, nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare, jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës si dhe promovon njëkohësisht edhe vlerat dhe traditën e fakultetit përkatës. Shpesh iniciativat individuale kthehen në projekte institucionale.

USH përmes njësave bazë dhe njësave kryesore, gjithashtu në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit për Karrierën, bazuar në Statutin dhe rregulloret, krijon një klimë të përshtatshme për kalim të lehtë të studentëve nga mjedisi i sistemit arsimor të mesëm në mjedisin e sistemit arsimor të lartë. Ai ofron informacion për studentët e ardhshëm si për politikën e pranimit ashtu edhe për organizimin e programeve të studimit.



Nën konceptin e “Ditëve të Hapura” realizohet informimi i të rinjve për mundësitë e ndryshme që ofrohen nga programet e universitetit duke shtruar dhe propozuar çdo alternativë studimi, duke dhënë përgjigje për çdo pyetje dhe paqartësi dhe duke sugjeruar mundësitë e punësimit në varësi të programit të studimit.

USH realizon informimin e studentëve përmes faqes zyrtare si dhe rrjeteve sociale nëpërmjet të cilave informacioni shpërndahet më shpejt tek të rinjtë. Fakultetet mbështesin studentët përkatësisht për çdo program studimi, me orientime dhe aktivitete të veçanta. Që nga viti 2013 Universiteti i Shkodrës ka adoptuar programin e menaxhimit të studentëve “ESSE3” tani Pitagora, që realizon mbështetjen e tyre në mësimdhënien me sistemin elektronik dhe në të shkruar.

Universiteti i Shkodrës respekton të drejtat e studentëve që u përkasin kategorive të veçanta dhe i mbështet ato gjatë procesit mësimor duke i lehtësuar aksesin në mësimdhënie dhe duke krijuar ambiente të përshtatshme që janë gjithnjë në përmirësim.

USH ofron dhe siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë plotësuese në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj. Institucioni ka ngritur struktura ndihmëse që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në përputhje me standardet bashkëkohore.

Biblioteka e Universitetit të Shkodrës ka literaturë të pasur me tekste të autorëve të njohur në fushat ekonomike nga universitete të njohura në botë, por që duhet të pasurohet vazhdimisht duke pasur parasysh që fusha e kërkimit shkencor është dinamike dhe në ndryshim të vazhdueshëm. Biblioteka e Universitetit ofron kushte optimale për të studiuar apo punuar.

Studentët përfaqësohen në Senatin Akademik (dy studentë) dhe Bordin e Administrimit, (Statuti i Universitetit, Neni 47,2/b). Ata janë të organizuar në Këshillin Studentor me përfaqësues nga secili fakultet, rezultat i një procesi të rregullt dhe gjithë përfshirës zgjedhor. Këshilli merr pjesë aktive në çështje që lidhen me të drejtat e studentëve. USH ka në politikën e tij përfshirjen dhe mbështetjen e studentëve në organizimin kombëtar dhe ndërkombëtar të aktiviteteve/projekteve me karakter shoqëror, kulturor dhe sportiv. Përmes tyre sigurohet një klimë miqësore për shoqërimin e studentëve edhe jashtë auditoreve të universitetit.

USH ofron disa baza të punësimit pas diplomimit, përmes lidhjeve me punëdhënës të ndryshëm, privat dhe publik, bizneseve dhe faktorëve të tjerë, praktikave, ëorkshopeve, panairove etj.

Universiteti i Shkodrës ka krijuar një formë regjistrimi, ku studentët e diplomuar, në mënyrë vullnetare, mund të regjistrojnë të dhënat e tyre në databaset e USH-së. Kjo formë ka si qëllim mbledhjen e të dhënave dhe më pas analizimin e tyre në funksion të afrimit të diplomës së përvetësuar dhe kërkesave të tregut të punës. Zyra e Këshillimit dhe e Karrierës organizon aktivitete të vazhdueshme me ALUMNI për monitorimin dhe kontaktet me ish-studentë të USH –së.



## ANALIZA SWOT

### Pika të forta

- Programe akademike bashkëkohore, kurrikula në përputhje me kërkesat e tregut dhe më gjerë;
- Shkalla e lartë e kualifikimit të stafit akademik të brendshëm dhe atij mbështetës;
- Rezultatet ekzistuese të mësimdhënies dhe përvoja e mirë që ofrojnë elementet bazë të kërkuara për programet e nivelit të parë dhe të nivelit të dytë në hartimin dhe përmirësimin e programeve të reja;
- Lidhjet e ngushta të FGJH-së me institucione homologe dhe të tjera brenda dhe jashtë vendit kanë mundësuar jo vetëm krijimin e kushteve për kualifikimin dhe shkëmbimin e eksperiencës së stafit akademik por edhe bashkëpunim në drejtim të realizimit të programeve të studimit;
- Bashkëpunimi kombëtar e ndërkombëtar pjesëmarrja në projekte, dhe trajnime të ndryshme;
- Organizimi i mirë i praktikave profesionale të studentëve tanë;
- Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë. Garantuar nga strukturat e kontrollit dhe të vlerësimit të brendshëm të ngritur në nivel fakulteti dhe departamenti;
- Përfshirja e studentëve në vendimmarrje.
- Trasmetimi tek studentët i një informacioni cilësor dhe bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik e praktik, me qëllim formimin cilësorë të studentëve, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e të marrin vendime të sakta, të orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikimeve të sektorëve e degëve ku ata specializohen;
- Hapja e programit të ciklit të tretë të studimit, Doktoratë në “Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm”, përfaqëson një mundësi të re për zhvillimin dhe zgjerimin e fakultetit dhe rritjen e kontributit të tij në zhvillimin ekonomiko-shoqëror të Rajonit të Veriut;
- USH ka një staf akademik të kualifikuar, ambicioz, me eksperiencë ndërkombëtare dhe me moshë relativisht të re;
- Ndërkombëtarizimi është një objektiv i vazhdueshëm i USH-së, i orientuar drejt marrëveshjeve me universitetet perëndimore, europiane dhe amerikane, përmes të cilave janë realizuar mobilitete të stafeve dhe studentëve dhe janë siguruar bashkëpunime me strukturat kërkimore brenda këtyre Universiteteve;
- Suksese në aplikime dhe finalizime në projektet ndërkombëtare, përfshirje e gjerë e stafit akademik, administrativ dhe studentëve në mobilitete; partneritete në kuadrin e projekteve europiane si CEEPUS, ERASMUS Mundus, Interreg (FOST INNO), IPA (HELIX), TEMPUS (EUREQA, CHTMBAL, MARED), Erasmus (MARDS, FINAC, USIA), etj;
- Departamentet bëjnë përpjekje të vazhdueshme për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës;

- Informacioni për studentët është i vazhdueshëm dhe ofrohet si në rrugë zyrtare ashtu edhe përmes përdorimit të rrjeteve sociale që janë ngritur dhe administrohen nga stafet e secilit fakultet
- Studentët gëzojnë një shkallë të lartë mbështetjeje në përfshirjen e tyre në organizmat studentorë në Fakultet;
- Përfshirja e studentëve dhe ekspertëve të jashtëm në hartimin e RVB-ve të programeve të studimit;
- USH ka një traditë mjaft pozitive në drejtim të informimit dhe orientimit të studentëve, duke nisur që me aktivitetet për informimin e maturantëve;
- Rifreskimi i vazhdueshëm i njohurive teorike dhe praktike me zhvillimet e shkencave ekonomike e globale,
- Aplikim i modeleve të reja dhe bashkëkohore të mësimdhënies,
- Baza materiale laboratorike mësimore, libra dhe paisje, për stafin akademik dhe studentët është rinovuar falë investimeve ndër vite nga projektet ndërkombëtare;
- Përfshirje e studentëve në organizimin e aktiviteteve/projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter akademik, social, kulturor dhe sportiv;
- Formim profesional e shkencor të specialistëve në nivel të lartë, si drejtues të përgjithshëm biznesi, financiarë, kontabilistë dhe menaxhere turizmi;
- Raporte të mira dhe bashkëpunuese me institucionet publike dhe bizneset të cilat ndikojnë në përfshirjen e studentëve në praktikat profesionale;

#### **Pika të dobëta**

- Nevojë për përfshirje më të madhe dhe ndërgjegjësim të studentëve për rolin që luajnë në sigurimin e cilësisë së veprimtarisë akademike;
- Mungesa e një tregu të gjërë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave për çdo program;
- Rritja e rolit të zyrës së këshillimit të karrierës në secilin program. Përfshirja e studentëve sidomos atyre të ciklit të dytë në veprimtarinë kërkimore shkencore;
- Mungesa e literaturës bashkëkohore në bibliotekë dhe mos shfrytëzimin e literaturës eksistuese nga studentët në shkallën e duhur;
- Mungesa e rregullores së shpërndarjes së fondit për kërkim shkencor;
- Mungesa e ambienteve të zyrave për stafin akademik;

#### **Mundësitë**

- Shanse për rritjen e bashkëpunimit me institucionet publike dhe private;



- Kthimi i FGJH-së në qendër trajnimi për të gjithë specialitetet që ofron;
- Mundësia për të zgjeruar rrjetet dhe lidhjet e USH-së me institucione të arsimit të lartë brenda e jashtë vendit, në funksion të zgjerimit të pjesëmarrjes në projekte kombëtare e ndërkombëtare;
- Mundësia për të rritur pjesëmarrjen në hartimin e strategjive të zhvillimit të Rajonit;
- Akreditimi i të gjithë programeve të studimit për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre në treg;
- Në strategjitë e ardhshme të FE duhet të përfshihen edhe disa iniciativa dhe projekte konkrete që do synojnë lidhjen e stafeve akademike dhe studentëve me bizneset në drejtim të krijimit të Inkubatorit të Biznesit, Qendra e Asistencës së Biznesit, Laboratori i Ushqimit dhe Pijeve, Qendra e Inovacioneve në zhvillimin e qëndrueshëm, etj.

### **Rreziqet**

- Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor;
- Rënia e numrit të të rinjve si pasojë e rënies të shkallës së lindshmërisë, emigrimit jashtë vendit dhe migrimit të brendshëm drejt Tiranës tkurr demografinë e zonës.
- Prirja e maturantëve për të vazhduar studimet universitare jashtë shtetit, gjë që sjell reduktimin e numrit të studentëve.
- Tregu i punës është i pakonsoliduar plotësisht gjë që ul vlerën e diplomës së studentëve të mirë.
- Shkalla e ulët e financimit nga biznesi lokal dhe kombëtar
- Rënia e numrit të pranimeve në disa programe studimi;
- Preference jo e lartë e maturantëve për programet e mësuesisë ku finalizohen disa nga programet tona bachelor;
- Mungesa e një tregu të gjërë punësimi në nivel rajonal, mungesa e të dhënave mbi punësimet në nivel rajonal e më gjerë krijon vështirësi në orientimin e programeve të studimit dhe në përcaktimin e kuotave për çdo program

## Shkalla e përmbushjes së standardeve

| Nr | Fusha   | Përmbushen plotësisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen pjesërisht | Nuk përmbushen |
|----|---|-----------------------|----------------------|-----------------------|----------------|
| 1  | Menaxhimi, autonomia dhe sigurimi i cilësisë    | ✓                     |                      |                       |                |
| 2  | Burimet dhe partneriteti                        |                       | ✓                    |                       |                |
| 3  | Programet e studimit, mësimdhënia dhe vlerësimi | ✓                     |                      |                       |                |
| 4  | Aktiviteti shkencor/artistik dhe inovacioni     |                       | ✓                    |                       |                |
| 5  | Studentët dhe mbështetja e tyre                 |                       | ✓                    |                       |                |

### Shtojca 1

#### Pyetësor mbi lëndën dhe pedagogun

Ky raport vjen në kuadër të Strategjisë së zhvillimit të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standardeve të cilësisë duke u bazuar në Ligjine Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 Neni 103: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, Pika 3 “Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, kjo strukturë organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi” dhe në aktet nënligjore të tij. Studentët janë fokusi i Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, ndaj vlerësimi studentor mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies është burim i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve institucionale dhe akademike që ofron ky universitet. Ky raport ka për qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies duke identifikuar problematikat, me qëllim përmirësimin e tyre. Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për njësitë kryesore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të strukturave dhe shërbimeve që ofron universiteti.

Procesi i realizimit të pyetësorëve të studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 datë 22.07.2015, Kreu X, Neni 103: “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, sipas të cilit:

1. Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.
2. Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e institucionit të arsimit të lartë.
3. Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësonin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo program studimi.
4. Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.
5. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, të përcaktuara në VKM Nr.824, datë 24.12.2021 “PËR MIRATIMIN E KODIT TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË”, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë, programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor, programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional”, “Master i Shkencave”.

- Në mbështetje të Ligjit 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit të USH-së, Vendimit të Senatit Akademik nr. 181 datë 31.05.2021 “Për miratimin e përbërjes së komisionit të përhershëm në nivel institucional për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit”, Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit vendosi të miratojë formatin dhe modalitetet e pyetësonit të studentëve, për vitin akademik 2021-2022”.
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë ka këto detyra:

- Evidenton dhe ndjek problematikat e lidhura me cilësinë e mësimdhënies
- Bën vlerësimin periodik të rezultateve të veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore.
- Organizon dhe ndjek zhvillimin e pyetësorit studentor institucional dhe pyetësorit për cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi.

Metodologjia e studimit është sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësoi i miratuar nga Komisioni i Përhershëm në Nivel Institucional për Garantimin e Standardeve të Cilësisë të Institucionit dhe Programeve të Studimit.

Kjo platformë u administrua nga Zyra e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe vlerësimit të standardeve. Të dhënat e gjeneruara nga platforma u organizuan me qëllim realizimin e këtij raporti, nga zyra e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Përgjigjet për çdo pyetje të mbyllur janë gjeneruar në përqindje. Përpunimit statistikor të pyetjeve të mbyllura është bërë në nivel institucioni, të cilat janë paraqitur në mënyrë grafike.

Në raport janë pjesëmarrës studentë të Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve të USH-së. Duke qenë se pyetësorët u zhvilluan online, stafi ndihmësakademik i zyrës së NJSBC-së dhe IT-së në bashkëpunim me stafin akademik mundësuan mbledhjen e sa më shumë adresave e-mail të studentëve, me qëllim garantimin e një përfshirjeje sa më të lartë.






|                                   |             |
|-----------------------------------|-------------|
| Fakulteti Shkencave Shoqerore     | 40          |
| Fakulteti i Shkencave të Natyrës  | 288         |
| Fakulteti i Shkencave të Edukimit | 264         |
| Fakulteti Ekonomik                | 375         |
| Fakulteti i Drejtësisë            | 59          |
| Fakulteti i Gjuhëve të huaja      | 43          |
| <b>Total pjeësmarrës</b>          | <b>1069</b> |

Përgjigjet e pyetësorit ruhen dhe përpunohen në mënyrë ANONIME. Të dhënat janë hedhur në database nga stafi ndihmësakademik i NJSBC-së, si dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore nga stafi ndihmësakademik i IT-së, me qëllim evidentimin e problematikave kryesore të perceptuara nga studentët.


- A ka qenë ngarkesa javore mësimore (leksione e seminare) e mjaftueshme për përvetësimin e njohurive të lëndëve?



Nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 57% e studentëve janë përgjigjur që ngarkesa javore mësimore ka qenë e mjaftueshme për përvetësimin e njohurive të lëndëve të zhvilluara gjatë semestrit të dytë, të vitit akademik. Ndërsa 25% janë përgjigjur që ngarkesa mësimore më shumë ka qenë e mjaftueshme për përvetësimin e njohurive të lëndëve sesa jo. 12% janë përgjigjur që ngarkesa mësimore më shumë nuk ka qenë e mjaftueshme sesa ka qenë. 6% janë përgjigjur që nuk ka qenë e mjaftueshme.

- A ka qenë materiali didaktik (libra, dispensa, fotokopje) i mjaftueshëm për studimin e lëndës?







Nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 64% e tyre janë përgjigjur që materiali didaktik ka qenë i mjaftueshëm për studimin e lëndës së zhvilluar gjatë semestrit të dytë, të vitit akademik. Ndërsa 20% janë përgjigjur që materiali didaktik më shumë ka qenë i mjaftueshëm për përvetësimin e njohurive të lëndëve sesa jo. 10% janë përgjigjur që materiali didaktik më shumë nuk ka qenë i mjaftueshëm sesa ka qenë, ndërsa 6% janë përgjigjur që nuk ka qenë i mjaftueshëm.

- A ka qenë e përcaktuar në mënyrë të qartë ndarja e pikëve (vlerësimi në seminare, detyra e kursit, provimi)?

Duke parë tabelën e mëposhtme shohim se rreth 72% e studentëve janë përgjigjur që ndarja e pikëve (vlerësimi në seminare, detyra e kursit, provimi) të lëndës së zhvilluar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik ka qenë e qartë. Ndërsa 14% janë përgjigjur që ndarja e pikëve më shumë ka qenë e qartë sesa jo. 7% janë përgjigjur që ndarja e pikëve më shumë nuk ka qenë e qartë sesa ka qenë, po 7% janë përgjigjur që nuk ka qenë e qartë.




- A kanë qenë temat dhe konceptet e trajtuara nga pedagogu në leksione të kuptueshme nga ana juaj?



Nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 59% e tyre janë përgjigjur që temat dhe konceptet e trajtuara nga pedagogu në leksione të zhvilluar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik kanë qenë të kuptueshme. Ndërsa 30% janë përgjigjur që temat dhe konceptet e trajtuara nga pedagogu në leksione më shumë kanë qenë të kuptueshme sesa jo. 7% janë përgjigjur që temat dhe konceptet e trajtuara nga pedagogu në leksione më shumë nuk kanë


qenë të kuptueshme sesa kanë qenë, ndërsa 4% janë përgjigjur që temat dhe konceptet e trajtuara nga pedagogu në leksione nuk kanë qenë të kuptueshme.

- A ka qenë i gatshëm pedagogu (i leksioneve) për të dhënë sqarime dhe shpjegime të mëtejshme kur kjo gjë i është kërkuar?



Nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 76% e tyre janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) ka qenë i gatshëm për të dhënë sqarime dhe shpjegime të mëtejshme kur kjo gjë i është kërkuar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik. Ndërsa 17% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë ka qenë i gatshëm për të dhënë sqarime dhe shpjegime të mëtejshme kur kjo gjë i është kërkuar sesa jo. 3% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë nuk ka qenë i gatshëm sesa ka qenë për të dhënë sqarime dhe shpjegime të mëtejshme kur kjo gjë i është kërkuar, ndërsa 4% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) nuk ka qenë i gatshëm për të dhënë sqarime dhe shpjegime të mëtejshme kur kjo gjë i është kërkuar.

- A ju ka nxitur sa duhet pedagogu (i leksioneve) interesin për lëndën?




Nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 55% e tyre janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) ka nxitur interesin për lëndën e zhvilluar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik. Ndërsa 25% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë ka nxitur interesin për lëndën sesa jo. 12% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë nuk ka nxitur interesin sesa ta ketë nxitur atë, ndërsa vetëm 8% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) nuk ka nxitur interesin për lëndën të zhvilluar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik.

- A ka qenë pedagogu (i leksioneve) gjithmonë prezent për të zhvilluar orët e mësimi?




Pyetja e 7



Për studentët e vitit të parë nga sa konstatohet nga tabela e mësipërme rreth 51% e tyre janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) ka qenë gjithmonë prezent për të zhvilluar orët e mësimit. Ndërsa 34% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë ka qenë gjithmonë prezent për të zhvilluar orët e mësimit sesa jo. 7% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) më shumë nuk ka qenë gjithmonë prezent për të zhvilluar orët e mësimit sesa ka qenë, ndërsa vetëm 8% janë përgjigjur që pedagogu (i leksioneve) nuk ka qenë gjithmonë prezent për të zhvilluar orët e mësimit për lëndën e zhvilluar gjatë semestrit të dytë të vitit akademik.




- A ka respektuar pedagogu (i leksioneve) gjithmonë orarin e zhvillimit të mësimit?



